



**RAPORT PËRFUNDIMTAR**  
**I AUDITIMIT**  
**“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”**  
**TË USHTRUAR NË BASHKINË KËLCYRË**

**TIRANË SHTATOR 2023**

<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
Legjenda dhe shkurtime	1-3
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	4-10
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	
<b>II. HYRJA</b>	
Objekti i auditimit	12-14
Qëllimi i auditimit	
Identifikimi i çështjes	
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
Përgjegjësitë e audituesve	
Kriteret e vlerësimit	
Standardet e auditimit	
Metodat e auditimit	
Dokumentimi i auditimit	
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15-16
<b>-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:</b>	
1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	16-19
2.1-2.5 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	19-28
2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre. Auditim mbi administrimin e aseteve	28-41
3. Vlerësimi i raportimit financiar	41-60
4.1- 4.3. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.	60-79
4.4. Mbi zbatimin e kontratave të punëve dhe shërbimeve publike	79-84
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	84-86
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	86-87
7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	87-103
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	104-119
<b>V. ANEKSE</b>	120-134

## Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NjA	Njësi Administrative.
ShA	Shoqëri Anonime.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 426/1 Prot, datë 19.05.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.05.2023 deri në datën 27.06.2023, në subjektin Bashkia Këlcyrë u krye “Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 dhe Auditimi i Përputhshmërisë për periudhën 01.07.2020 – 31.12.2022”.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditime mëparshëm.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti për aktet e konstatimit, por jo për projektraportin e auditimit. Subjekti nuk ka konfirmuar me shkresë për njohjen me projektraportin dhe nuk ka treguar interes për të zhvilluar takim përmbyllës në KLSH, për diskutimin mbi rezultatet e auditimit.

### 2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raportin përfundimtar (faqe)	Rëndësia	Rekomandimi
I	<p><b>Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë evidentuar nevojat për trajnim dhe nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.</p> <p>Hartimi dhe zbatimi i strukturës organizative nuk garanton realizimin e plotë të objektivave të njësisë vendore për disa fusha të veprimtarisë së saj, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Nuk është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Teritorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen dhe një mirë menaxhim të</li></ul>	41-60	E lartë	<p><b>Rekomandim:</b> Kryetari i Bashkisë të marrë masa për hartimin e programit vjetor për trajnimin e stafit, mbi bazën e evidentimit më parë të nevojave reale për trajnim.</p> <p><b>Rekomandim:</b> a) Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të parashikojë në strukturën organizative të institucionit ngritjen e sektorit të Administrimit të Aseteve me qëllim e miradministrimit të të gjitha asetëve të njësisë vendore.</p> <p>b) Të plotësohet sipas numrit të strukturës së miratuar në VKB Nr. 03, datë 18.01.2022, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Planifikimi dhe Zhvillimit</p>

	<p>aseteve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim, si dhe kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.</p> <p>- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Planifikimi dhe Zhvillimit të Territorit nuk janë plotësuar me të gjithë punonjësit sipas numrit të strukturës së miratuar.</p> <p>Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese.</p> <p>Nuk është hartuar rregjistër i riskut, duke mos marrë masa për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim nën 16, 20, 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, nën 64, pika h dhe j të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKB Nr. 03, datë 18.01.2022.</p>			<p>të Territorit.</p> <p>c) Të bëhet vlerësimi vjetor i punonjësve me status të nëpunësit civil.</p> <p><b>Rekomandim:</b>Nga secili sektor të hartohet rregjistri i riskut, për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre, të hartohet harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për këto procese.</p>
2	<p><b>Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Këlcyrë, në lidhje me kontratat e qirave për pyje dhe kullota, rezultoi se për vitin 2022 janë lidhur 30 kontrata, për të cilat nuk ka detyrime të pa likuajuara, por u konstatuan disa anomali si vijon:</p> <p>Konstatohet se kontratat në çdo rast nuk kanë bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (<i>sipas vendimit të Komisionit të Ndarjes së Kullotave apo vendimit të këshillit të komunës</i>).</p> <p>Në kontratë është përcaktuar se ato i referohen hartës bashkëlidhur çdo kontrate, por në fakt nuk administrohet një dokument i tillë, por vetëm një skicë e thjeshtë e cila nuk është miratuar nga titullari i institucionit apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij.</p> <p>Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfutur kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve</p>	28-41	E lartë	<p><b>Rekomandim:</b> Për të gjitha kontratat e dhënies me qira të fondit pyjor e kullor, duhet të krijohet dosje individuale, ku të pasqyrohen qartazi të gjitha të dhënat mbi fermerin, llojin e bagëtive që mbarështon, numrin e tyre, si dhe vërtetimin nxjerrë nga sistemi RUDA me të dhënave e marra nga AZHBR, si dhe parcela kullimore e dhënë në përdorim, sipas skicës së miratuar dhe të bashkëlidhur çdo kontrate.</p> <p><b>Rekomandim:</b> Të merren masa që kontratat për sipërfaqet kullimore të jepen në raport me numrin e krerëve që disponon çdo subjekt, sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare (dokument i cili duhet të shoqërojë kontratën) dhe të dhënave të AZHBR (Sistemi Rud), mbi numrin e krerëve të deklaruar dhe regjistruar</p>

	<p>Veterinare për numrin e regjistrit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.</p> <p>Lidhja e tyre përgjithësisht është bërë në mungesë të konfirmimit (vërtetimit) të numrit të bagëtive, dokument i cili lëshohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare, dhe konfirmon regjistrin e bagëtive dhe matrikullit të tyre sipas sistemit “Ruda”, duke mos bërë krahasimin e llojit dhe numrit të krerëve sipas kontratës me regjistrin e DRSHV, për secilin vit, si dhe eliminimit të rasteve të lidhjes së kontratave me persona të cilët nuk figurojnë të regjistruar në listën e blegtorëve.</p> <p>Nuk është kryer inventarizimi kadastrale pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).</p> <p>Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.</p> <p>Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.</p> <p>Nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave në ish-ZVRPP Gjirokastër, sot ASHK Drejtoria Gjirokastër.</p> <p>Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nën ngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.</p> <p>Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.</p> <p>Nuk janë përcaktuar kritere lidhur me afatin i cili duhet të jetë një vjeçar dhe pagesa të bëhet e menjëhershme në momentin e kontratës.</p>			<p>në këtë sistem.</p>
3	<p><b>Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se për vitin 2022 Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të cilat në bilanc paraqiten në vlerën 0 lekë.</p> <p>Mos kryerja e procesit të inventarizimit është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE Nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe</p>	41-60	Elartë	<p><b>Rekomandim:</b> Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale, të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”.</p>

	raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18.			
4	<b>Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar regjistër kontabël për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat e njësisë vendore. Për këtë arsye nuk ka të dhëna të sakta për aktivet lidhur me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26-33.	41-60	Elartë	<b>Rekomandim:</b> Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit për të gjitha aktivet e njësisë vendore, atyre afatshkurtra dhe afatgjata, përfshirë edhe pronat e njësisë vendore në pronësi apo në përdorim.
5	<b>Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DT, seksioni i kapacitetit teknik, u konstatua se në tre procedura prokurimi janë vendosur kriteret e cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, me aftësinë zbatuese të saj, pasi zërat e preventivit nuk justifikojnë kriteret e vendosura.	60-79	E lartë	<b>Rekomandim:</b> Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa për eliminimin e mangësive në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, duke shmangur vendosjen e kriterëve të cilët nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.
6	Në kontratën me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë” u konstatua se ishin instaluar pajisjet e sistemit SCADA të parashikuara në kontratë por, ky sistem ishte jashtë funksionit, i pa programuar, matësat elektronik nuk tregojnë matjet në panelet përkatëse, si dhe sistemi i klorinimit ishte jo funksional. Në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që në përfundim të punimeve dhe aktin e kolaudimit sistemit SCADA të jetë kryer testi i funksionimit (test report). Mosfunksionimi i sistemit të klorinimit tregon se sasia e ujit në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm rrezikon shëndetin publik të konsumatorëve. Mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm rrezikon shëndetin publik të konsumatorëve dhe është në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, neni 6 “Kriteret e cilësisë së ujit të pijshëm” pika 1 dhe Kontrata Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 (specifikimet teknike).	79-84	E lartë	<b>Rekomandim:</b> Bashkia Këlcyrë në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA të marrë masa të menjëhershme për vendosjen në funksionim të sistemit SCADA, i cili do të kryej një kontroll sa më efikas të sistemit të prodhimit e të shpërndarjes për uljen e kostove të prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu të vendoset në funksion sistemi i klorinimit, i koordinuar në mënyrë automatike me sistemin SCADA, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë ruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

7	<p><b>Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Këlcyrë, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 262/6 prot., datë 01.08.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre. Statusi i zbatimit të rekomandimeve është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, të pranuar plotësisht nga subjekti, prej të cilave është zbatuar pjesërisht 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, nuk janë zbatuar 11 masa organizative.</li> <li>- Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të munguara), janë rekomanduar 3 masa, për arkëtim të vlerës totale 73,726,000 lekë, të pranuar nga subjekti, prej të cilave dy masa janë të pa zbatuar, ndërsa një masë është në proces zbatimi.</li> </ul>	87-103	E lartë	<p><b>Rekomandim:</b> Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 262/6 prot., datë 01.08.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përsheptuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.</p>
8	<p><b>Gjetje nga auditimi:</b> Si rezultat i mos marrjes së masave shtrënguese nga Bashkia Këlcyrë, janë krijuar debitorë nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar.</p> <p>Gjendja e debitorëve më 31.12.2022 është në shumën <b>72,228 mijë lekë</b>, nga e cila debitorët e kategorisë private kanë vlerën 16,784 mijë lekë, ndërsa debitorët e kategorisë familjare kanë vlerën 55,444 mijë lekë, ose 76 % të totalit. Kjo vlerë konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar nga Bashkia Këlcyrë. Në vitin 2022 vlera e debitorëve ka ardhur në rritje krahasuar me vitin 2021, pasi në fund të vitit 2021 vlera e debitorëve është 63,685 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 kjo vlerë është 72,228 mijë lekë, ose 8,543 mijë lekë më e lartë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë të rinj në vlerën 8,543 mijë lekë.</p> <p>Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë masë tjetër shtrënguese për arkëtimin e debitorëve.</p>	28-41	E lartë	<p><b>1.1.Rekomandim:</b> Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit vlerësimit tatimor për debitorët privat dhe familjar, si dhe në vijim të ndjekin të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve prej 72,228 mijë lekë nga debitorët e privat dhe familjar.</p>
9	<p>Nga auditimi u konstatua se për katër subjekte të cilët zhvillojnë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, nga Bashkia Këlcyrë nuk është aplikuar tarifa për paisjem me autorizim për zhvillimin e aktivitetit të mësipërm. Nga këto veprime në total është krijuar</p>	28-41	E lartë	<p><b>Rekomandim:</b> Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 8,000,000 lekë nga 4 subjektet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Subjekti D., për vlerën prej 1,800,000 lekë.</li> <li>-Subjekti E., për vlerën prej 3,300,000 lekë.</li> </ul>



<p>një e ardhur e munguar në vlerën <b>8,000,000 lekë</b>, sipas detyrimeve të subjekteve në vijim:          Subjekti D. për vlerën prej 1,800,000 lekë.          -Subjekti E. për vlerën prej 3,300,000 lekë.          -Subjekti D., për vlerën prej 2,200,000 lekë.          -Subjekti A., për vlerën prej 700,000 lekë.</p>		<p>-Subjekti D., për vlerën prej 2,200,000 lekë.          -Subjekti A., për vlerën prej 700,000 lekë.</p>
--	--	---

### 3. Konkluzioni dhe opinionin i auditimit

#### OPINIONI I AUDITIMIT

##### I. Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2022

KLSH ka audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Këlcyrë për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **të modifikuar me rezervë**<sup>1</sup> për llogaritë vjetore të Bashkisë Këlcyrë, duke arritur në përfundimin se anomali të e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2022, të shprehura në bazën për opinion.

##### Baza për dhënien e opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit për shpenzimet e vitit 2022 prej 3,9 milion lekë, si dhe anomali të e konstatuara, si vijon:

-Për vitin 2022, nuk janë përfshirë në inventarizim llogaritë: 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215, si dhe për këto llogari nuk ekziston një regjistër kontabël, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

-Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin” është nënvlersuar në vlerën 28,453,410 lekë.

##### II. Opinioni i auditimit të përputhshmërisë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Këlcyrë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në

<sup>1</sup> “Opinion i modifikuar me rezervë”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura në llogaritë vjetore.

gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar**<sup>2</sup> të përputhshmërisë.

#### **Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë**

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

- Nuk është hartuar regjistër i riskut, duke mos marrë masa për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.

- Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese.

- Nuk është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen dhe një mirë menaxhim të asetëve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim, si dhe kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2022 rezultojnë detyrime të pa arkëtuara nga taksapaguesit e kategorisë familjarë dhe privat në vlerën 72.2 milion lekë.

- Në kontratën me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë” u konstatua se ishin instaluar pajisjet e sistemit SCADA të parashikuara në kontratë por, ky sistem ishte jashtë funksionit, i pa programuar, matësat elektronik nuk tregonin matjet në panelet përkatëse, si dhe sistemi i klorinimit ishte jo funksional. Në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që në përfundim të punimeve dhe aktin e kolaudimit sistemit SCADA t’i jetë kryer testi i funksionimit (test report). Mosfunksionimi i sistemit të klorinimit tregon se sasia e ujit në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjeno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm rrezikon shëndetin publik të konsumatorëve.

-Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 28,453 mijë lekë.

- Nuk është hartuar regjistër kontabël për aktivet afatgjata, përfshirë edhe pronat e njësive vendore në pronësi apo në përdorim.

-Janë konstatuar anomali në hartimin e kritereve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi në tre raste janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

- Në një rast, në procedurat e prokurimit publik është kualifikuar, shpallur fitues dhe lidhur kontratë me operatorin ekonomikë i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Këlcyrë:**

Drejtimi i njësive vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit

<sup>2</sup> “Opinion i modifikuar”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në veprimtarinë e institucionit të audituar.

financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Këlcyrë.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

**II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 426/1 Prot, datë 19.05.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.05.2023 deri në datën 27.06.2023, në subjektin Bashkia Këlcyrë u krye “Auditimi Financiar” për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 dhe “Auditimi i Përputhshmërisë” për periudhën 01.07.2020 – 31.12.2022”. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.B.M. – Përgjegjës Grupi
- 2.H.I. – Anëtar
- 3.E.RR. – Anëtar
- 4.M.M. – Anëtar
- 5.S.H.– Anëtar

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë risku.

**OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

**1. Objekti i auditimit.** Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

**2. Qëllimi i auditimit.** Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur

saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit nga subjekti, të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar.

### **3. Identifikimi i çështjes.**

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit të auditimit, u identifikuan fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimit e auditimit, të miratuara me programin e auditimit, si më poshtë:

Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare për vitin 2022.

4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMTV).

7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

*(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)*

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

*(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)*

**6. Kriteret e vlerësimit.** Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

#### **Standardet e Auditimit:**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;

- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH;

- Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH;

- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH;

- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

#### **Akte ligjore:**

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;

- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

## **Akte nënligjore**

- VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”;
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.

## **Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:**

- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të vetëqeverisjes vendore” etj.;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e Procedurat të Auditimit në KLSH;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Këlcyrë, etj.

## **7.Standardet e auditimit**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI<sup>t</sup>, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i zbatimi të rekomandimeve të KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

## **8. Metodat (Procedurat) e auditimit.**

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5).

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të riskut të auditimit.

Për sa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, grupi i auditimit ka kryer intervista verbale, ka kryer teste kontrolli.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (risku në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat

thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, si:

Kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, intervistomi, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

### 9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

*Zona Gjeografike:* Këlcyra kufizohet në veri me bashkinë Poliçan, në lindje me Bashkinë Skrapar, në jug me bashkinë Përmet dhe Libohovë dhe në perëndim me Bashkinë Tepelenë dhe Memaliaj. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Këlcyrës.

*Popullsia:* Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 6.113 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrisë Civile, kjo bashki numëron 12.468 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 304.65 km<sup>2</sup>, me një densitet prej 40.92 banorë/km<sup>2</sup>.

*Të dhëna të tjera:* Këlcyra është një qytezë e shtrirë mes maleve Trebeshinë dhe Nemerckë, e cila përshkohet nga ujërat e kthjella të Vjosës. Zona me peizazhe mahnitëse dhe vende historike ofron pak sa i përket strukturës arkitekturore. Zhvillimet urbane pa kriter, mos-kombinimi i ndërtimeve para viteve '90 me ato të tranzicionit dhe mungesa e një plani urban për zgjerimin kanë sjellë pasoja për qytezën e Këlcyrës.

Të ardhurat ekonomike të banorëve janë të ulëta. Ato vijnë nga aktivitete të vogla tregtare dhe shërbimi, por edhe nga bujqësia dhe blegtoria e pakët. Këlcyra është dalluar gjithmonë për cilësinë e lartë të frutave dhe rrushit dhe është njohur si qendër për kultivimin e rakisë dhe verës. Kaosi në tregun shqiptar të pijeve dhe spekulimet kanë bërë që Merloti i famshëm i Këlcyrës pothuajse të humbasë në tregun shqiptar të verës.

Edhe vreshtaria ka pësuar luhatje të ndjeshme, ndërsa kantinat kanë pak peshë në ekonominë e zonës. Të ardhurat nga emigracioni kanë mbështetur mjaft familje të zonës, por rënia e tyre për shkak të krizës ka rënduar situatën ekonomike të banorëve.

Popullsia e Këlcyrës është e përbërë kryesisht nga vendas dhe të ardhur nga fshatrat përreth. Shumë banorë kanë migruar drejt Tiranës, ndërsa një pjesë e madhe e popullsisë kanë emigruar kryesisht drejt Greqisë fqinje.

#### Emri i Njësisë

#### Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre

#### Këlcyrë

**Qyteti:** Këlcyrë, Fshatrat

**Fshatrat:** ; Fshat Këlcyrë, Mbretzhdan, Maleshovë, Limar, Leskaj

#### Ballaban

**Fshatrat:** Ballaban, Vinokash, Vinokash Fushë, Komarak, Mazhar, Kondas, Psar, Ball, Kajcë, Pavar, Toshkëz, Bubës 1, Bubës 2, Beqaraj

#### Sukë

**Fshatrat:** Sukë, Goricë, Fshat i Ri, Rodenjë, Podgoran, Podgoran Fushë, Ujmirë, Zhepovë, Shelq, Topojan, Luar, Delilaj, Çorogunj, Taroninë

#### Dishnicë

**Fshatrat:** Beduqas, Tolar, Panarit, Riban, Varibop, Kuqar, Mërtinjë, Xhanaj, Bënjë, Fratar, Senican, Katundishtë, Leskovec, Gërdas, Kodrishtë

Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, etj. Vendimet merren nga Këshilli Bashkiak i përbërë nga 15 anëtarë; Drejtimi i Bashkisë kryhet nga Kryetari i Bashkisë; Njësitë Administrative drejtohen nga Administratorët e Njësive Administrative;

### **Detyrat dhe kompetencat e Bashkisë Këlcyrë fokusohen kryesisht në:**

- Shërbimin publik;
- Shërbimin social;
- Shërbimin kulturor dhe sportet;
- Biznesin.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Për vitin 2022 Bashkia Këlcyrë ka funksionuar duke planifikuar si buxhet 321,964,713 lekë realizimi i të cilave është në masën 93.4%. Nga kjo shumë 31,193,930 lekë janë mbuluar nga të ardhurat e veta dhe 269,467,509 lekë janë mbuluar nga granti i qeverisë.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

## **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS PIKAVE TË PROGRAMIT**

### **Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik**

➤ Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Këlcyrë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësive në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe

kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

**Titulli i gjetjes:** Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

**Situata:** Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:

-Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese. Nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1

-Në bazë të pyetësorit dërguar njësisë të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi.

-Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).

-Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen

-Nuk ka vlerësime vjetore për punonjësit.

-Nuk ka raporte periodike mbi zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit.

-Bashkia Këlcyre nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhëniet me të cilët rregullohen me anë të Kodit të Punës.

-Bashkia Këlcyre nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik.

-Bashkia Këlcyre nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.

-Në Bashkinë Këlcyre nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut.

-Bashkia Këlcyre nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.

-Bashkia Këlcyre nuk ka hartuar dhe miratuar hartat e procesit të punës.

-Bashkia Këlcyre nuk ka miratuar gjurmën e auditimit.

-Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se në Strukturën Organizative të miratuar me Vendimin Nr. 03 Datë 18.01.2022, sektorë si: Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Sektori i Auditit të Brendshëm dhe Zyra e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit nuk kanë asnjë punonjës në strukturën e tyre. Bashkia Këlcyre nuk ka parashikuar në Strukturën e saj për vitin 2022 sektorin e IMTV.

-Për vitin 2022 nuk është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut.

-Nuk është zhvilluar numri i duhur i mbledhjeve të kërkuara për GMS.

-Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Këlcyre, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

-Si rrjedhojë e vakancave në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Këlcyre nuk ka veprimtari të auditit të brendshëm.



*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë, me detyrë nëpunës autorizues, znj. V.K., përgjegjës i Zyrës së Financës, me detyrë nëpunës zbatues dhe Koordinator Risku.*

**Kriteret:**

- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1.
- Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.
- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore.
- Udhëzimi nr. 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 3.2.5.
- Ligji nr. 10296 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin neni 8, pika a. Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.
- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.
- Udhëzimi nr. 16 dt 20.07.2016 pika 3.2.2.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 21, pika 2.
- Ligji nr.10296 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 8, pika 8. shkronja a.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22, pika 5.
- Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreun III, paragrafi 3.3.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2.
- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.4.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit ligjor të cituar më sipër.

**Ndikimi:** Mosnjohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Funksionimi i institucionit Bashkia Këlcyrë dhe përmbushja e detyrimit të saj ligjore dhe kushtetuese.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1.1:** Të plotësohen vakancat në Strukturën e Bashkisë Këlcyrë. Të garantohej funksionimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm, Sektori i IMTV, si dhe ai i Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juridike.

**Rekomandimi 1.2:** Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit. Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut. Të hartohet regjistri i riskut.

**Rekomandimi 1.3:** Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin. Të garantohej zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit për MFK dhe të raportohet për realizimin e tyre nga sektorët përkatës të ngarkuar me pikat specifike.

**Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm.**

**Titulli i gjetjes:** Mosfunksionimi i Sektorit të Auditimit të Bashkisë Këlcyrë

**Situata:** NJAB nuk është ngritur për vitin 2022 duke qenë se nuk ka asnjë punonjës, në kundërshtim me Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3, 6. Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk funksionon dhe organizuar në përputhje me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 09, datë 24.01.2020, “Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve për vitin 2020”, me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 12, datë 26.01.2021, “Për miratimin e

strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve për vitin 2021” si dhe “Rregullores së Funksionimit të Brendshëm të Administratës së Bashkisë Këlcyrë” nr. 359 prot., datë 19.02.2020.

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e ngritjes së strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm nuk sjell një veprimtari të pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për të përmirësuar performancën e institucionit, mosidentifikim të anomalive që janë konstatuar nga KLSH në fushën e MFK-s, pasqyrave financiare si dhe buxhetit.

**Shkaku:** Mos ngritje të Njesisë së Auditit të Brendshëm

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë Këlcyrë të marrë masa për ngritjen e Njesisë së Auditit të Brendshëm në nivel sektori; marrëveshjes midis titullarëve të njësive publike përkatëse apo kontraktimit të personave juridikë ose fizikë, të çertifikuar si “auditues të brendshëm”, të hartojë dhe miratoj dokumentacionin e nevojshëm si dhe pas këtij procesi kjo njësi të hartojë program pune për auditimin e fushave me risk në veprimtarinë e institucionit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Z. K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë, nëpunës autorizues;*

## **Pika 2.1-2.5 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

### *2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;*

**Titulli i gjetjes** Në Bashkinë Këlcyrë u konstatuan parregullsi të dukshme në hartimin dhe miratimin e programeve buxhetore afatmesëm (PBA) për vitin 2022.

#### **Situata:**

Programimi i PBA 2022-2024

Nuk është bërë miratimi i tavanëve të buxhetit afatmesëm 2022-2024 me Vendim të Këshillit Bashkiak, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Këlcyrë për vitet 2022-2024”, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Këshilli Bashkiak Këlcyrë nuk ka marrë Vendim për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024 sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33.

Miratimi i Buxhetit Vjetor 2022, me Nr. 3, datë 08.02.2021, është kryer jashtë afateve të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, pika 3 dhe 4.

Programimi i PBA 2022-2024

Nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024.

Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 22.12.2021, “Për miratimin e tavanëve dhe pasqyrave të programit buxhetor afatmesëm vendor 2022- 2024, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Këlcyrë për vitet 2022-2024”, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Këshilli Bashkiak Këlcyrë nuk ka marr Vendimin për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Miratimi i Buxhetit Vjetor 2022, me Nr. 3, datë 08.02.2021, është kryer jashtë afateve të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, pika 3 dhe 4.

Mungon Plani i Masave dhe Veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Grupi auditues konstaton se ka mungesë të dokumentave (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.

Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë.

### **Kriteri:**

- Ligji nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”:

Neni 33 ku cilësohet:

*“ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.*

Neni 34 ku cilësohet: *Pika 1. Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore..”.*

Neni 35 ku cilësohet: *Pika 1. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.*

Neni 36 ku cilësohet: *Pika 4. Programi buxhetor afatmesëm vendor përfshin informacionin për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore për: a) secilën kategori të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore ;b) shpenzimet sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik për çdo program buxhetor; c) qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse. Të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore; ç) vlerësimin e kostove të politikave aktuale dhe atyre të reja, të planifikuara për financim nëpërmjet shpenzimeve buxhetore vendore vjetore dhe*

afatmesme; d) informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara nga çdo program buxhetor dhe niveli i përmbushjes së tyre.

*Pika 5. Brenda datës 1 qershor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i dërgon Ministrisë së Financave projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm.*

Neni 37 ku cilësohet: *Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.”*

-Udhëzimi nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, shtojca 5 e udhëzimit ku cilësohet: *Gjurma e Auditit për procedurat e përgatitjes së PBA (njësitë e qeverisjes së përgjithshme).*

-Udhëzimi nr.22, datë 30.07.2017 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore”, shtojca 1 e udhëzimit ku cilësohen: *“Afatet kohore për monitorimin e buxhetit”.*

-Udhëzimi nr.6/3, datë 10.07.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”.

-Udhëzimi nr.7, datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, kapitulli 1 ku cilësohet: *Afatet e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, shtojca 4 “Grupi për menaxhimin strategjik, ekipi i menaxhimit të programeve”, shtojca 5 “Pema e programit dhe roli i saj në mbështetje të rishikimit të politikave të programit dhe planifikimin e shpenzimeve të programit”.*

**Impakti:** Në hartimin dhe planifikimin e programeve buxhetore afatmesëm, treguesve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, i udhëzimeve për hartimin e programeve buxhetore afatmesëm, mos funksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesa e organizmit të grupeve të punës dhe ndarjes së detyrave, mungesa e një kalendarit për funksionimin e programit buxhetor afatmesëm.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa të menjëhershme, për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik, për zbatimin e të gjitha procedurave për programimin e buxheteve vjetore dhe afat mesme, duke krijuar grupet e punës sipas projekteve të financimit, si dhe të zbatohet kalendarit i programimit të buxhetit sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1.Z.K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë si Nëpunës Autorizues

2.Znj.V.K., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit

Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 3 datë 08.02.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokaster: me shkresën nr. 175/1 prot date 24.02.2022.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 20,994,000 lekë, të ardhura të trashëguara në vlerën 1,552,000 lekë, transferta e pakushtëzuar kap vlerën 70,850,000 lekë, transferte e pakushtëzuar e trashëguar në vlerën 9,024,000 lekë, transferta specifike kap vlerën 49,080,000 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 151,500,000 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 151,500,000 lekë.

Gjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr. 29, datë 30.09.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Këlcyrë për ndryshime brenda buxhetit të vitit 2022, duke pakësuar zërin 602 në vlerën 611,000 lekë dhe duke shtuar zërin 600, po në vlerën 611,000 lekë.

Gjithashtu me urdhër të titullarit është kryer lëvizje e fondeve brenda të njëjtës strukture buxhetore, për dhënien e ndihmës financiare ne fund të vitit për punonjësit në shumën 1,950,000 lekë.

Në formë tabele paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2022 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

*në mijë lekë*

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Projekt Buxhet 2022
600	Paga	79,470	90,150	90,150	90,150
601	Sigurime Shoqërore	13,797	15,355	15,355	15,355
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	24,740	31,430	31,430	31,430
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0
604-606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	271	2,445	2,445	2,445
<b>I</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>118,278</b>	<b>139,380</b>	<b>139,380</b>	<b>139,380</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	18,000	12,120	12,120	12,120
	<b>Shp. Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>18,000</b>	<b>12,120</b>	<b>12,120</b>	<b>12,120</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>18,000</b>	<b>12,120</b>	<b>12,120</b>	<b>12,120</b>
<b>III</b>	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>I+II +III Totali I Shpenzimeve</b>	<b>136,278</b>	<b>151,500</b>	<b>151,500</b>	<b>151,500</b>

*Burimi: Sektori i financës*

Gjatë vitit 2022 nuk është bërë Analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore, Raportet e monitorimit nuk janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe nuk janë dërguar në ministrin e financave brenda afateve ligjire në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

**Planifikimi i buxhetit bazë (buxheti i vet bashkisë) me ndryshimet si dhe plani i buxhetit bazë (buxhet me fonde të kushtezuara-gjendja civile, ndihme paaftesi dhe investime me buxhet shteti) dhe ndryshimet paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.1 bashkëlidhur projekt rait të auditimit.**

**2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.**

*-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:*

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e më poshtme:

*në mijë lekë*

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	105,505	97,233	+ 8,272
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	33,875	38,949	-5,074
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	12,120	17,776	-5,656
4	Investime nga FZSHS	0		
	<b>Total i planit fillestar</b>	<b>151,500</b>	<b>153,978</b>	<b>-2,478</b>
	<b>Shtesat nga Pushteti Qendror</b>			
5	Investime grant i kushtëzuar	66,374		
6	Shpenzime për pagat (600+601)	2,056		
7	Shpenzime (602.604.606.609)	90,746		
	Grant i kushtëzuar (230-231)			
	<b>Gjithsej</b>	<b>310,676</b>		

*Burimi: Sektori i financës*

**Nga auditimi konstatohet se** nga krahasimi i planit përfundimtar të vitit 2022 me atë të PBA-së 2022-2024, do shikojmë se ulje të planit përfundimtar në vlerën 2,478 mijë lekë respektivisht: vlera në ritje prej 8,272 mijë lekë i perket shpenzimeve për paga; vlera në ulje 5,074 mijë lekë i perket shpenzimeve operative dhe transfertat, ndërsa vlera në ulje 5,656 mijë lekë i perket investimeve të cilat janë ulur për shkak të mosrealizimit të të ardhurave.

*Lista e investimeve në vazhdim të parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe granti paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.2 bashkëlidhur raportit të auditimit.*

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla të cilat paraqiten **në aneksin nr. 2 pika 2.2 bashkëlidhur raportit të auditimit.**

Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik paraqitet në aneksin nr. 3 pika 2.2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën **321,964 mijë lekë** ndërsa plani i buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën **310,676 mijë lekë me një diferencë në vlerën 11,288 mijë lekë.**

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferata e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **321,964 mijë lekë**, ndërsa realizimi **300,661 mijë lekë**, ose në masën 93.3%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **92,358 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **81,481 mijë lekë**, ose në masën 88%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 91%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **29,239 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **22,613 mijë lekë**, ose në masën 77.3%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **78,494 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **78,374 mijë lekë**, ose në masën 99.8%.

***Titulli i gjetjes:** Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, planifikimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve.*

**Situata:** Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Këlcyrë ka diferencë me vlerën e planifikuar. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Këlcyrë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetaren e Bashkisë Këlcyrë z.K.N si dhe Znj.V.K me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022.

Veprimet e mësipërme janë në perputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

*“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.*

**Kriteri:**

Pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27 dhe 32, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016; Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37: Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “ç”.

**Ndikimi/Efekti:** Mangësi e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore.

**Shkaku:** Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të dokumentojë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar edhe kërkesat e tyre buxhetore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në fund të çdo viti buxhetor të përgatis dhe të paraqes për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në vijim Këshilli Bashkiak Këlcyrë të marr vendimet brenda afateve.

**Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë**

Për vitin 2022 fondi rezerve është miratuar në shumën prej 600,000 lekë, ndërsa fondi i emergjencës në shumën prej 1,499,000 lekë.

- mënyrën e llogaritjes të kesaj vlere, bazën ligjore për këtë; Fondi rezerve është përlllogaritur në masën rreth 0.30% të shumës së buxhetit të pavarur të njësisë, ndërsa fondi emergjencës është përlllogaritur në masën rreth 1.7 të shumës së buxhetit të transf së pakushtezuar, transf specifike si edhe të ardhurat e vitit ushtrimor sipas ligjit 139/2015 për pushtetin vendor, ligji 45/2019 për mbrojtjen civile etj.

- vlera e përdorur në fakt nga Bashkia Këlcyrë; Për vitin 2022 fondi i emergjencës i miratuar në buxhetin e bashkisë nuk është përdorur në asnjë rast, kjo edhe për shkak të mungesës së të ardhurave. Përsa i përket fondit rezerve është përdorur në shumën prej 200,000 lekë sipas vendimeve të miratuara në këshillin bashkiak për dhënie ndihme për familje në nevojë për rast sëmundje të renda dhe kurime të specializuara.

- vlera e pa përdorur; Në total plan i papërdorur është në shumën prej 1,599,000 lekë, i ndarë në 1,499,000 lekë fond emergjence dhe 100,000 lekë fond rezerve.

**2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)**

*Në mënyrë të përmbledhur paraqitet fondet e trazhuara për vitin 2022.*



Fondet e trashëguara në 31.12.2021 për përdorim në vitin 2022 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2022 për përdorim në vitin 2023 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
10,576,863	14,809,090

## Detyrimet e prapambetura viti 2022

në lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2022
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
231	Investime	39,297,136	12,000,000	27,297,136	0	27,297,136
602	Shpenz operat, sherbime	963,524	963,524	0	1,156,274	1,156,274
	<b>Totali</b>	<b>42,260,660</b>	<b>12,963,524</b>	<b>27,297,136</b>	<b>1,156,274</b>	<b>28,453,410</b>
Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrit e linjës)						
	Detyrime ne total					

*Burimi: Bashkia Këlcyrë*

*Sqarim: Nga vlera prej 27,297,136 lekë si detyrim per investime, shuma prej 5,670,245 lekë ka kaluar si detyrim Vendim gjyqesor me vendim gjykate nr. 480 date 01.06.2022.*

Vlera e raportuar nga Bashkia Këlcyrë në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është **9,208,704 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 520 prot., datë 21.02.2023 drguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vleren e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vleren e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua sfatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve	<b>21,626,891</b>		
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>			<b>0.85%</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>0</b>		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			

<b>b</b>	<b>Shenzime kapitale</b>	<b>21,626,891</b>		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>0</b>		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>21,626,891</b>	<b>151,500,000</b>	<b>14,28%</b>

*Burimi: Bashkia Këlcyrë*

**Titulli i gjetjes:** Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura

**Situata:** Bashkia Këlcyrë në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 42,260,660 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në Buxhetin vjetor 2022 është likuiduar vlera 13,807,190 lekë.

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (42,260,660-28,453,410), me 13,807,190 lekë, ose në masën prej 32.6%.

Për sa më sipër rezulton se për vitin 2022 në buxhetin e bashkisë janë parashikuar investime të reja në vlerën 12,120 mijë lekë. Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N. si dhe znj. V.K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022 paraqitet në aneksin nr. 1 pika 4.4 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Kriteri:** Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimi MFE Nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku thuhet: Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës”.

**Ndikimi/Efekti:** Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

**Shkaku:** Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Sektori i Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, ku mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rrishtë për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

### **3.5 Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Njësitë vendore përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore në fushat e infrastrukturës rrugore, arsimit, shëndetësisë etj.

Fondi total i pa alokuar, deri më 31.12.2022 për investimet, kap vlerën 247,214 lekë dhe i përket periudhës së investimeve të kontraktuara për vitet 2019-2022.

Të detajuara, investimet e financuara nga FZHR nga viti 2019, të cilat nuk janë likuiduar deri më datën 31.12.2022 jepen në tabelat në vijim:

Nr	Objekti i prokurimit	Kontrata nr.datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuiduar 31.12.2022	Vlera e pa likuiduar	Arsyet e mos likuidimit
1	Rikonstruksion i rrugëve të lagjes së Spitalit	07.05.2019	34,858	21,000	13,858	Sipas planifikimit në buxhet
2	Sistemim asfaltim rruga Suke-Podg.Fushe, rruga Gorice, rruga Komarak e Vinokash, rruga Rriban, rruga fshat Kelcyre	10.06.2019	36,353	30,455	5,898	Sipas planifikimit në buxhet
3	Ndërtim ujësjellesash për njësitë administrative Ballaban, Suke e Deshnicë Loti i parë njësi Suke e Ballaban	29.06.2021	296,328	114,000	182,328	Sipas celjes së fondeve nga MF
4	Supervizim për Ndërtim ujësjellesash për njësitë administrative Ballaban, Suke e Deshnicë Loti i parë njësi Suke e Ballaban	08.11.2021	3,472	997	2,475	Sipas celjes së fondeve nga MF
5	Sistemim asfaltim rruga ura e Mbrezhanit Malshove	22.10.2021	44,160	9,000	35,160	Sipas planifikimit në buxhet
6	Permiresimi i banesave ekzistuese (Projekte për permiresimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara)	13.10.2020	18,197	18,197	0	Mbyllur
7	Permiresimi i banesave ekzistuese (Projekte për permiresimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara)	22.10.2022	19,670	12,174	7,495	Sipas celjes së fondeve nga MF
	<b>Totali</b>		<b>453,038</b>	<b>205,823</b>	<b>247,214</b>	

*Burimi: Bashkia Këlcyrë*

### **Pika 2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve.**

**Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

➤ ***Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore***

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 4, datë 15.12.2021, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Këlcyrë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”, ku përfshihet edhe strukturën e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 6 punonjës konkretisht 1 Përgjegjës i zyrës së tatim taksave dhe 2 specialist për tatim taksa vendore të Bashkisë Këlcyrë dhe 3 agjent në Njësit Administrative. Struktura e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 është paraqitur në **Aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.**

➤ ***Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:***

Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Referuar të dhënave të marra nga Sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Këlcyrë, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2021	141	0	0	141
		2022	141	16	1	156
2	Biznesi Madh	2021	24	0	0	24
		2022	24	0	2	22
(1+2)	Gjithsej	2021	165	0	0	165
		2022	165	16	3	178

**Burimi:** *Bashkia Këlcyrë*

**Situata:** Për vitin 2022, kanë ushtruar aktivitet 178 subjekte (*165 subjekte të biznesit të vogël, 22 subjekte të biznesit të madh*) nga të dhënat e tabelës konstatohet se për vitet objekt auditimi ka 16 regjistrime të reja dhe 3 subjekte mbyllje aktiviteti.

Përsa më sipër konstatohet se:

- Kjo situatë sipas Bashkisë Këlcyrë tregon nivelin e ulët ekonomik të kësaj Bashkie, por sipas mendimit të Grupit të KLSH-së është edhe puna e pamjaftueshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave.

-Numri i bizneseve ka ardhur duke u rritur nga viti 2021 në vitin 2022, me 13 subjekte të vegjël dhe me një ulje me 2 subjekte të mëdhenj, përsëri niveli i arkëtimit mbetet pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2021.

-Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të licencuar dhe të mbrojtur.

-Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe kontrollit fizik të dokumentacionit rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore.

-Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe auditimi fizik i dokumentacionit, rezulton se nga Zyra e Taksave Vendore nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore

Gjirokastër, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohet dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik).

**Kriteri:**

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 4 ku cilësohet: “Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”, pika 7 Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar. Neni 16 ku cilësohet: “Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, është i detyruar që, deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga Ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Deklarata dorëzohet në bankat, me të cilat administrata tatimore ka marrëveshje për pranimin e deklaratave dhe të pagesave dhe ajo shoqërohet me çdo kërkesë për rimbursim apo me çdo shumë për t'u paguar -Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 41 ku cilësohet: “Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar” 1. Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, vendos masën e bllokimit të mallrave dhe detyron personin të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si tatimpagues i tatimit mbi vlerën e shtuar. Masa e bllokimit hiqet pas kryerjes së regjistrimit për veprimtarinë ekonomike, duke aplikuar masat dhe dënimin, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 121, të këtij ligji. 2. Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKB, përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, për mallrat që disponon, administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencës/autorizimit për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmujore.

**Impakti:** Mungesa e kontrollit të territorit nga strukturat e zyrës së tatim taksave për evidentimin e subjekteve aktive dhe të ardhurat që realizojnë.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe mos veprim i zyrës së taksave

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që deklarojnë mbyllje aktivitet nëse deklarimi është i saktë si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të paregjistruar në QKB. Bashkia Këlcyrë duhet të marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e subjekteve fizik/juridik si dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore.

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022  
Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në aneksin nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit rezulton se; **Për vitin 2022**, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 46, datë 22.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër. Nga të dhënat e pasqyrës së sipërcituar, shihet se për vitin 2022 sipas planit janë në vlerën 20,994 mijë

lekë të planifikuara, janë realizuar 14,938 mijë lekë ose 71%, mos realizim në vlerën 6,056 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e ndërtesës, tarifa e pastrim-gjelbërimit, tarif për shfrytëzimin e lëndëve druhsore etj, Konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, nuk është planifikuar nuk ka një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Nuk është rakorduar (çdo 6-muaj) me Drejtorinë e Tatimeve të Qarkut Gjirokastrë për realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, në cilësinë e agjentit tatimor.

Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Këlcyrë si dhe nuk ka një korespondenc me Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTRR).

Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi nuk është planifikuar si burim i krijimit tatimor. Sektori i taksave dhe tarifave vendore, duke mospatur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës (ASHKK)

Nga auditimi, u konstatua se shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyrë Sh.A., nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë. Ku për të cilat Bashkia Këlcyrë nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërimit-ndriçimit.

Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj... ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu VIII “Vlerësimi tatimor”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

### **Titulli i gjetjes nr. 3 Planifikimi i gabuar dhe jo i saktë për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022**

-Taksa mbi tokën bujqësore, për vitin 2022 realizimi paraqitet në masën 50.6% ose nga 2,300 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 1,163 mijë lekë.

**Tabela nr. 2.7 “Mbi sipërfaqen e tokës gjithsej të ndarë sipas ligjit”**

Nr	Bashkia Këlcyrë dhe NJA	Tokë bujqësore gjithsej	Nga e cila				Familjet që kanë marrë tapi	
			Arë	Pemëtore	Vreshta	Ullishte	Nr.	Ha
1	Këlcyrë	790	778.5	3	7	1.5	436	430
2	Sukë	2172	2161	5	6	0	1021	1343
3	Ballaban	2398	2393		4	1	1005	1342
4	Deshnicë	2365	2352	6	5	2	898	1537
<b>Totali</b>		<b>7725</b>	<b>7684.5</b>	<b>14</b>	<b>22</b>	<b>4.5</b>	<b>3360</b>	<b>4652</b>

Burimi i të dhënave: Sektori i të Ardhurave

Punoi: KLSH

Referuar të dhënave të Sektorit të Menaxhimit të tokës Bashkia Këlcyrë, por edhe nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej 7725 Ha, është ndarë 4652 Ha dhe janë pa ndarë 3073 Ha.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë së saj, dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu nëse vërejmë pasqyrat e mëposhtme do të konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme përse i përket taksës së tokës bujqësore. Kjo tregon se Sektorin e Taksave dhe Tarifave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë, dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.

Nr	Bashkia Këlcyrë dhe NJA	Sip e tokes gjithsej ha	Numri i familjeve gjithsej	Marre toke nga AMTP sip.ha	Marre toke e AMTP familje gjithsej
1	Këlcyrë	790	436	430	436
2	Sukë	2172	1021	1343	1021
3	Ballaban	2398	1005	1342	1005
4	Deshnicë	2365	898	1537	898
<b>Bashkia Këlcyrë Totali</b>		<b>7725</b>	<b>3360</b>	<b>4652</b>	<b>3360</b>

Nga tabela sa më sipër vihet re se në Bashkinë Këlcyrë janë posedues të tokës bujqësore sipas ligjit, gjithsej **3,360** familje dhe që duhet ti nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajtshme sipas kuadrit ligjor.

**Tabela nr. 2.8 “Fondi i tokës bujqësore klasifikuar sipas kategorisë”**

Nr	Nj. Administrative	Kategoria 4	Kategoria 5	Kategoria 6	Kategoria 7	Sip. Tot. Ha
1	Këlcyrë	-	254	-	176	430
2	Sukë	-	97	505	741	1,343
3	Ballaban	-	108	394	840	1,342
4	Deshnicë	-	294	1,072	171	1,537
<b>Shuma/hektar</b>		<b>-</b>	<b>753</b>	<b>1,971</b>	<b>1,928</b>	<b>4,652</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë

Punoi: KLSH

Në Bashkinë Këlcyrë rezulton se toka bujqësore u përket kategorive IV deri VII, sipas përkatësisë, Kategoria e V 753 Ha, kategoria VI 1,971 Ha dhe kategoria VII 1,928 Ha. Gjithsej fondi i tokës bujqësore për Bashkinë Këlcyrë është **4,652** Ha.

**Tabela nr. 2.9 “Vlerësimi i tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/cmimit”**

Nr.	Kategoria/tokë	Cmimi/ha/vit	Sipërfaqja/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit 2022
2	Kategoria V	1,250 lekë	753	941,250	
3	Kategoria VI	1,200 lekë	1971	2,365,200	
4	Kategoria VII	1,100 lekë	806	2,120,800	
6	<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>4,652 hektar</b>	<b>5,427,250</b>	<b>2,300,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë

Punoi: KLSH

- Nga sa më sipër diferenca në planifikim është **3,127,250** lekë për vitin 2022 (5,427,250 - 2,300,000), gjë e cila ka sjell të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë për vitin 2022 në vlerën **3,127,250** lekë.

**Kriteri:** Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 ku cilësohet: *“Taksa mbi tokën bujqësore 1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nën kategorizime. 2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji. 3. Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. 4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë ose komunës, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme”.*

**Impakti:** Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe koordinim i gabuar midisi sektorëve në marrjen e informacionit.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej **3,127,250 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

**Titulli gjetjes :** *Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**Situata:** Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Gjirokastrë, u konstatua se. Për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 31.12.2022), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej **3** persona për vlerë takse të llogaritur prej 72,322 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2022 kanë paguar detyrimet 1 persona me vlerë 25,928 lekë dhe nuk kanë paguar detyrimet 2 persona në vlerën 46,394 lekë vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Këlcyrë për vitin 2022. Referuar periudhës përpara vitit 2022 rezultoi se nuk kanë paguar detyrimin **5** persona me vlerë **142,360 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë përpara vitit 2022. Në total debia nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë është në vlerën 188,754 lekë. ***Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 3 pika pika 2.6 Bashkëlidhur raportit të auditimit.*** Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Këlcyrë, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Gjirokastrë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie, si dhe vendosjen e barës së sigurisë hipotekore në kartelat shoqëruese deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Kriteri:** Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Mos menaxhim i mirë, veprime në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë në vlerën **188,754 lekë**.



**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave drejtuese në zbatimin e ligjit.

**Rëndësia: I lartë.**

**Rekomandimi**

Spektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **188,754 lekë** ndaj **7 personave**.

**Titulli gjetjes:** *Puna e pamjaftueshme e agjentëve tatimorë në arkëtimin e detyrimeve dhe neglizhencia e strukturave të Bashkisë Këlcyrë në menaxhimin e situatës.*

**Situata:** Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Këlcyrë (*brenda datës 5 të çdo muaji*), gjë e cila konstatohet nga fakti se në vitin 2022 nuk ka asnjë arkëtim.

Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Gjrokastër në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korespondencë me Ministrinë e Financave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithëshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”.

Për sa më sipër, u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Këlcyrë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjorbitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

**Kriteri:** Neni 117<sup>3</sup> të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkia, nga mos arkëtimin dhe derdhja në buxhet i detyrimeve që arkëtohen nga agjentëve tatimorë.

**Shkaku:** Neglizhencë e strukturave përgjegjëse në zbatimin e legjislacionit për agjentët tatimor.

**Rëndësia: E mesme**

**Rekomandimi**

---

<sup>3</sup> “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifën e mbledhura, apo i shmangjet mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjatë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së përmbledhura apo të shmangur.”

Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mbledhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

**Titulli i gjetjes *Mbi aplikimin e tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.***

Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnicë, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.**

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që tregtojnë karburante në Bashkinë Këlcyrë për vitin 2022, paraqiten 4 subjekte si më poshtë:

NR	Emërtimi i Subjektit	ADRESA	Data e fillimit të Aktivitetit	Autorizim / Licencë
1	D	KËLCYRË	20.10.2015	Pajisur me autorizim 1 vjeçar për vitin 2022 dhe 2023
2	E	KËLCYRË	01.12.2011	Nuk është pajisur me licencë për 5 vjeçarin e I-parë deri 12/2016 si dhe nuk është bërë rinovim për 5 vjeçarin e II-dytë deri 12/2021 si dhe për 5 vjeçarin e III –të deti 12/2026
3	D	KËLCYRË	12.01.2015	Nuk është pajisur me licencë për 5 vjeçarin e I-parë deri 01/2020 si dhe nuk është bërë rinovim për 5 vjeçarin e II-dytë deri 01/2025
4	A	KËLCYRË	05.01.2018	Nuk është pajisur me licencë

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim, për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas pasqyrës si më poshtë:

**Tabela nr.2.3.11 “Pasqyra përmbledhëse e subjekteve që nuk ka likuiduar tarifën e licencimit/autorizimit”**

NR	Emërtimi i Subjektit	Data e fillimit të Aktivitetit	Afati i përdorimit të licences	Periudha e shfrytëzimit të Aktivitetit	Pagesa sipas VKM nr.344, dt. 19.04.2017		Pagesa sipas VKM nr.344, dt. 19.04.2017		Diferenca për pagesë
					Pikë shitje	Stac Shitje	Pikë shitje	Stac Shitje	
1	D	20.10.2015	10/2023	8 vjet	200,000	2,000,000		400,000	1,800,000
2	E	01.12.2011	12/2016 -12/2021 dhe 12/26	15 vjet	300,000	3,000,000			3,300,000
3	D	12.01.2015	01/2020 dhe 01/2025	6 vjet	200,000	2,000,000			2,200,000

NR	Emërtimi i Subjektit	Data e	Afati i përdorimit të licences	Periudha e shfrytëzimit	Pagesa sipas VKM nr.344, dt. 19.04.2017		Pagesa sipas VKM nr.344, dt. 19.04.2017		Diferenca për pagesë
4	A	05.01.2018	01/2023	5 vjet	100,000	1,000,000		400,000	700,000
					<b>800,000</b>	<b>8,000,000</b>		<b>800,000</b>	<b>8,000,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Titulli gjetjes:** *Mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i Licencave/Autorizime të subjekteve që tregtojnë karburante.*

**Situata:** Gjatë auditimit, u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (*sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas*), në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Në këtë njësi vendore operojnë katër subjekte të tregtimit të karburanteve sipas tabelës se sipërcituar.

-Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnicë, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 8,000,000 lekë**, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

**Kriteri:-** Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35 ku cilësohet:

“1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur:

a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;

b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.

2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent”.

- VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II, kapitulli III, pika 4, ku cilësohet:

**II. Procedura për dhënien e autorizimeve**

*Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.*

**III. Pagesat**

*Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues. Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:*

- 1. për lejet e tregtimit të llojit "A" 500 000 lekë*
- 2. për lejet e tregtimit të llojit "B" 200 000 lekë*
- 3. për lejet e tregtimit të llojit "C" 200000 lekë*
- 4. për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazi të lëngshëm, vajrash lubrifikante dhe të stacioneve të mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm 100 000 lekë.*
- 5. për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse 50000 lekë.*

*Tarifat për përsëritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave të mësipërme.*

*- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës "b" ku cilësohet:*

*II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

*1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njërive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:*

*b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njërive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.*

*9. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe **2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.***

*- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

*"9. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.**"*

*10. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe **200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.***

*- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

*"10. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.**"*

*"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

**-VKM nr. 344, datë 19.04.2017,** për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

**Impakti:** E ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë, identifikuar si mungesë në arkëtimin e të ardhurave për realizimin e investimeve, në vlerën 8,000,000 lekë, shkaktuar nga aktiviteti i paligjshëm i 4 subjekteve dhe mospagim të detyrimeve.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave në zbatimin e kuadrit ligjorë.

**Rëndësia: I lartë**

**Rekomandimi**

Spektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Këlcyrë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **8,000,000 lekë** nga 4 subjektet, *respektivisht;*

-Subjekti **D.**, për vlerën prej **1,800,000 lekë**.

-Subjekti **E.**, për vlerën prej **3,300,000 lekë**.

-Subjekti **D.**, për vlerën prej **2,200,000 lekë**.

-Subjekti **A.**, për vlerën prej **700,000 lekë**.

**Titulli gjetjes :** Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022.

**Situata:** Nga informacioni i paraqitur nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Këlcyrë dhe auditimi i tyre, u konstatua se gjendja e debitorëve sipas periudhave objekt auditimi është si vijon:

Emertiminjesive	Gjendja fund 31.12.2021	Pakesime 2022	Shtesagjatevitit 2022	Gjendjanë fund vitit 2022
<b>BIZNESE</b>				
BIZNESI MADH	2,908	-	1,116	4,024
BIZNESI VOGEL	11,389	-	1,371	12,760
<b>FAMILJARE</b>	7,198	-	1,558	8,756
TOKA	42,190	-	4,498	46,688
<b>TOTALI</b>	<b>63,685</b>	-	<b>8,543</b>	<b>72,228</b>

Burimi: Spektori i Taksave dhe tarifave vendore

Nga të dhënat konstatohet se gjendja e debitorëve më 31.12.2022 është në shumën **72,228 mijë lekë**, ku debitorët familjarë zënë 76.7% të totalit të debitorëve, gjë e cila tregon se nga Zyra e taksave Këlcyrë nuk punohet në drejtim të arkëtimin të tyre në zbatim të dispozitave ligjore dhe mundësive të gjetjes së rrugëve, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

Në krahasim me vitin 2021, gjendja e debitorëve vjen në rritje, ku në fund të vitit 2021 vjen në vlerën 63,685 mijë lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 72,228 mijë lekë **ose me rritje në vlerën 8,543 mijë lekë.**

Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Këlcyrë, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, **veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhura për Bashkinë Këlcyrë, në vlerën 72,228 mijë lekë për vitin 2022.**

Gjithashtu, nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk është vijuar me procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, ku rezultojnë debitorë (fizik/juridik) me vlerë **16,784 mijë lekë**, janë debitorë në vite.

**Kriteri:** Në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve<sup>4</sup>, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.

**Ndikimi/Efekt:** Mungesa e të ardhurave në vlerën **72,228 mijë lekë**, sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disjelojnë taksat dhe tarifatat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **72,228 mijë lekë**, si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gjirokastër për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të këqinj.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

---

<sup>4</sup> “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

**Titulli gjetjes:** *Mbi dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor.*

**Situatë:** Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Këlcyrë, në lidhje me kontratat e qirave për pyje dhe kullota, rezultoi se:

- Nga Bashkia Këlcyrë për periudhën e vitit 2022, ka lidhur **30** kontrata për vlerën prej **334,000 lekë**, të cilat janë likuaduar totalisht sipas **aneksit nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.**

**Konstatohet se** Kontratat në çdo rast nuk kanë bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (*sipas vendimit të Komisionit të Ndarjes së Kullotave apo vendimit të këshillit të komunës*).

- Kontratat i referohen hartës bashkëlidhur çdo kontrate, kur në fakt nuk administrohet një dokument i tillë, por vetëm një skicë e thjeshtë e cila nuk është miratuar nga titullari i institucionit apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij si p.sh. komisioni për dhënien me qira të pyjeve e kullotave.

- Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfituar kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.

- Lidhja e tyre përgjithësisht është bërë në mungesë të konfirmimit (vërtetimit) të numrit të bagëtive, dokument i cili lëshohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare, dhe konfirmon regjistrin e bagëtive dhe matrikullit të tyre sipas sistemit “Ruda”, duke mos bërë krahasimin e llojit dhe numrit të krerëve sipas kontratës me regjistrin e DRSHV, për secilin vit, dhe eliminimit të rasteve të lidhjes së kontratave me persona të cilët nuk figurojnë të regjistruar në listën e blegtorëve.

- Nuk është kryer inventarizimi kadastrale pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

- Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.

- Nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullosor.

- Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.

- Nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave në ish-ZVRPP Gjirokastër, sot ASHK Drejtoria Gjirokastër.

- Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.

- Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.

- Nuk janë përcaktuar kritere lidhur me afatin i cili duhet të jetë një vjeçar dhe pagesa të behët e menjëhershme në momentin e kontratës.

**Kriteri:** në referim të nenit 5 “*Planet e Mbarështimit*”, nenin 6 “*Funksionimin e Shërbimit Pyjor*”, nenin 15/2 “*Pronësia e Fondit Pyjor*” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005; nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “*Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010; Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “*Për fondin kullosor*”, neni 5, pika 2/b “*Pronësia*”, neni 7 “*Inventarizimi*”, neni 8 “*Regjistrimi*”, neni 9 “*Regjistri i fondi kullosor*”, neni 14 “*Planet e mbarështimit*” dhe neni 15 “*Bimët mjekësore*”, neni 29 “*Organet e kontrollit*”, neni 30 “*Dokumentimi*”, por dhe 33

“Vlerësimi i dëmit” dhe 34 “Kundërvajtjet Administrative”; VKM nr. 799, datë 29.9.2010, “Përcaktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”; VKM nr.22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal”, pika 3 e vijim, duke mos gjetur zbatim dhe pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006.

**Impakti:** Lidhja e kontratave në kundërshtim me ligjin, çojnë në keqadministrim të pronës publike.

**Shkaku:** Mos njohje e kuadrit ligjor nga personat përgjegjës

**Rëndësia:** I mesëm.

**Për këtë rekomandojmë:**

- Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të kërkoj në Këshillin Bashkiak, një ndryshim të strukturës organizative të bashkisë, duke krijuar Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe pronës publike, pjesë përbërëse e të cilës duhet të jenë Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave.

- Për të gjitha kontrata e dhënies me qira të fondit pyjor e kullor, duhet të krijohet dosje individuale, ku të pasqyrohen qartazi të gjitha të dhënat mbi fermerin, llojin e bagëtive që mbarështon, numrin e tyre, si dhe vërtetimin nxjerrë nga sistemi RUDA me të dhënave e marra nga AZHBR, si dhe parcela kullimore e dhënë në përdorim, sipas skicës së miratuar dhe të bashkëlidhur çdo kontrate.

- Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa që kontratat për sipërfaqet kullimore të jepen në raport me numrin e krerëve që disponon çdo subjekt sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare (dokumenti i cili duhet të shoqërojë kontratën) dhe të dhënave të AZHBR (sistemi Rud), mbi numrin e krerëve të deklaruar dhe regjistruar në këtë sistem.

**Titulli i gjetjes 9:** Mos arkëtim për tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit.

**Situata:** Nga auditimi i subjekteve të ndërtimit të cilat kanë kryer punime dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe Njësive Administrative në vartësi për periudhën 01.07.2020-31.12.2022, për tarifën vendore, në bazë të paketës fiskale me vendim nr.86 datë 26.12.2019, vendimi nr.39 datë 28.12.2020 dhe vendimin nr. 46, datë 22.12.2021 “Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore”. Bazuar në evidencën e prokurimeve ku subjektet që janë kualifikuar si oferta e vlefshme dhe kanë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve në territorin e Bashkisë janë të pasqyruara në pasqyrën vijuese.

Nr	Subjekti	V.kontratës (pa tvsh)	Lloji i taksave dhe tarifave sipas kontratës (Pastrim, ndriçim dhe gjelbërim)			
			Totali vjetor	T.P sipas kontratës	Detyrim	Debitor lekë
1	2	15,164,120	115,000	3 muaj	28,800	<b>28,800</b>
2	B	246,939,596	115,000	7 muaj	67,000	<b>67,000</b>
3	Sh	36,800,000	115,000	3 muaj	28,800	<b>28,800</b>
4	2	16,478,713	115,000	3 muaj	28,800	<b>28,800</b>
	<b>Totali</b>					<b>153,400</b>



Nga auditim i dokumentave këto subjekte nuk kishin paguar tarifave vendore si e pastrimit, gjelbërim e ndriçim, Sektori i të Ardhurave Vendore Bashkia Këlcyre, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 01.07.2020-31.12.2022 sipas paketës fiskale Vendimit të Këshillit të Bashkisë Këlcyre me vendim nr.86 datë 26.12.2019 dhe vendimi nr.39 datë 28.12.2020 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1/1. Këto subjekte janë debitorë në vlerën **153,400 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara** për Bashkinë Këlcyre.

**Kriteri:** 1).Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, neni 35

2) Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1/1

3) Vendimit të Këshillit të Bashkisë Këlcyre nr. 86 datë 26.12.2019 dhe vendimi nr. 39 datë 28.12.2020 dhe vendimin nr. 46, datë 22.12.2021 “Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore”.

**Impakti:** -Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve në bashki.

**Shkaku:** Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse dhe në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e kësaj drejtorie.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandim:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyre, të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **153,400 lekë**, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Këlcyre, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik.

**Për sa më sipër** Për periudhën objekt auditimi dhe shkeljet e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi punonjësit e mëposhtëm:

- znj. L.J. me detyrë përgjegjës në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- z. M.Ç. me pozicion Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- z. I.K. pozicion Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

**Pika 3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

***Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2022.***

***Për vitin 2022***, Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së

*përgjithshme*” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Përmet me shkresën Nr. 799 prot., datë 27.03.2023, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flow).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave. (*Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 1 e Pozicionit Financiar bilanci i v. 2022*)

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

• ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Këlcyrë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Përmet si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

• ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

**Për vitin 2022** nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.

➤ ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikes si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti nuk është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në programe kompiuterike “Excel”.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Përditësimet e veprimeve ekonomike nuk janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, magazinës, të pagave etj si dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Përsa i përket sistemimeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë jo të plotë, pasi pershkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkakun e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhenat te nevojshme qe i japin dokumentit forcen e nje prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim*

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2022.

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhen e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e celjes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

**Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në llogaritë e duhura.

**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

#### Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes

**Ekzistenca:** Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, ndërsa detyrimet nuk janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra nuk janë të paraqitura të plota në bilanc.

**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivitet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

#### Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të deri diku të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura .

**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë, por jo në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022, rakordon me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivitet dhe të Pasivitet kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivitet për vitin 2022 është **1,117,849,045** lekë dhe për vitin 2021 është **1,137,209,996** lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zberthyer në llogari sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

## **A. AKTIVE AFATSHKURTRA.**

**Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2022**

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 “Disponilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën **25,153,484 lekë**.

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Përmet kjo llogari është për vlerën **25,153,484 lekë**. Konstatohet se “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”.të paraqitur është e rakorduar me shumën e “Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre” në vlerën **25,153,484 lekë** e pasqyruar në formatin nr. 1.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte” paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Sa më sipër llogaria 520 “Disponilitete në Thesar” e rakorduar me të dhënat e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor, *sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.*

-Gjendja e llogarisë **32 “Inventar i imët”** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 10,280,990 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 10,475,141 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

**Titulli gjetjes:** *Kontabilizimi i gabuar i llogarisë 468 Debitorë të ndryshëm”*

### **Situata:**

Llogaria **468 “Debitorë të ndryshëm”** për vitin 2022, paraqitet në vlerën 28,796,938 lekë e cila përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Lëvizja e llogarisë e rakorduar me SIFQ paraqitet si vijon:

Nr.	Llogarite Ekonomike Sipas modeleve			Gjendja me 31/12/2022		Ngarkimi ne SIFQ	
	3/shifrore	4/shifror	7/shifrore	Institucioni	SIFQ	Shtese	Pakesim
	468	4682	4682000	28,796,938	6,078,720	22,718,218	0.00

Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se shtesa prej **22,718,218 lekë i përket debitorve nga biznesi**. Nga rakordimi me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Këlcyrë, janë evidentuar detyrimet në fund të vitit 2022 në vlerën **72,228,000 lekë** detyrimi paraqitet si më poshtë vijon:

Emertiminjesive	Gjendja fund 31.12.2021	Pakesime 2022	Shtesagjatevitit 2022	Gjendjanë fund vitit 2022
<b>BIZNESE</b>				
BIZNESI MADH	2,908	-	1,116	4,024
BIZNESI VOGEL	11,389	-	1,371	12,760
<b>FAMILJARE</b>	7,198	-	1,558	8,756
TOKA	42,190	-	4,498	46,688
<b>TOTALI</b>	<b>63,685</b>	-	<b>8,543</b>	<b>72,228</b>

Pra nuk është pasqyruar vlera e saktë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe kundër partinë Klasa 7 e llogarive “Të ardhurat”, për rrjedhojë nuk janë njohur si të ardhura për vitin 2022 në vlerën **72,228 mijë** lekë.

*Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.*

**Kriteri:**

ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku citohet:

*“Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga:*

- *Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm.*
- *Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm.*

*Të drejtat. Funksionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitohen (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116).*

*Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve).*

*Funksionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë:*

*a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat:*

- ***Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit);***
- *Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve direkte);*
- ***Kreditohet klasa 7 me analiza;***
- *Kreditohet 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje).*

*b) Arkëtohen të drejta të konstatuara:*

- *Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza;*
- *Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza.*

*c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:*

- *Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);*
- *Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;*
- *Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)”*

**Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformimi i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të taksave dhe tarifave të arkëtueshme paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

**Shkaku:**Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

-Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke e debituar për vlerën 72,228 mijë lekë

në fund të vitit 2022. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

**Titulli i Gjetjes:** *Mbi kontabilizimin e kontratave të investimit dhe njohjes së të drejtës për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit për këto investime publike për vitin 2022.*

**Situata:**

**Llogaria 4342** “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2022)” në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 8,524,875 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021 të cilat trashëgohen në vitin 2022, e cila në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 28,453,410 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 6,153,280 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 201,001 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,170,594 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 0 lekë, cka ka sjell një nënvlersim të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” në vlerë 28,453,410 lekë, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij.

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij ku citohet:

*“Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njërive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta”), subjektit i lind e drejta e regjistrimit të pjesës së mbetur të kontratës në vitin përkatës, pasi i ka zbritur likuidimet e vitit, të regjistroj të drejtën në 4342 Operacione me shtetin me kundërpartit të ardhurën 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

**Impakti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyrë ndaj shtetit për angazhimet e ndërmarra me fondet nga buxheti i shtetit, të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

**Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, neni 10 dhe 11; të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i shfuqizuar, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Rëndësia:** - E Lartë.

### **Rekomandime:**

Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023.

### **II. AKTIVET AFATGJATA**

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në vlerën neto paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,016,445,197 lekë.

Klasa 20 “ Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- Gjëndja e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 100,204 lekë. sipas akt rakordimit me degën e thesarit Përmet, në vlerë historike si vijon:

<b>Struktura</b>	<b>Emertimi Asetit</b>	<b>Vlefte date 31.12.2021</b>	<b>Shtesat 2022</b>	<b>Pakesime t 2022</b>	<b>Fund Viti 2022</b>
2020100	Studime dhe kerkime (2302100)	5,835,481	0	0	5,835,481
	<b>Shuma</b>	<b>5,835,481</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>5,835,481</b>

**Titulli i gjetjes:** *Mangësi të dhënash në pasqyrimin e llogarisë 202 “Studime e Kërkime”*

### **Situata:**

- Gjëndja e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 100,204 lekë. Paraqitja e kësaj vlere në pasqyrat financiare, nuk mbështetet me dokumentacion, pasi struktura e financës nuk administron dokumentacion për analizën analitike të kësaj llogarie. Si e tillë, konstatohet se nuk ka informacion nëse vlera e studimeve dhe projekteve i përkasin objekteve të përfunduara apo jo, duke mos dhënë siguri për vlerën e saktë të llogarisë 202 në pasqyrat financiare.

### **Kriteri**

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me **Udhëzim e MFE nr. 8**, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Aneksi 1** “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me **VKM nr 783**, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrueshme Patrupëzuar”**Pika 1/b** “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “*Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202*” “*Studime dhe Kërkime*”.

**Impakti:**- Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

### **Shkaku:**

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizimit të aktiveve.

**Rëndësia:**E Lartë

### **Rekomandimi**

Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Këlcyrë të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projekteve sipas investimeve të kryera dhe për cdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe



Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

### **Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM në vlerën prej **1,016,344,993** lekë sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022 përbëhet nga:

- Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 365,492,210 lekë;
- Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujre” në vlerën 627,911,271 lekë;
- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 1,230,679 leke;
- Llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 14,041,401 lekë; dhe
- Llogaria 218 “inventar ekonomik” në vlerën 7,669,432 lekë.

Në vitin paraardhës 2021, vlera totale neto e AAM-ve paraqitet në shumën 1,044,228,587 lekë.

Duke analizuar veprimet e shtesave të AAM-ve vlerësuar me koston historike, sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës paraqiten në aneksin nr. 3 bashkëlidhur project raportit të auditimit.

- **Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 0 lekë për vitin 2022 dhe e pandryshuar krahasuar me vitin e mëparshëm 2021.
- **Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” për vitin ushtrimor 2022** paraqitet prej 0 lekë dhe e pandryshuar krahasuar me vitin e mëparshëm 2021.

**Titulli i gjetjes:** *Mangësi në regjistrin kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.*

### **Situata:**

Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të paraqitur 0 lekë në bilanc, në kundërshtim me VKM nr.433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

**Kriteri:** VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”.

**Ndikimi/Efekti:** Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë inventarizimin e përvitshëm të tyre, sjell mos pasqyrim të saktë të këtyre vlerave, si rrjedhojë e mungesës së informacionit në mënyrë analitike, për secilin aset si pasojë e mungesës së një regjistri kontabël.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, torje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

**Titulli i gjetjes:** *Mangësi në regjistrin kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.*

**Situata :**

-Llogaria **212 “Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 357,824,654 lekë, më 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie rezulton 365,492,210 lekë me një ritje në vlerë neto 7,667,556 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit 2022.

-Llogaria **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 660,839,287 lekë, më 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie rezulton 627,911,271 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese dhe vlerën e amortizimit.

-Llogaria **214 “ Instalime teknike, makineri e paisje”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Këlcyrë dhe ish Komunat, në fund të vitit 2021 rezulton për vlerën 1,521,444 lekë dhe në fund të vitit 2022 për vlerën 1,230,679 lekë ose me ulje në vlerën neto 290,765 lekë.

-Llogaria **215 “Mjete transporti”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Këlcyrë dhe ish Komunat, në fund të vitit 2021 rezulton për vlerën 16,289,327 lekë dhe në fund të vitit 2022 për vlerën 14,041,401 lekë me një ulje në vlerën neto 2,247,926 lekë që i përket vlerës së amortizimit.

Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2022, është marrë bruto nga pasqyrat financiare. Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik cdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Spektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2022, Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

*Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.*

*Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues.*

*Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). Nën-pika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2, Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata jo materiale".*

*Pika 33. Llogaritë përkatëse në klasën 2 funksionojnë si më poshtë vijon:*

*a) Për shtesat nga rivlerësimi:*

*Do të debitohen llogarit e klasës 2 të aktiveve afatgjata; dhe*

*Do të kreditohet llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve"*

**Kriteri:**

UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nën-pika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

**Impakti:** Mungesa e regjistrimit të AAGJ si dhe mos pasqyrim i saktë i vlerës neto të aktiveve afatgjata materiale nga përlllogaritja e gabuar e amortizimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të AAGJ, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

**Shkaku:** Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për inventarizimin e disa prej AAGJ e evidentimin e tyre me të gjitha të dhënat në regjistrin e aktiveve si dhe llogaritjen e pasaktë të amortizimit.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Këlcyrë të marrë masapër kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrimit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

-Llogaria **218 "Inventar ekonomik"** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Këlcyrë dhe ish Komunat, në fund të vitit 2021 rezulton për vlerën 7,753,875 lekë dhe në fund të vitit 2022 për vlerën 7,669,432 lekë ose me ulje në vlerën neto 84,443 lekë, në përputhje me UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet " Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara", ndryshuar me UMFE nr.5/2022.

**- Testi substancial i amortizimit**

**Qëllimi:** Ripërdorimi i amortizimit duke u bazuar në udhëzimin nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të ripërfomuar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet. Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF paraqitet në aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur project raportit të auditimit.

**3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare,** ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk janë kryer veprime të tilla, për rrjedhojë gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet me zero.

- **Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2022, paraqiten në vlerën 0 lekë. Ky vlerësim financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jomateriale sipas tabelës mëposhtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 78,374,385 lekë si vijon;

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0
2	Aktive Aftagjata materiale	78,374,385
<b>3</b>	<b>Totali</b>	<b>78,374,385</b>

*Burimi: Bashkia Këlcyrë*

Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata.

**Titulli gjetjes:** Mbi llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare”

**Situata:**

Bashkia Këlcyrë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 26.06.2023 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA, e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 21,259,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 21,259,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Këlcyrë në “Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Në rastin tonë investimi përfaqëson aksionet me vlerë kontabël (kosto) 21,259,000 lekë dhe investitori është Bashkia Këlcyrë, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale” pika 55, 56,

57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

**Kriteri:**

Urdhri e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmisuar”, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57.

**Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2022, të llog 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, gjendje kjo e nënvlerësuar me vlerë 21,259,000 lekë.

**Shkaku:**

Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

-Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA me vlerë kontabël **21,259,000 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.**

**1.Nënrubrika, llogari të pagueshme,** gjendja e llogarive të 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, të 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, -të 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, të 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, të 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, nuk është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 8,524,875 lekë për vitin 2022. E analizuar për vitin 2022 për vlerën **36,978,285 lekë përbëhet** dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2022
1	Paga Personeli llogaria 42	6,153,280
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	201,001
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,170,594
4	Furnitorëllogaria.401-408	28,453,410
	<b>TOTALI</b>	<b>36,978,285</b>

Rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara pasive**, pra në vitin 2022 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

Gjendja e llogarisë 42 “**Detyrime ndaj personelit**” në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 6,153,280 lekë e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2022.

-Gjendja e llogarisë **431 “Detyrime ndaj shtetit tatim taksa”** në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 201,001 lekë detyrimet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2022.

-Gjendja e llogarisë **435 “Sigurime shoqërore”** në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 2,170,594 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe sigurimet shendetsore për muajin dhjetor 2022.

Llogarisë 466 “**Kreditorë për mjete në ruajtje**”, më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 17,724,903 lekë, më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 10,345,394 lekë, Gjatë vitit 2022 likuidimet e kryera janë në vlerën 7,379,509 lekë sipas rakordimit me degën e thesarit Përmet:

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të paqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet në aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën **226,400,887** lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Përmet paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 7,752,280 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 5,000 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 2,452,573 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7029 “Të tjera tatime mbi Pasurine”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 46,048 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

d. Gjendja e llogarisë **7033 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 2,334,006 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

e. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 2,689,653 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 7,410,722 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 2,087,046 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 3,106,947 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

c. Gjendja e llogarisë **7113 “Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 16,000 lekë, e cila përfshin tarifatat shërbimeve, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

d. Gjendja e llogarisë **719 “Të tjera të ardhura jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 2,216,729 lekë.. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

**Analiza e llogarive të shpenzimeve** në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën **211,592,787** lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën **81,932,523 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **81,932,523 lekë** diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën **14,359,678 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **14,359,678 lekë**, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **22,606,201 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën **22,606,201 lekë**, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 422,102 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **92,466,434 lekë**, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

**Për vitin 2022** totali i të ardhurave ne vlere është **226,400,877 lekë** dhe totali shpenzimeve është **211,592,787 lekë**. Diferenca e tyre në vlerën **14,808,090 lekë** rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën - 194,151lekë .

**- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Këlcyrë).**

**-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”**

**Për vitin 2022** numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr.45 datë 22.12.2021 Miratuar në total numri 205 dhe Gjendjes Civile = 4 punonjës gjithsej, gjithsej në fakt 179 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Këlcyrë është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë-pagesat janë të firmosura nga përgjegjja e zyrës së Financës znj. V.K deri më datë 31.12.2022 dhe nga Kryetari i Bashkisë .

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Përgjegjësja e zyrës së Financës znj. V.K dhe nga Kryetari Bashkisë z. K.N.

**- Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2022.**

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2022) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të hartuara nga Kryetari i Bashkisë është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Këlcyrë, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Këlcyrë, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2022) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga përgjegjisa e zyrës së Financës znj. V.K deri më datë 31.12.2022 dhe nga Kryetari i Bashkisë .

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Kryetari i Bashkisë .

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, janë bërë ndalesa edhe për debitorët të përcaktuar në Urdhrat përkatës.

### *Veprimet nëpërmjet magazinës*

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë-daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

### **MALLRA DHE SHËRBIME (Ilogaria 602)**

#### *Ligishmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.*

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas



destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël. Në menyre të detajuar pagesa sipas llog. 602 janë sipas listës që disponon Drejtoria e Financës.

**Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi; Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Bashkisë Këlcyrë, NA, z.K.N.; Përgjegjëse e Financës NZ, znj.V.K.**

(Sa më sipër është trajtuar më gjerësisht në Akt konstatimin nr. 9 datë 27.06.2023).

**3.4. Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

**Titulli gjetjes:** Mungesa e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Këlcyrë.

**Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: për vitin 2022 struktura organizative është miratuar me vendimin e këshillit bashkiak (VKB) nr.45 datë 22.12.2021, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë Këlcyrë, institucioneve në varësi njësive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2022. Rezulton se në strukturën aktuale organizative të bashkisë Këlcyrë nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”.

**Bashkisë Këlcyrë**, pas reformës territoriale të trashëguara dhe të transferuara nga ish/Komunat dhe ish/Bashkia për periudhat raportuese 2022 për secilën njësi administrative të analizuar evidentohen sa më poshtë;

Nr	Njësitë Administrative	Prona të listuara pasuri shtet me VKM		Prona të listuara pasuri pyje e kullota		Tokë bujqësor e pandarë	
		Nr	Sip	Pyje	Kullota	VKM	Fakti
1	Njësia Adm (ish/bashkia Këlcyrë)	224	=	1,315	2,312	357	360
2	Njësia Adm (ish/komuna Dëshnicë)	66	=	3,056	1,574	806	828
3	Njësia Adm (ish/komuna Sukë)	66	=	1,345	1,408	770	829
4	Njësia Adm (ish/komuna Ballaban)	48	=	1,463	2,345	837	1056
	<b>Njësia Admi bashkia Këlcyra</b>	<b>404</b>		<b>7,179</b>	<b>7,639</b>	<b>2,770</b>	<b>3,073</b>

**Burimi i të dhënave Bashkia Këlcyrë**

Të dhënat në tabelë evidentojnë gjendjen aktuale të asetëve, pronave e pasurisë së paluajtshme të administruara, por të pa evidentuara në pasqyruarën financiare (bilanci kontabël) i njësisë

shpenzuese bashkia Këlcyrë, ndërsa këto prona pasuri të paluajtshme të trashëguara dhe të transferuara nga ish/komunat e ish/bashkia për llogari të njësinë administrative bashkia Këlcyrë (pas reformës territoriale) nëpërmjet VKM pasqyrohen sa më poshtë;

**1-**Për administrimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore të trashëguara nga (ish/bashkia Këlcyrë) për llogari të saj me VKM nr. 114, datë 03.02.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi, ose në përdorim të Bashkisë Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës” si dhe VKM nr. 530, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkisë Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës”, trajtohen mënyra dhe transferimi në pronësi, ose përdorim i pronave publike shtetërore, prona të listuara sipas lidhjeve nr.1, bashkëngjitur në secilin vendim, ku me VKM nr.114, datë 03.02.2008 janë të listuara sipas lidhjes bashkëngjitur 27 prona, ndërsa me VKM nr.530, datë 01.05.2008, janë listuar sipas lidhjes bashkëlidhur 197 prona. Ndërsa referuar informacionit dhëna nga specialisti kadastrës së bashkisë rezulton se, toka e pa ndarë gjendje në fakt evidentohet sipërfaqja 360 ha.

**2-**Për administrimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore të trashëguara nga (ish/Komuna Dëshnicë), për llogari të saj me VKM nr. 1028 datë 09.07.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, të pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Dishnicë, të Qarkut të Gjirokastrës”, trajtohet mënyra dhe transferimi në pronësi ose përdorim i pronave publike shtetërore janë të listuara sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur 66 prona. Ndërsa toka bujqësore e pandarë, objekt i dhënies me qira, njësia administrative Sukë disponon 806 ha tokë bujqësore, për të cilën nuk është bërë inventarizimi dhe konfirmimi nga Këshilli i Qarkut. Ndërsa referuar informacionit të dhëna nga specialisti i kadastrës së bashkisë rezulton se, toka e pa ndarë gjendje në fakt evidentohet sipërfaqja 828 ha.

**3-**Për administrimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore të trashëguara nga (ish/Komuna Sukë), për llogari të saj me VKM nr. 331 datë 19.03.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, të pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Suk, të Qarkut të Gjirokastrës”, trajtohet mënyra dhe transferimi në pronësi ose përdorim i pronave publike shtetërore janë të listuara sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur 66 prona. Ndërsa toka bujqësore e pandarë, objekt i dhënies me qira, njësia administrative Sukë disponon 770 ha tokë bujqësore, për të cilën nuk është bërë inventarizimi dhe konfirmimi nga Këshilli i Qarkut. Ndërsa referuar informacionit dhënë nga specialisti kadastrës në bashki rezulton se, tokë pandarë gjendje në fakt evidentohet sipërfaqja 829 ha.

**4-**Për administrimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore të trashëguara nga (ish/Komuna Ballaban), për llogari të saj me VKM nr.283, datë 12.03.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, të pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Ballaban të Qarkut të Gjirokastrës”, në të cilin trajtohen mënyra dhe transferimi në pronësi ose përdorim të pronave publike shtetërore të ish/Komuna Sukë, sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur të cilat janë 48 prona të listuar. Ndërsa toka bujqësore arë e pandarë, objekt i dhënies me qira, njësia administrative Ballaban disponon 837 ha tokë bujqësore, për të cilën nuk është bërë inventarizimi dhe konfirmimi nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë. Ndërsa referuar informacionit të dhëna nga specialisti i kadastrës së bashkisë rezulton se, toka e pa ndarë gjendje në fakt evidentohet sipërfaqja 1056 ha.

Për sa më sipër bashkia Këlcyrë për periudhën raportuese 2022 u konstatuan mangësi dhe shkelje të parashikuara në ligjin nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e

pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III, pika 30 ku përcaktohet se:

“...Formati regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.” dhe pika 35/a ku citohet: “Dokumentet vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet e të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.....”.

Në këto kushte nga njësitë administrative pas përfundimit të reformës territoriale dhe riorganizimit bashkia Këlcyrë e përbërë nga (ish-Bashkia Këlcyrë, ish-Komuna Sukë dhe ish-Komuna Ballaban) për mënyrën e administrimit, dokumentimit të pasurisë dhe asetëve të paluajtshme u konstatua sa më poshtë:

**a-**Nga bashkia Këlcyrë për të konkluduar nëse procesi i miratimit të listës paraprake, nuk është kryer asnjë veprim dokumentar për afishimin dhe ballafaqimin me komunitetin dhe institucione të tjera që operojnë në territorin e bashkisë, si edhe për marrëdhëniet financiare të vlerësimit, trajtimit, mirëmbajtjes dhe përpilimit të listës përfundimtare e paraqitur për miratim, në mospërputhje me VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi specialistët përkatës.

**b-**Bashkia Këlcyrë nuk ka ngritur komision për të marrë në dorëzim asetet, nuk ka kryer marrjen në dorëzim, kolaudimin, vlerësimin, nuk ka kryer inventarizim fizik dhe regjistrim kontabël, njëkohësisht nuk ka aplikuar pranë ZVRPP Përmet për të bërë regjistrimin këtyre pasurive, në mospërputhje me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” pikat 20; 21; 22 dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 37; 42 deri 60; 74.

**c-**Bashkia Këlcyrë nuk ka marrë me procesverbal dorëzimi të nënshkruar nga përfituesi bashkia dhe institucionet qendrore dorëzuese asetet e qëndrueshme në pronësi të të cilave kanë qenë këto prona e asete, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, administratë, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, funerali, zhvillimi ekonomik, troje të lira, infrastrukturë, strehim e mbrojtje civile, si dhe bujqësi e ushqim, të cilat duhej të ishin shoqëruar me harta dhe me të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre, etj, në mospërputhje VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

**d-**Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar përmbledhësen e bashkimit të listave të asetëve dhe pronave të transferuara nga ish/Komuna Dishnicë, Sukë, Ballaban dhe ish/Bashkia për të pasqyruar pasuritë e paluajtshme të njësisë Bashkia Këlcyrë (pas reformës territoriale) me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Këlcyrë.

Në këto kushte rezulton se Bashkia Këlcyrë (pas reformës territoriale) nuk ka menaxhuar mirë situatën e asetëve të paluajtshme në pronësi dhe në përdorim si rezultat i mos regjistrimit të të

drejtave të pronësisë apo përdorimit, moskryerjes në përputhje me përcaktimet ligjore të procesit të inventarizimit dhe marrjes së tyre në dorëzim, mos ushtrimit të kontroleve dhe saktësisë të kufijve të pronave, numrave të pasurisë sipas zonave përkatëse kadastrale, mosshfrytëzimit të tyre në formën e qiradhënies, përfshi edhe tokat bujqësore të pandara në dispozicion, veprime në mospërputhje me VKM nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1 ku citohet: “Bashkia është trashëgimtari ligjor i njësisë të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të. Bashkia me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësisë të qeverisjes vendore që janë shkrirë, përfshirë edhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë”.

**e-Bashkia Këlcyre** nuk ka hapur regjistrin kontabël të aktiveve, ndërsa nga nëpunësi autorizues nuk është caktuar nëpunësi zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim njësi administrative bashkia Këlcyre, në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26; 27,

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Bashkisë Këlcyre, NA, z.K.N; Përgjegjëse e Financës NZ, znj.V.K.**

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

**Ndikimi/Efekti:**Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

**Shkaku:**Mungesa e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Këlcyre.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi** - Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet si dhe për krijimin e regjistrit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF.

**Pika 4.1-4.3. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik**

**Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve**

Në dosjet e prokurimit nuk administrohen dokumente që të vërtetojnë që nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave nuk është bërë mbi

bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, por në dosje administrohen listat prioritare për investime, të cilat janë miratuar me Vendim të KB vitit 2020, 2021 dhe 2022 bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

### **Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara**

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Këlcyrë (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën objekt auditimi nga 01.07.2020 deri më 31.12.2022, Bashkia Këlcyrë ka realizuar 6 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 355,431,996 lekë, vlerë të lidhjes së kontratës 324,224,218 lekë dhe diferencë midis tyre në vlerën 24,593,613 lekë, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

	Objekti i prokurimit	Loji i procedurës së prokurimit	Data e zhvillimit te procedurës se prokurimit	Data e lidhjes se kontratës	Fondi limit pa TVSh	Vlera e kontratës pa TVSh	Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës	OE Fitues	Audituar ose jo
1	Përmirësim i banesave ekzistuese		21.09.2020	3.10.2020	15,201,078	15,164,120	36,958	”2	Jo
2	Karburant per automjetet	“Kërkesë për propozim”	08.03.2021	2021	6,602,310	17.9%		D	Po
3	Ndërtim Ujësllësish për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)”	E hapur	06.05.2021	29.06.2021	252,277,207	249,483,204	2,794,003	H	Po
4	Sistemim asfaltim I rruges Ura e Mbrezhanit - Malshove	“E hapur , Punë”	07.09.2021	08.02.2021	58,333,333	36,800,000	21,533,333	Sh	Po
5	Karburant për automjetet	“Kërkesë për propozim”	16.05.2022	06.06.2022	6,527,500	6,385,494	142,006	A	Po
6	Përmirësimi banesave ekzistuese	“E hapur , Punë”	20.09.2022	21.010.2021	16,478,712	16,391,400	87,313	2	Po
	<b>Totali</b>				<b>355,431,996</b>	<b>324,224,218</b>	<b>24,593,613</b>		

*1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Ndërtim Ujësllësish për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)”, vlerë të fondit limit 252,277,207 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021.*

<i>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim Ujësllësish për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban &amp; Sukë)”,. REF-91451-03-29-2021</i>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> nr.615 prot., datë 25.03.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin</b> nr.615 prot., datë 25.03.202: S.V, J.N, F.S	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</b> Urdhër nr. 615/1 Prot.,datë 25.3.2021: B.A., A.Q, S.K
<b>2.Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur , Punë”		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 252,277,207 lekë	<b>6.Oferta fituese:</b> H me vlerë 249,483,204 lekë pa TVSh	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> 2,794,003 lekë (pa tvsh)

<b>8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit:</b> 06.05.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit	<b>10. Operoret Ekonomik</b> a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) S'kualifikuar 1 c) Kualifikuar 2 OE
<b>11. Ankimime:</b> AK: Nuk ka patur ankesa	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:</b>
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> datë 29.6.2021, Nr. 615/5 prot.	<b>15. Vlera e kontratës:</b> 249,483,204 lekë pa TVSh	16. Likuiduar deri Vlera 154,000,000 lekë, pa likuiduar vlera 142,327,515

**Burimi i financimit:** Fonde të akorduara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës të Mbetjeve.

Kontrate e lidhur me datën 29.06.2021 me Nr. Kontrate 615/5 prot.

Vlera totale e kontratës 296,327,515 leke me tvsh e ndare në katër vite si më poshtë:

Viti 2021 në shumen 60,000,000 leke me tvsh;

Viti 2022 në shumen 4,000,000 leke me tvsh;

Viti 2023 në shumen 4,000,000 leke me tvsh;

Viti 2024 në shumen 228,327,515 leke me tvsh.

Likuiduar deri më 31.12.2022 vlera 114,000,000 lekë. Likuiduar gjatë periudhës janar – 20 qershor 2023 vlera 40 milion lekë.

#### **Hartimi i kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit**

Nga titullari i autoritetit kontraktor Z. K.N. ka dalë urdhëri prokurimit nr. 615 prot, datë 25.03.2021, në të cilin është përcaktuar njësi e prokurimit e përbërë nga: nga Znj. F.S., juriste, jo punonjëse e Bashkisë Këlcyrë. Për këtë qëllim në datën 06.01.2022 është lidhur aktmarrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S., pa numër protokoll, z. J.N. me detyrë përgjegjës i zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. S.V., me detyrë ish inspektor i taksave dhe tarifave vendore, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 31.07.2022, sipas urdhrit nr. 37, datë 15.07.2022, për shkak të daljes në pension. Për hartimin e kriterëve të veçanta të DT njësi e prokurimit ka hartuar procesverbalin nr. ska, datë 25.03.2021.

Në dokumentet e tenderit nuk është përcaktuar emri i personit përgjegjës. Në këto dokumente është vendosur adresa e postës elektronike dhe në vend të emrit të personit përgjegjës për prokurimin janë shënuar inicialet F.S., inicialet e cilat nga komunikimi me Znj. F.S. dhe me subjektin e audituar, përfaqësojnë këtë person, juriste, anëtare e njësisë së prokurimit.

Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DT, seksioni i kapacitetit teknik, pika 2.3.1 “Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës”, konstatohet se në këtë pikë janë kërkuar edhe licenca të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën e kontratës që prokurohet, si:

- N.S – 9 A -Punime strukturore speciale.

Referuar VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, licenca N.S – 9 A -Punime strukturore speciale, “Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për trasmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t’u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotave të gfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilota ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të

*punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve”.* Nga auditimi konstatohet se në preventiv nuk ka zëra që të justifikojnë nevojën e licencës N.S – 9 A -Punime strukturore speciale.

Gjithashtu në pikën 2.3.2 të seksionit të kapacitetit teknik është kërkuar: Licensë lëshuar nga QKL, kodi III.2 A (1+2) për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis. Auditim mjedisor, si dhe licenca lëshuar nga QKL, kodi III.1.A, Leje Mjedisi e tipit C: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.

Kjo kërkesë është e pa argumentuar teknikisht nga autoriteti kontraktor.

*Referuar nenit 25 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”:*

*Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis. duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.*

Pra çdo vlerësim i ndikimit në mjedis është ezauruar në fazën e hartimit të projektit. Madje raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është bërë pjesë e dokumenteve të tenderit hedhur në sistemin e prokurimit elektronik. Çështja e auditimit mjedisor të kërkuar në DT, nuk i shërben AK, pasi ky auditim është pjesë e kontraktorit dhe nuk mund t’i japë garanci autoritetit kontraktor, audit i vetë i kontraktorit. Kjo do të thotë që kontraktori auditon vetveten, për llogari të autoritetit kontraktor, proces i cili nuk i shërben autoritetit kontraktor si një siguri për punimet e kryera. Autoriteti kontraktor i merr garancitë nga mbikëqyrja që i bënë vet kontraktorit.

Këto kërkesa janë të pa argumentuara teknikisht dhe të panevojshme, nuk kanë lidhje me natyrën e kontratës. Në preventiv nuk ka zëra punimesh që të diktojnë nevojën e kritereve të mësipërme.

Në pikën 2.3.4 të seksionit të kapacitetit teknik, është kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar me kohë të plotë minimalisht:

120 (njëqind e njëzet) punonjës për periudhën Dhjetor 2020 – Mars 2021 (duke përfshirë dhe muajin Mars 2021), të vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve me kohe të plote për secilin muaj.
- b. Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme.

Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 4-mujore, dhjetor 2020-mars 2021, në operatorin ofertues, është e pa nevojshme, e pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Ky kuadër ligjor nuk kërkon që të vërtetohet ekzistenca e një numri të caktuar punonjësish, për periudha të mëparshme. Numri i punonjësve nuk provon përvojën e duhur të mëparshme, në mënyrë që të vendosen afate kohore për muaj të caktuar në listëpagesë. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Për sa më sipër është në kundërshtim me: kërkesat e pikës 2, neni 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku thuhet: *Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit*".

Nga njësia e prokurimit nuk është bërë argumentimi për numrin e kërkuar prej 120 të punonjësve. Duke parë natyrën dhe tipologjinë e kontratës, konstatohet një numër i konsiderueshëm punonjësish pa përcaktuar profesionin dhe objektin e punës për të gjithë numrin 120.

Përveç kësaj, konstatohet një disbalancë e dukshme midis numrit të drejtuesve të mjeteve (shoferëve) dhe mjeteve të kërkuara që do të drejtohen prej tyre. Janë kërkuar në total 6 shoferë, por nga ana tjetër janë kërkuar në total 18 mjete që do të drejtohen prej tyre (12 kamion, 4 kamioncina, 2 autobot uji), që do të thotë se një shofer do të drejtojë 3 mjete, një raport i pa kuptimtë shofer/mjet, i cili tregon për mungesën e argumentimit për numrin e shoferëve dhe mjeteve të kërkuara.

-Gjithashtu është kërkuar një numër i konsiderueshëm makinerish, numër i cili nuk gjen argumentim teknik nga AK, argumentim i cili duhet të bëhet bazuar në kohëzgjatjen e punimeve, grafikun dhe volumin e punimeve. Kështu janë kërkuar gjithsej 12 copë kamionë vetëshkarkues me kapacitet të ndryshëm, si dhe 4 kamioncina, 3 fadromë, 6 eskavator (2 prej tyre me çekiç pneumatik), 2 minieskavator, minifadromë etj.

Veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku respektivisht thuhet: (VM 914): neni 26: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

(LPP, neni 46):*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:*

b) *aftësia teknike*: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

Për anomalitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kapacitetit teknik, ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, hartues i këtyre kriterëve, anëtar i njësisë së prokurimeve Z. J.N. Nga auditimi konstatohet se Bashkia Këlcyre nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për mbikëqyrjen e veprimtarinë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike



etj. Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi.

### **Vlerësimi i ofertave**

Nga titullari i autoritetit kontraktor z. K.N. ka dalë urdhri Nr. 615/1 Prot., datë 25.03.2021, në të cilin është përcaktuar KVO, i përbërë nga: z. B.A., me detyrë inspektor ndërtimi (i mesëm), z. A.Q., me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore, Znj. S.K. me detyrë specialiste e shërbimit social, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.03.2022.

Në datën 14.06.2021, KVO ka hartuar raportin përmbledhës, protokolluar me nr. 615/2. Me shkresën nr. 615/3 prot., datë 14.06.2021, titullari i autoritetit kontraktor z. K.N. ka miratuar procedurën e KVO (raportin përmbledhës) dhe ka shpallur fituesin.

Në tender kanë marrë pjesë tre operator ekonomik, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi
1	4	249,405,235	S'kualifikuar
2	H	249,483,204	Kualifikuar, fitues
3	C	251,098,849	Kualifikuar

Kohëzgjatja e punimeve 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit (Kriteret e vlerësimit): oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

### **Arsyet e skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik "4" ShPK**

Operatori Ekonomik "4" ka paraqitur në SPE, vetëm ofertën ekonomike të shoqëruar me preventivin e punimeve. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor teknik, ekonomik kualifikues dhe skualifikimi është i drejtë.

2.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "Përmirësim i banesave ekzistuese", vlerë të fondit limit 16,478,713 lekë, zhvilluar në vitin 2022.

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Përmirësim i banesave ekzistuese". REF-39708-08-24-2022</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> nr.1805/1 prot., Nr. 49, datë 17.08.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.1805/1 prot., Nr. 49, datë 17.08.2022: V.K, J.N, F.S</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</b> Urdhër nr. 1805/2 Prot.,Nr. 50,datë 17.8.2022: O.H, A.Q, Q.P
<b>2.Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> "E hapur , Punë"		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh) 16,478,713 lekë</b>	<b>6.Oferta fituese:</b> "2 me vlerë 16,391,400 lekë pa TVSh, ose 19,669,680 lekë me TVSH.	<b>7.Diferenca me fondin limit 87,313 lekë (pa tvsh)</b>

<b>8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit:</b> 20.09.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i shtetit	<b>10. Operatoret Ekonomik</b> a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) S'kualifikuar 2 c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime:</b> AK: Nuk ka patur ankesa	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:</b>
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
<b>14. Lidhja e kontratës Nr. 2347,</b> datë 21.10.2022	<b>15. Vlera e kontratës:</b> 16,391,400 lekë pa TVSh	16. Likuiduar deri me 20.06.2023, e gjithë vlera e kontratës

Vlera totale e kontratës 19,669,680 leke me tvsh, planifikuar likuidimi: viti 2022 ne shumen 12,174,385 leke me tvsh, viti 2023 ne shumen 7,495,295 leke me tvsh.

Likuiduar sipas grafikut të mësipërm e gjithë vlera e kontratës. Procedura pa arkivuar nga personi përgjegjës.

#### **Hartimi i kriterëve të veçanta të DT**

Preventivi për këtë investim është hartuar nga z. J.N., inxhinier ndërtimi. Me urdhrin e prokurimit nr.1805/1 prot nr. 49, datë 17.08.2022, të titullarit të AK Z. K.N, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga F.S, juriste, e kontraktuar nga jashtë Bashkisë Këlcyre, Z.V.K, jurist, me detyrë përgjegjës i Zyrës Ujitjes dhe Kullimit, Z. J.N me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Në dokumentet e tenderit nuk është përcaktuar emri i personi përgjegjës. Në këto dokumente në vend të emrit të personit përgjegjës për prokurimin janë shënuar inicialet F.S., inicialet të cilat nga komunikimi me Znj. F.S, përfaqësojnë këtë person, juriste, anëtare e njësisë së prokurimit, por nuk ka urdher për këtë qëllim nga titullari i AK.

Në pikën 2.4.1, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

#### **- 1 (një) Arkitekt**

**- Minimumi 1 (një) punonjës i pajisur me Certificate: Ekspert në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin”.**

Kërkesa për një arkitekt dhe ekspert zjarrfikës është e pa argumentuar teknikisht në procesverbalin e hartuar për argumentimin e kriterëve të veçanta të DT. Nuk ka lidhje me natyrën dhe tipologjinë e kontratës, pasi nuk ka në preventiv zëra punimesh, të cilët të diktojnë nevojën për arkitekt dhe ekspert zjarrfikës. Ky kriter është i pa nevojshëm, nuk ka lidhje të ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës dhe vjen në kundërshtim me nenin 39, pika 4, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.*

Gjithashtu nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit, konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike. Në këtë procesverbal nga njësia e prokurimit është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën autoritetit kontraktor, që gjatë hartimit të kriterëve mund t’u kërkojë ofertuesve plotësimin e një numri të caktuar kriteresh të nevojshme, por nuk është argumentuar teknikisht lidhja e kriterit të vendosur me objektin e kontratës, me zërin konkret të preventivit. Kështu nuk janë dhënë argumenta për numrin e kërkuar të punonjësve, numrin e secilës makineri, paisje të kërkuar etj. Numri i punonjësve dhe i makinerive të kërkuara duhej të argumentohej në procesverbal, duke shpjeguar lidhjen e këtij

numri me volumin e punimeve, orët e punës, grafikun e punimeve etj. Autoriteti kontraktor ka të drejtën e vendosjes së kriterëve të nevojshme që duhet të plotësojnë operatorët ekonomik, por njëkohësisht ka edhe detyrimin e argumentimit teknik të arsyes së vendosjes së këtyre kriterëve. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2, germa (c), ku thuhet:

*“Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën... argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...”*

- nenin 39, pika 6.ç, ku thuhet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

*fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

-nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, ku thuhet:

*Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.*

*2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.*

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, hartues i kriterëve të seksionit të kapacitetit teknik, anëtar i njësisë së prokurimeve z. J.N. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Këlcyre nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për mbikëqyrjen e veprimtarinë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi

#### **Vlerësimi i ofertave**

Në datën 12.10.2022, KVO ka hartuar raportin përmbledhës, protokolluar me nr.1805/7. Me shkresën nr. 1805/8 prot., datë 12.10.2022, titullari i autoritetit kontraktor z. K.N. ka miratuar procedurën e KVO (raportin përmbledhës) dhe ka shpallur fituesin.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në tender kanë marrë pjesë 3 operator ekonomik, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi
1	I	13,639,269	S’kualifikuar
	“N”	15,256,088	S’kualifikuar
	”2”	16,391,400	Kualifikuar, fitues

#### Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE I

KVO: 1. Operatori Ekonomik I nuk ka arritur te paraqese oferten e plote dhe te sakte siç është kërkuar ne DST (operatori ka paraqitur vetëm nje preventiv përmbledhës por nuk ka arritur te paraqesë preventivat për çdo njësi (shtëpi banimi) qe do te ri konstruktohet).

Nga auditimi konstatohet se konkluzioni i KVO se “operatori ekonomik I nuk ka arritur te paraqesë preventivat për çdo njësi (shtëpi banimi) qe do te rikonstruktohet”, është i saktë.

KVO: 2. Operatori nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plote dhe te sakte për te dëshmuar plotësimin e pikës 2.8 te kriterëve të veçanta për kualifikim, ku është kërkuar: *...Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzoj analizë teknike për të gjithë zërat e preventivit te ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.*

Nga auditimi konstatohet se konkluzioni i mësipërm i KVO nuk është i saktë, pasi operatori ekonomik ka paraqitur analizë teknike për të gjithë zërat e preventivit te ofertës përmbledhëse, e cila përmban zërat dhe volumin e punimeve.

#### Arsyet se skualifikimit nga KVO të OE “N&SH”

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë N&Sh, nuk plotësojnë Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.4.4 dhe pika 2.8 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

Dokumentacioni provues i formularit të vetëdeklarimit, si dhe dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, dorëzuar më datë, 22.09.2022 me prot hyrës nr.2086, nuk është i rregullt dhe konform kushteve dhe kriterëve të DST.

Konkretisht:

1. Secili prej pjesëtareve te BOE nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë për te dëshmuar plotësimin e pikës 2.4.4 te Kriterëve te veçanta për kualifikim te DST (*nuk ka paraqitur diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore per stafin Teknik te kërkuar Karpentier; Elektracist; Murator; Suvatues; pllakashtrues*).

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorëzuar fizikisht rezulton se: BOE, ka paraqitur vetëm dëshmi te kualifikimit te sigurimit Teknik dhe jo diplomë/dëshmi përkatëse te kualifikimit profesional.

Së dyti: Secili prej pjesëtareve te BOE, nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë për të dëshmuar plotësimin e pikës 2.8 te Kriterëve te veçanta për kualifikim; *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

- Kamion vetëshkarkues, 3 copë, pronësi ose me qera
- Kamionçine (kapaciteti mbajtës deri ne 3.5 (tre pike pese) ton, 2 copë pronësi ose me qira

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit qe lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;*

OE Sh, referuar shtojcës nr.8, ka paraqitur dokumentacionin fizik të rregullt vetëm për një mjet kamioçinë. Për dy mjetet e tjera kamioçinë ka paraqitur dokumentacion jo të rregullt. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezultoi se ka skaduar certifikata e kontrollit teknik me date 12.10.2021 dhe ka skaduar polica e sigurimit më date 12.10.2021.

Për mjetin tjetër kamioçinë, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezultoi se ka skaduar certifikata e kontrollit teknik me date 30.07.2022.

OE Sh, referuar shtojcës nr.8, ka paraqitur dokumentacionin fizik të rregullt vetëm për dy mjete kamion vetëshkarkues. Për mjetin e tjetër kamion vetëshkarkues, ka paraqitur dokumentacion jo të rregullt. Nga verifikimi që iu bë dokumentacionit të dorëzuar si certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik etj, rezultoi se mjeti me targe A, është tërheqës dhe jo kamion vetëshkarkues.

OE N, pjese e BOE, nuk ka deklaruar asnjë makineri në shtojcën nr.8.

Referuar sa më lart, BOE N&Sh, nuk plotësojnë pikën 2.8 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Nga auditimi i saktësisë së konkluzionit të KVO, se BOE nuk plotësojnë pikën 2.8 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, konstatohet se:

Në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur midis dy OE, është përcaktuar:

Punimet do të kryen në raportin:

“N” shpk: 70.46 % (shtatëdhjetë pike dyzet e gjashtë) të elementeve, zërave dhe volumeve të punimeve sipas preventivit bashkëngjitur.

“Sh” do të realizojë: 29.54% (shtatëdhjetë përqind) të elementeve, zërave dhe volumeve të punimeve sipas preventivit bashkëngjitur.

Në pikën 2.8 të kriterëve të veçanta të DT, është kërkuar lloji dhe sasia e makinerisë së më poshtë:

Kamion vetëshkarkues, 3 copë;

Kamioçinë (kapaciteti mbajtës deri në 3.5 (tre pike pese) ton, 2 copë;

Autobetoniere, 1 copë;

Autobot uji, 1 copë;

Kamion me vinç, 1 copë.

Për mjetet e mësipërme OE N, pjese e BOE, nuk ka deklaruar asnjë makineri në shtojcën nr.8 dhe për këtë arsye konstatimi i KVO se BOE nuk plotëson kriterin 2.8 të seksionit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, është i drejtë, e si rrjedhojë skualifikimi i BOE N&Sh, është i drejtë.

#### Mbi kualifikimin e BOE 2&E

**Titulli i gjetjes:** Kualifikimi i operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DT dhe mos anulimi i tenderit.

**Situata:** Në kontratën e bashkëpunimit midis BOE 2&E, është vendosur që përfaqësuesi i BOE do të jetë OE “2” dhe palët kanë rënë dakord që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e kontratës do të jetë: OE 2 do të kryej 1% të punimeve, e cila konsiston në realizimin vetëm të zërit “Tavan me material rapote”, ndërsa OE E dotë realizojë 99% të kontratës, e cila konsiston në realizimin e të gjithë zërave të tjerë të preventivit, përveç zërit që do të realizojë OE “2”ShPK.

Në pikën 2.8 të seksionit të kapacitetit teknik të DT është kërkuar që OE të vërtetojnë se disponojnë 3 mjete kamion vetëshkarkues. Disponimi i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetë deklaramit (shtojca 8) gjatë

fazës së ofertimit. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetë deklarimit sipas shtojcës 8.

Por nga auditimi i formularit përmbledhës të vetë deklarimit të paraqitur nga OE E, është deklaruar se disponohen 2 kamionë vetëshkarkues dhe jo 3, si është kërkuar në DT (Kamionët me targa A dhe A). Operatori tjetër ekonomik “2” ka deklaruar se nuk disponon asnjë mjet (kjo për shkak edhe të përqindjes së ulët prej 1% dhe natyrës së zërit që do të realizojë). Në këtë mënyrë BOE “2” & E, nuk plotëson kriterin e pikës 2.8 të seksionit të kapacitetit teknik të DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO, por duhet të ishte skualifikuar. KVO duhet ti kishte propozuar titullarit të autoritetit kontraktor anulimin e tenderit.

**Kriteri:** Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 98, pika të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku thuhet:

*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:...b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme...”*

Gjithashtu veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 82, pika 2, germa (i) të VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar., ku thuhet:

*“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...”*

*i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit...”*

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO: z. O.H, me detyrë specialist i larte emergjenca civile & kadastër, z. A.Q. me detyrë specialist i taksave e tarifave vendore, z. Q.P., me detyrë teknik i mesëm pyjesh.

**Ndikimi:** Mos anulimi i tenderit dhe kualifikimi i një OE ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DT, ka sjell lidhjen e kontratës me një OE i shpallur fitues në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrin ligjor në fuqi në fushën e prokurimit publik lidhur me vlerësimin e ofertave.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor të marrë masa për një vlerësim të barabartë të operatorëve ekonomik dhe të shmang rastet e kualifikimit të operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DT. Në raste të tilla të bëhet anulimi i tenderit.

3. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Mbrezhanit – Malshovë”, vlerë të fondit limit 58,333,333 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021.

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Mbrezhanit – Malshovë”, REF – 02745-08-12-2021</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> nr.1727 prot., datë 09.08.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit,</b> ngritur me urdhrin nr.1727 prot., datë 09.08.2021 F.S, S.V, J.N,	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</b> Urdhër nr. 1727/1 Prot.,datë 09.08.2021: B.A, O.H, S.K
<b>2.Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur , Punë”		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 58,333,333 lekë	<b>6.Oferta fituese:</b> Sh me vlerë 36,800,000 lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> 21,533,333 lekë (pa tvsh)

<b>8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit:</b> 07.09.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e veta	<b>10. Operoret Ekonomik</b> a) Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) S'kualifikuar 1 c) Kualifikuar 4 OE
<b>11. Ankimime:</b> AK: Nuk ka patur ankesa	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:</b>
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
<b>14. Lidhja e kontratës nr.2245/4,</b> datë 22.10.2021	<b>15. Vlera e kontratës:</b> 36,800,000 lekë pa TVSh, ose 44,160,000 me TVSh.	16. Likuiduar deri

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë Këlcyrë. Nga Bashkia Këlcyrë në DT është përcaktuar se: “Financimi i objektit do të bëhet sipas parashikimit dhe planifikimit të buxhetit afatmesëm Bashkisë Këlcyrë. Përkatësisht viti 2021 me financim në shumën 3,333,333 (tre milion e treqind e tridhjetë tre mijë e treqind e tridhjetë tre) lek pa tvsh dhe pjesa tjetër në vitet në vazhdim”. Vlera prej 3,333,333 lekë, përbën afërsisht 5.7% të vlerës totale të kontratës, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 40 “E drejta për të kryer shpenzime”, të ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku thuhet:

*“Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës”.*

Gjithashtu, shtrirja e financimit më shumë se kohëzgjatja e kontratës, për ë shumë se një vit kalendarik, duke mos respektuar grafikun e punimeve, situacionet dhe faturat që do të priten në kohën e përfundimit të punimeve për secilin situacion dhe për kontratën përfundimtare, është në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht:

- Nenin 106 “Kohëzgjatja e kontratës”, pika 1, 3, 4, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet:

*1. Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.*

*3. Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.*

*4. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.*

Për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i AK Z, K.N.

### **Hartimi i kriterëve të veçanta të DT**

Në dokumentet e tenderit nuk është përcaktuar emri i personi përgjegjës. Në këto dokumente është vendosur adresa e postës elektronike dhe në vend të emrit të personit përgjegjës për prokurimin janë shënuar inicialet F.S., inicialet të cilat nga komunikimi me Znj. F.S., përfaqësojnë këtë person, juriste, anëtare e njësisë së prokurimit.

Në urdhrin e prokurimit të titullarit të AK, është përcaktuar si person përgjegjës Znj. F.S.

Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik AK ka kërkuar: Kodi III.2 A (1+2) për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis. Auditim mjedisor. Ky kriter është i pa argumentuar teknikisht dhe nuk ka lidhje me tipologjinë, natyrën e kontratës dhe bie në kundërshtim me pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku kërkohet që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe vlerën e

kontratës. Për rrjedhojë cenohen edhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, ku kërkohet që nga AK të garantohet trajtim i barabartë dhe jo diskriminues i operatorëve ekonomik dhe të mos ngushtohet konkurrenca.

Në bazën ligjore të mësipërme thuhet:

Pika 1 e nenit 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020:

*... Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”;*

- Pika 4 e nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021:

*”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. ...”;*

Në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik AK ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL). Në vendosjen e këtij kriteri AK nuk ka përcaktuar se cila është licenca konkrete që duhet të paraqesin OE, duke krijuar paqartësi të OE për plotësimin e këtij kriteri, si dhe paqartësi të KVO gjatë vlerësimit të ofertave. Ky formulim i bërë nga AK vjen në kundërshtim me kërkesat e pikës 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet:

*“...Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

Gjithashtu nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit, konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike. Në këtë procesverbal nga njësia e prokurimit është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën autoritetit kontraktor, që gjatë hartimit të kriterëve mund t’u kërkojë ofertuesve plotësimin e një numri të caktuar kriteresh të nevojshme, por nuk është argumentuar teknikisht lidhja e kriterit të vendosur me objektin e kontratës, me zërin konkret të preventivit. Kështu nuk janë dhënë argumenta për numrin e kërkuar të punonjësve, numrin e secilës makineri, paisje të kërkuar etj. Numri i punonjësve dhe i makinerive të kërkuara duhej të argumentohej në procesverbal, duke shpjeguar lidhjen e këtij numri me volumin e punimeve, orët e punës, grafikun e punimeve etj. Autoriteti kontraktor ka të drejtën e vendosjes së kriterëve të nevojshme që duhet të plotësojnë operatorët ekonomik, por njëkohësisht ka edhe detyrimin e argumentimit teknik të arsyes së vendosjes së këtyre kriterëve. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2, germa (c), ku thuhet:

*“Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:...*

*c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...”.*

- nenin 39, pika 6.ç, ku thuhet: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*



-nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, ku thuhet:

1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.

2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, hartues i kriterëve të seksionit të kapacitetit teknik, anëtar i njësisë së prokurimeve z. J.N. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për mbikëqyrjen e veprimtarinë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi.

#### **Vlerësimi i ofertave**

Në datën 06.10.2021, KVO ka hartuar raportin përmbledhës, protokolluar me nr.2245. Me shkresën nr. 2245/1 prot., datë 06.10.2021, titullari i autoritetit kontraktor z. K.N. ka miratuar procedurën e KVO (raportin përmbledhës) dhe ka shpallur fituesin.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit (Kriteret e vlerësimit): oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Nga auditimi konstatohet se oferta fituese nuk është anomalisht e ulët, pasi vlerë 85% e mesatares së ofertave të vlefshme është 35,301,651 lekë. Gjithashtu nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve të ofertës fituese.

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi
1	“Sh”	36,800,000	Kualifikuar, fitues
2	“K.” ShPK	40,039,645	Kualifikuar
3	“D.” ShPK	41,418,750	Kualifikuar
4	BOE B&S	47,867,020	Kualifikuar
5	R&T&C	57,238,293	S’kualifikuar

#### 4. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Karburant për automjetet”, me fond limit 6,602,310 lekë, zhvilluar në vitin 2021

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant për automjetet”, . REF-88076-02-23-2021</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr.327/1 prot., datë 17.02.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> , ngritur me urdhrin nr.327/1 prot., datë 17.02.2021 S.V, J.N, F.S	<b>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</b> Urdhër nr. 327/2 Prot., datë 17.2.2021: B.A, A.Q, S.K
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”		

<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 6,602,310 lekë	<b>6.Oferta fituese: "D"</b> me marzh fitimi 17.9%	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> lekë (pa tvsh)
<b>8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit:</b> 08.03.2021	<b>9.Burimi Financimit:</b> Grant+të Ardhura	<b>10.Operatoret Ekonomik</b> a)Pjesëmarrës në tender:1 OE b)S'kualifikuar - c) Kualifikuar 1 OE
<b>11.Ankimime:</b> AK: Nuk ka patur ankesa	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b>	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:</b>
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
<b>14.Lidhja e kontratës</b>	<b>15.Vlera e kontratës:</b>	16. Likuiduar deri

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët (Marzhi më i ulët i fitimit i shprehur në përqindje).

Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin e kontratës është nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 31.12.2021

### **Hartimi i kriteve të veçanta të DT**

Nga auditimi nuk u konstatuan anomali në hartimin e kriteve të veçanta të DT.

### **Vlerësimi i ofertave**

Në tender ka marrë pjesë vetëm OE "D". Nga auditimi nuk u konstatuan anomali në plotësimin e kriteve nga operatori ekonomik fitues.

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi
1	"D"	Marzh fitimi 17.9%	Kualifikuar, fitues

### **5. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "Karburant për automjetet", me fond limit 6,527,401 lekë, zhvilluar në vitin 2022**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Karburant për automjetet", . REF 27209-04-29-2022</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> nr.947/1 prot., datë 29.04.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit,</b> ngritur me urdhrin nr.947/1 prot., datë 29.04.2022 S.V, J.N, F.S	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</b> Urdhër nr. 947/2 Prot., datë 23.4.2022: B.A, O.H, A.Q,
<b>2.Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> "Kërkesë për propozim"		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 6,527,401 lekë	<b>6.Oferta fituese: "D"</b> me vlerë 6,385,494 lekë pa TVSh	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> 141,907 lekë (pa tvsh)
<b>8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit:</b> 16.05.2022	<b>9.Burimi Financimit:</b> Fonde të akorduara nga Bashkia Këlcyrë dhe buxheti i shtetit	<b>10.Operatoret Ekonomik</b> a)Pjesëmarrës në tender:1 OE b)S'kualifikuar - c) Kualifikuar 1 OE
<b>11.Ankimime:</b> AK: Nuk ka patur ankesa	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b>	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:</b>
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
<b>14.Lidhja e kontratës</b>	<b>15.Vlera e kontratës:</b>	16. Likuiduar deri

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Karburant për Automjete" sasisë dhe kohëzgjatja e kontratës: deri më 31.12.2022.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim.**

### **Hartimi i kriterëve të veçanta të DT**

Nga auditimi nuk u konstatuan anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT.

### **Vlerësimi i ofertave**

Në tender ka marrë pjesë vetëm OE A. Nga auditimi nuk u konstatuan anomali në plotësimin e kriterëve nga operatori ekonomik fitues.

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi
1	A	6,385,494	Kualifikuar, fitues

**Titulli:** Mos hartimi i planit për zbatimin e kontratës

**Situata:** Nga auditimi konstatohet se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për të gjitha kontratat e lidhura si rezultat i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, për mbikëqyrjen e veprimtarinë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi.

Personi përgjegjës për prokurimin Znj. F.S, ka patur detyrimin që të raportojë pranë APP informacionin lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës, detyrë të cilën nuk e ka kryer, pasi ka munguar informacioni për shkak të mos përcaktimit nga titullari të personit për monitorimin e zbatimit të kontratës. Nga auditimi nuk u konstatua që në rrugë shkresore, personi përgjegjës për prokurimin të ketë vënë në dijeni titullarin e autoritetit kontraktor, për mungesën e këtij informacioni i cili ka sjellë dhe mos përmbushjen e detyrës nga personi përgjegjës për prokurimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Znj. F.S.

**Kriteri:** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- nenin 124 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku thuhet:

Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor.

Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj.

Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit.

Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit.

-nenin 107 i nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet:

“...Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

a)Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;

- b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
- c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti;
- d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;
- dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së”.

Ndikimi: Mos hartimi planit për monitorimin e kontratës dhe mos përcaktimi i personit konkret për këtë qëllim, ka rrisht në mos njohjen si duhet nga AK të situatës së zbatimit të kontratës.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi për çështjen e monitorimit dhe zbatimit të kontratës.

**Rëndësia:** e mesme.

**Rekomandim:** Titullari i AK, të marrë masa që për cdo kontratë të lidhur me operatorët ekonomik në fushën e prokurimit publik, të hartojë plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe të përcaktojë person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës.

**Titulli i gjetjes:** Anomali në përcaktimin e personit përgjegjës të prokurimit.

**Situata:** Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyrë për vitin 2021 dhe 2022 ka caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht person përgjegjës për prokurimin, Znj. F.S., e cila sipas të dhënave të Bashkisë Këlcyrë, është punonjëse me kohë të plotë e Bashkisë Tiranë.

Për këtë qëllim në datën 06.01.2022 është lidhur aktmarrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S, pa numër protokolli. Bazuar në nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësi e prokurimit”, të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në rast mungese personeli, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm. Gjithashtu autoriteti/enti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete/ente kontraktore.

Edhe pse kuadri ligjor në fuqi ka bërë parashikimet e mësipërme, nevoja për marrjen e një personi nga një autoritet tjetër kontraktor nuk është e argumentuar nga Bashkia Këlcyrë, pasi ky institucion nuk ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit. Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton detyrimin që subjektet të kenë pa tjetër një jurist në njësinë e prokurimit. Bashkia Këlcyrë ka në strukturën e saj personel me arsim të lartë për kryerjen e kësaj detyre, të cilët më parë duhet të trajnohen prej saj.

Detyrimi që ka vendosur nenin 74 i VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me personin përgjegjës për prokurimin është:

Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë.

Gjithashtu po ky nen, ka vendosur detyrimin për titullarin e autoritetit kontraktor si vijon: Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik.

Nga auditimi konstatohet se përveçse nuk plotësohen kushtet për marrjen nga Bashkia Këlcyrë të një personi nga një autoritet tjetër kontraktor, edhe procedura e ndjekur për këtë qëllim është e gabuar. Bashkia Këlcyrë nuk i është drejtuar me shkresë zyrtare asnjë autoriteti kontraktor, pra as Bashkisë Tiranë, në mënyrë që ky institucion të përcaktojë personin e kërkuar nga Bashkia Këlcyrë. Në rast të nevojave të tilla, është institucioni Bashkia Tiranë që përcakton se cili do të jetë punonjësi i kërkuar nga Bashkia Këlcyrë dhe nuk përcakton punonjësi për veten e vet që të bëhet pjesë njesisë së prokurimit dhe person përgjegjës, në një institucion tjetër, si në rastin konkret. Aktmarrëveshja midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S. nuk është një marrëdhënie midis dy institucioneve, pasi nuk paraprihet nga akatmarrëveshja prej tyre, por marrëveshje midis një individi (të cilit për arsye se është i punësuar me kohë të plotë pranë Bashkisë Tiranë, nuk i lejohet të kryej detyra të tjera jashtë këtij institucioni pa autorizimin dhe miratimin e titullarit të Bashkisë Tiranë, brenda orarit zyrtar të punës) dhe Bashkisë Këlcyrë.

Në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohen detyrat e personit përgjegjës për prokurimin, ku midis të tjerash janë:

Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
  - Hartimin e urdhrat të prokurimit;
  - Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;
  - Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
  - Administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
  - Ndjek procesin e komunikimit me operatorët ekonomikë të përfshirë në procesin e ankimimit, për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla;
  - Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor;
  - Ndjekjen e procedurave për konfiskimin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP dhe në këto rregulla;
  - Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor; etj.
- Të gjitha detyrat e përcaktuara më sipër, personi përgjegjës për prokurimin nuk mund ti kryej dot, pa miratimin e titullarit të institucionit ku punon, pasi kryerja e tyre kërkon kohën e nevojshme në dispozicion, kërkon angazhim konkret brenda orarit të punës dhe brenda institucionit të Bashkisë Këlcyrë. Me Bashkinë Tiranë, kjo gjë vështirësohet akoma më shumë për shkak të distancës midis dy institucioneve.

**Kriteri:** Nenin 74 i VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**Ndikimi:** Shkelje e kuadrit ligjor në fuqi lidhur me përcaktimin e personit përgjegjës të prokurimit.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi lidhur me përcaktimin e personit përgjegjës të prokurimit.

**Rëndësia:** lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për ndërprerjen e aktmarrëveshjes që ka bërë më Znj. F.S dhe të përcaktojë personin përgjegjës për prokurimin publik, nga punonjës brenda strukturës së vet. Në rastet e tenderave që do të kërkojnë njohuri të specializuara, Bashkia Këlcyrë të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore.

### **Mbi pikën e Auditimit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël**

**Për vitin 2022** është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël me Urdhërin nr. 02 prot. datë 18.01.2022 të Titullarit të AK znj. K.N, i përbërë nga:

1.H.SH. Kryetar.

2.V.K. Anëtar.

3.B.A. Anëtar.

Nga auditimi i **zonës së llogarisë 602**, për blerjet me vlera të vogla, rezultoi se për vitin 2022 janë zhvilluar gjithsej 16 procedura me vlerë të fondit limit 4,020,397 lekë dhe me vlerë kontrate pa tvsh 3,456,954 lekë, me diferenc nga fondi limit në vlerën 563,443 lekë. nga grupi i auditimit u audituan 5 procedura me vlerë të kontratës pa tvsh 1,713,600 lekë, ore 50% të vlerës së prokuruar. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 1 pika 4 bashklidhur raportit të auditimit:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	vlerë	në % ndaj totalit
2022	16	3,456,954	5	1,713,600	50%
<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>3,456,954</b>	<b>5</b>	<b>1,713,600</b>	<b>50%</b>

**Burimi i të dhënave:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Këlcyrë

**Titulli i gjetjes:** Mangësi në zbatimin e dispozitave ligjore të VKM nr.285. dt. 19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik.

**Situata:** Nga auditimi i procedurave me vlerë të vogël u konstatua problematika persa i përket kritereve të përcaktuara në ftesën për ofertë, si vijon:

#### **1.Për procedurën me objekt “Blerje Furnizim vendosje pjese kembimi per automjete”**

-Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.

-Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratën e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues.

-Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar vërtetim nga të dalë nga organet përkatëse, se OE i ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike.

- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar që OE nuk ka provuar me anën e dokumentacionit se veprimtaria e tij është në përputhje me legjislacionin në fuqi për punën dhe mjedisin.

#### **2.Për procedurën me objekt “Blerje dru zjarri”**

-Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.

-Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratën e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues.

-Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar vërtetim të dalë nga organet përkatëse, se OE i ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike.

-Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që OE nuk ka provuar me anën e dokumentacionit se veprimtaria e tij është në përputhje me legjislacionin në fuqi për punën dhe mjedisin

### **3. Për procedurën me objekt: Blerje Materiale Kancelarie**

- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.
- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratën e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues.
- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar vërtetim nga të dalë nga organet përkatëse, se OE i ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike.
- Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që OE nuk ka provuar me anën e dokumentacionit se veprimtaria e tij është në përputhje me legjislacionin në fuqi për punën dhe mjedisin.

#### **Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua mungesa e këtyre dokumenteve si më poshtë:**

- Nuk është administruar Certifikata Elektronike ISO 140001-2015, sipas kriterëve të përgjithshme të përcaktuar në Ftesën për Ofertë.
- Për sa më sipër, KPVV duhet të kishtë skualifikuar operatorin ekonomik, për të vijuar me operatorin e radhës.

### **4. Procedurën me objekt: Blerje Materiale Ndërtimi për Shërbim e Mirëmbajtje**

#### **Sa i përket kriterëve të përcaktuar në ftesën për ofertë, konstatohet se:**

- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.
- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratën e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues.
- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar vërtetim nga të dalë nga organet përkatëse, se OE i ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike.
- Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që OE nuk ka provuar me anën e dokumentacionit se veprimtaria e tij është në përputhje me legjislacionin në fuqi për punën dhe mjedisin.

#### **Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua mungesa e këtyre dokumenteve si më poshtë:**

- OE fitues nuk ka dorëzuar Certifikatën certifikatën ISO 9001:2015 mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë.

Për sa më sipër KPVV duhet të kishin skualifikuar OE fitues për mungesë dokumentacioni dhe duhet të kishin kaluar në operatorin e radhës.

### **5. Për procedurën me objekt: “Blerje Baze Materiale per Lyerje Objekte Shkollore”**

#### **Sa i përket kriterëve të përcaktuar në ftesën për ofertë, konstatohet se:**

- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.
- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar deklaratën e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues.
- Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar vërtetim nga të dalë nga organet përkatëse, se OE i ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike.
- Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që OE nuk ka provuar me anën e dokumentacionit se veprimtaria e tij është në përputhje me legjislacionin në fuqi për punën dhe mjedisin.

**Ndikimi:** Mospërfshirja e e kriterëve në Ftesën për Ofertë të parashikuara në VKM nr. 285 dt. 19.05.2021, për Rregullat e Prokurimit Publik, nuk garanton cilësinë e mallit, sendeve apo shërbimeve që do të prokurohen si dhe pajtueshmërinë e operatorëve ekonomikë me legjislacionin në fuqi.

Shkaku: Mosrespektimi I dispozitave ligjore të VKM nr.285, dt.19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik.

**Kriteret Ligjore:** 1) VKM nr.285, dt.19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik, neni 40, pika 4, pika 7

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Në procedurat e ardhshme të prokurimit, për prokurimet me vlerë të vogël, të bëhen pjesë e kriterëve të përgjithshme të gjitha përcaktimet e bëra në VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për Rregullat e Prokurimit Publik. Të verifikohet me përpikmëri dokumentacioni i dorëzuar nga OE fitues dhe pajtueshmëria e këtij dokumentacioni me kriteret e parashikuara në Ftesën për Ofertë.

**Pika 4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.**

Për objektin **“Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë”**, gjatë auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Bashkisë Këlcyrë dhe BOE B&H me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019.*
  - *Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);*
  - *Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 në situacionin Situacioni nr.6;*
  - *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 6;*
- 2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Bashkisë Këlcyrë dhe OE “Z”sh.p.k me Nr. ....Prot. datë 22.10.2019.*
- *Korrenspondencat mes Bashkisë Këlcyrë dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “Z”sh.p.k.*

**Kontratat**

Objekti është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr.2292 Prot datë 01.11.2019 me objekt **“Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë”** të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B” sh.p.k me licenca profesionale përkatësisht N dhe N. Vlera e kontratës është 177,466,647 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Afati i përfundimit të punimeve është zgjatur me 2.5 muaj me Amendim Kontrate nr.1943prot. datë 03.07.2020 pra duke përcaktuar si datë për përfundimin e tyre 15.10.2020.. Kjo zgjatje e afatit të përfundimit të punimeve ka ardhur si rezultat i në procesin e shpronësimeve dhe ndalesës së punimeve nga banorët e zonës për ndërtimin e kaptazhit në fshatin Fratar me pretendimin se burimi përdorej për nevojat e tyre.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit pa nr. prot, datë 22.10.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “Z sh.p.k, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1208/13, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 228,081 lekë me TVSH.

Kolaudimi i punimeve të ndërtimit është kryer nga OE “A” sh.p.k. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh M sipas kontratës datë 29.05.2019 dhe akti i kolaudimit është mbajtur më datë 30.10.2020.

**Hartimi i projektit**

Projekti është hartuar nga OE “Z”sh.p.k ku ishin të parashikuara të kryhen punimet në linjën e jashtme; punime në kaptazh për tre burime me vetërrjedhje; rikonstruksion i depos 20 m<sup>3</sup> dhe 700 m<sup>3</sup>; punimet në stacionin e pompimit së bashku me pajisjet elektro-mekanike dhe linjën e dërgimit si dhe sistem SCADA i cili do të kryej monitorimin në distancë të sistemit të pompave dhe matjen e prodhimit e konsumin në daljen e depove.



Financimi i hartimit të projektit dhe punimeve civile është kryer me fondet e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës kanalizime Dhe Mbetjeve të Ngurta.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 15.11.2019. Punimet kanë përfunduar me datë 15.10.2020 brenda afatit të përcaktuar në amendimin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve prej 106 ditë kalendarike, kjo referuar shkresës Nr.50 Prot. datë 15.10.2020 të mbikëqyrësit të punimeve.

Sipërmarrësi i punimeve me kërkesën, Nr.155 Prot. datë 07.09.2020 (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve për nevojat e ndryshme të punimeve brenda preventivit ofertues, pas të cilës është bërë kërkesë nr. 45 prot dhe datë 07.09.2020 e mbikëqyrësit të punimeve drejtuar AK.

Me shkresat Nr. 2363 Prot datë 08.09.2020 dhe Nr. 2613 Prot. datë 07.09.2020 janë miratuar kërkesa për ndryshime volumesh (+/-), si dhe preventivi i rishikuar me vlerë 353,615 lekë pa TVSH, më pak se ai i kontratës fillestare ku në të është përfshirë edhe vlera e fondit rezervë.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjetës Këlcyrë”.		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr.2292Prot. datë 01.11.2019	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 177,466,647 lekë <b>BOE B&amp;H</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me TVSH 177,113,028 lekë -Vlera pa TVSH 147,594,190 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 244 ditë, Zbatuar 336 ditë. Fillimi punimeve: 27.03.2019 Përfundimi punimeve: 12.07.2019	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> “Z”sh.p.k	Licenca Nr: M	Kontrata pa nr. 2041 prot, datë 04.10.2019
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE A sh.p.k	Licenca Nr: M	Kontrata pa nr. prot, datë 29.05.2019
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 29.10.2020	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> datë 30.10.2020	
<b>16.Likuiduar deri dt</b>		
<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendim kontrate nr.1943prot. datë 03.07.2020, shtyrje afati me 106 ditë .		

Në kontratë është parashikuar instalimi i sistemit SCADA në stacionin e pompimit Këlcyrë si dhe në depon 700 m<sup>3</sup>. Ky sistem do të bëjë të mundur matjen e prurjeve, nivelin e rezervuarit dhe konsumin në dalje të depos nëpërmjet matësive elektronik e kështu komandimin në distancë të elektro-pompave duke minimizuar kostot e prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu nëpërmjet matësive në sistemin e shpërndarjes bëhet kontrolli i humbjeve në rrjet duke i krahasuar me konsumin total të klientëve si dhe sasia e klorit që duhet të injektohet në sistem sipas nevojave. Nga vizita në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesit të Bashkisë Këlcyrë u konstatua se ishin instaluar pajisjet e sistemit SCADA të parashikuara në kontratë por, ky sistem ishte jashtë funksionit, i pa programuar, matësat elektronik nuk tregonin matjet në panelet përkatëse si dhe sistemi i klorinimit ishte jo funksional. Në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që në përfundimi të punimeve dhe aktin e kolaudimit sistemit SCADA ti jetë kryer testi i funksionimit (test report). Mosfunksionimi i sistemit të klorinimit tregon se sasia e ujit në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjeno-sanitare të përcaktuara në legjislacion.

Për sa më sipër, mos klorifikimi i ujit të pijshëm ngarkon me përgjegjësi, Administratorin e Ujësjetës Këlcyrë sh.a. referuar VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullore cilësia e ujit të pijshëm”, ku në neni 15 thuhet: “Dezinfektimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e administratorit”.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme në depon 700 m<sup>3</sup> dhe në stacionin e pompimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 339, 337 lekë pa TVSH.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në kategorinë II. Punime për dhomën e pompave, zëri F.V dritare metalike 18 kg/m<sup>2</sup> në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 5 m<sup>2</sup> dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga vizita në terren u konstatua se ky zë punimesh nuk është kryer, nuk janë vendosur asnjë lloj dritareje. Për sa më sipër kontraktori ka përfituar volumin e punimeve 5 m<sup>2</sup> në zërin F.V dritare metalike 18 kg/m kjo në vlerën 22,540 lekë pa TVSH (5 m<sup>2</sup> x 4508 lekë/m<sup>2</sup>). Gjithashtu u konstatua se në dhomën e pompave nuk ishte vendosur derë e për rrjedhojë kontraktori ka përfituar më tepër volumin 1.94 m<sup>2</sup> për zërin Derë d/alumin pa xham, me mbushje d/alumin kjo në vlerën 23,627 lekë pa TVSH (1.94 m<sup>2</sup>x 12179 lekë/m<sup>2</sup>).

-Në kategorinë VII. Punime konstruksioni (Dhoma e komandimit), zëri Transport dheu me auto deri 2 km në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 179 m<sup>3</sup> dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga vizita në terren u konstatua se ky zë punimesh nuk është kryer sipas distancave të përcaktuara në preventiv por është hedhur në rrethimin e depo. Për sa më sipër kontraktori ka përfituar volumin e punimeve 179 m<sup>3</sup> në zërin Transport dheu me auto deri 2 km kjo në vlerën 30,430 lekë pa TVSH (179 m<sup>3</sup> x 170 lekë/m<sup>3</sup>).

-Në kategorinë VII. Punime për murin pritës, zëri Transport dheu me auto deri 2 km në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 105 m<sup>3</sup> dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga vizita në terren u konstatua se ky zë punimesh nuk është kryer sipas distancave të përcaktuara në preventiv por është hedhur në rrethimin e depo dhe është përdorur për mbushjen pas mureve. Për sa më sipër kontraktori ka përfituar volumin e punimeve 105 m<sup>3</sup> në zërin Transport dheu me auto deri 2 km kjo në vlerën 17,850 lekë pa TVSH (105 m<sup>3</sup> x 170 lekë/m<sup>3</sup>). Gjithashtu mbushja pas mureve është kryer me material të gërmuar dhe jo me zhavorr kështu që kontraktori ka përfituar më tepër volumin e punimeve 44 m<sup>3</sup> të zërin Mbushje me zhavorr pas mureve kjo në vlerën 45,716 lekë pa TVSH (44m<sup>3</sup>x 1039 lekë/m<sup>3</sup>).

-Në kategorinë VII. Punime rrethimi, zëri Transport dheu me auto deri 2 km në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 63 m<sup>3</sup> dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga vizita në terren u konstatua se ky zë punimesh nuk është kryer sipas distancave të përcaktuara në preventiv por është hedhur në rrethimin e depo dhe është përdorur për mbushjen pas mureve. Për sa më sipër kontraktori ka përfituar volumin e punimeve 63 m<sup>3</sup> në zërin Transport dheu me auto deri 2 km kjo në vlerën 10,710 lekë pa TVSH (63 m<sup>3</sup> x 170 lekë/m<sup>3</sup>). Gjithashtu mbushja pas mureve është kryer me material të gërmuar dhe jo me zhavorr kështu që kontraktori ka përfituar më tepër volumin e punimeve 20 m<sup>3</sup> të zërin Mbushje me zhavorr kjo në vlerën 22,320 lekë pa TVSH (20 m<sup>3</sup>x 1117 lekë/m<sup>3</sup>).

-Në kategorinë F2. Pajisje të sigurimit teknik, sipas situacionit përfundimtar janë dorëzuar pajisje për sigurinë nga rryma elektriken dhe një analizator portativ i përqindjes së klorit. Nga auditimi i dosjes teknike nuk gjenden gjurmë që këto pajisje të jenë dorëzuar tek punonjësit e Ujësjiellës Këlcyrë. Nga mosdorëzimi i pajisje të përfshira në situacionin përfundimtar me vlerë totale 166,144 lekë pa TVSH është përfituar më tepër nga ana e kontraktorit.

**Titulli i gjetjes:** *Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.*

**Situata:** Në objektin “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe BOE B&H me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 177,466,647 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 8 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr.1943 prot. datë 03.07.2020, deri më 15.10.2020, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- *Projekti fillestar;*
- *Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 6;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 6;*
- *Ndryshimet e miratuara nga AK;*
- *Korrespondencat mes Bashkisë Këlcyrë dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “Z” sh.p.k.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	II. Punime për dhomën e pompave	F.V dritare metalike 18 kg/m2	22,540
		Derë d/alumin pa xham, me mbushje d/alumin	23,627
2	VII. Punime konstruksioni (Dhoma e komandimit)	Transport dheu me auto deri 2 km	30,430
3	VII. Punime për murin pritës	Transport dheu me auto deri 2 km	17,850
		Mbushje me zhavorr pas mureve	45,716
4	VII. Punime rrethimi	Transport dheu me auto deri 2 km	10,710
		Mbushje me zhavorr	22,320
5	F2. Pajisje të sigurimit teknik	Pajisje për sigurinë nga rryma elektriken	45,784
		Analizator portativ i përqindjes së klorit	120,360
SHUMA			<b>339, 337</b>

Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.3.

**Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: *“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.*

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 ku përcaktohet se: *“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.*

- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

- Kontrata e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe OE “Z” me Nr....Prot. datë 22.10.2019 me objekt: *“Mbikëqyrje e punimeve në objektin, Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë”*, Neni 7 pika 1 *“Përgjegjësitë e të kontraktuarit”.*

**Ndikimi/Efekti:** Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 339, 337 lekë pa TVSH.

**Shkaku:** Certifikimi nga ana e supervizorit i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Këlcyre të marrë masa, për arkëtimin e shumës 339, 337 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga *BOE B&H* sipas kontratës së lidhur me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 për realizimin e punimeve civile.

**Titulli i gjetjes:** *Rrezikimi i shëndetit publik nga mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm dhe mosfunksionim i sistemit SCADA.*

**Situata:** Në kontratën me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjes Këlcyre” është parashikuar instalimi i sistemit SCADA në stacionin e pompimit Këlcyre si dhe në depon 700 m<sup>3</sup>. Ky sistem do të bëjë të mundur matjen e prurjeve, nivelin e rezervuarit dhe konsumin në dalje të depos nëpërmjet matësve elektronik e kështu komandimin në distancë të elektro-pompave duke minimizuar kostot e prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu nëpërmjet matësve në sistemin e shpërndarjes bëhet kontrolli i humbjeve në rrjet duke i krahasuar me konsumin total të klientëve. Referuar sasisë që hyn në sistemin e shpërndarjes, e matur nga matësat elektronik në dalje të depos, bëhet dezinfektimi i ujit të pijshëm me hipoklorit natriumi të koordinuara nëpërmjet sistemit SCADA. Nga vizita në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesit të Bashkisë Këlcyre u konstatua se ishin instaluar pajisjet e sistemit SCADA të parashikuara në kontratë por, ky sistem ishte jashtë funksionit, i pa programuar, matësat elektronik nuk tregonin matjet në panelet përkatëse si dhe sistemi i klorinimit ishte jo funksional. Në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që në përfundimi të punimeve dhe aktin e kolaudimit sistemit SCADA ti jetë kryer testi i funksionimit (test report). Mosfunksionimi i sistemit të klorinimit tregon se sasia e ujit në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara në legjislacion.

**Kriteri:** -VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, neni 6 “Kriteret e cilësisë së ujit të pijshëm”, ku citohet:

*1. Uji i pijshëm duhet të jetë i shëndetshëm dhe i pastër. 2. Uji i pijshëm plotëson kërkesën e pikës 1, nëse: a) nuk përmban mikroorganizma, parazitë apo ndonjë lëndë tjetër, e cila, në sasi apo në përqendrim, përbën një rrezik potencial për shëndetin publik.*

- Kontrata Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 (specifikimet teknike).

**Ndikimi/Efekti:** Mungesë monitorimi për uljen e kostove dhe dëmtim i shëndetit publik.

**Shkaku:** Mosfunksionimi i sistemit SCADA dhe mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm.

**Rëndësia:** Mosfunksionimi i sistemit SCADA dhe mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Këlcyre në bashkëpunim me Ujësjes Kanalizime Këlcyre sh.a të marrë masa të menjëhershme për vendosjen në funksionim të sistemit SCADA i cili do të kryejë një kontroll sa më efikas të sistemit të prodhimit e të shpërndarjes për uljen e kostove të prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu të vendoset në funksion sistemi i klorinimit, i koordinuar në mënyrë automatike me sistemin SCADA, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë rruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

## **Pika 5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Këlcyre ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i

ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015”. Bazuar në sa më sipër, gjatë vitit 2022 janë miratuar 8 Vendime për Leje Ndërtimi, sipas sistemit të e-leje, nga të cilat 7 leje janë me sipërfaqe me të vogël së 250 m2 si dhe 1 leje me sipërfaqe më të madhe se 250 m2, të cilat janë paraqitur në tabelën si vijon:

Emertimi	Data	Nr.prot	Sip.nderti mi (m2)	Preventiv	Investitori	Taksa e ndikimit ne infrastrukture
Rikonstruksion ,shtese kati perdhe e mbingritje kati	01.11.2022	2448	133	3,270,763	V.P	130,130
Mbingritje banese nje kat	24.10.2022	2390	138.6	3,500,172	Y.K,H.K, S.K	135,609
Rikonstruksion dhe ndryshim funksioni ne strukture banese ,1 kat	26.09.2022	2123	79.2	2,087,807	K.N, M.N	62,634
Mbingritje banese 1 kat me cati	06.09.2022	1919	137.4	3,813,182	A.K	134,435
Objekt banimi 2 kat	10.07.2022	1515	221	5,289,082	A.S	216,231
Objekt 3 kat	15.02.2022	364	781.76	27,770,103	B.D	833,103
Banese 2 kat	05.05.2021	947	249	8,108,750	Z.K	243,267
Rikonstruksion ,shtese kati perdhe e mbingritje kati me cati	20.07.2020	2040	126.70	4,178,206	H.S, D.S	141,456

**Burimi:** Drejtoria e PZHT rakorduar me sistemin e-leje

Nga dokumentacioni i sipër cituar rezulton se për periudhën objekt auditimi janë konstatuar problematika në miratimin e lejeve të ndërtimit. Në mënyrë të detajuar paraqiten si vijon:

**Titulli i Gjetjes:** Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se për lejet e mëposhtme të miratuara nga ana e bashkisë Këlcyrë nuk është marrë mendim nga institucionet e duhura.

**Situata:** nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet:

-leje ndërtimi nr., datë 28/09/2022 i jepet: zhvilluesit: A.S i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M.G, leja e ndërtimit për objektin: objekt banimi 2k adresa e realizimit të punimeve: fshat Zhepovë, bashkia Këlcyrë.

-leje ndërtimi nr. 1148 , datë 28/05/2021 i jepet: zhvilluesit: Z.K, S.K i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: R.SH leja e ndërtimit për objektin: banesë 2 kat adresa e realizimit të punimeve: fshat Podgoran, bashkia Këlcyrë.

-leje ndërtimi, datë 28/05/2021 i jepet: shoqërisë “1” sh.p.k ME licence n, drejtues ligjor E.L. zhvilluesit: Z.K, S.K i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: R.SH leja e ndërtimit për objektin: banesë 2 kat adresa e realizimit të punimeve: fshat Podgoran, bashkia Këlcyrë.

-leje ndërtimi nr. 876, datë 20/04/2022 i jepet: zhvilluesit: A.R i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: J.X leja e ndërtimit për objektin: “objekt 3 kate, kati pare njesi sherbimi, 2 kate njesi hyrse ne funksion te bujtines (D). adresa e realizimit të punimeve Këlcyrë.

Për lejet e mësipërme nuk është marrë mendim nga institucionet si AZHT,ASHK,UK

**Kriteri:** VENDIM Nr. 408, datë 13.5.2015 “për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”,Neni 15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

**Ndikimi/Efekti:** Mosmarrja e mendimeve pozitive nga institucionet e tjera të përfshira ndikon negativisht në zhvillimin e zonës pasi leja e miratuar pa aprovimin e këtyre institucioneve mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin e tyre.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi nga ana e DPKZHT Këlcyrë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga DPKZHT Këlcyrë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi me mendimet pozitive të aprovuara nga institucionet e nevojshme për të dhënë këtë mendim.

**Titulli i Gjetjes:** *Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se preventivi nuk është real por fiktiv bazuar mbi llogaritjet e bëra të tijë në preventivin e ngarkuar në sistemin e-leje.*

**Situata:** nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet:

-leje ndërtimi nr., datë 28/09/2022 i jepet: zhvilluesit: A.S i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M.G, leja e ndërtimit për objektin: objekt banimi 2k adresa e realizimit të punimeve: fshat Zhepovë, bashkia Këlcyrë.(sipas proejktuesit preventivi i llogaritur për këtë projekt është 5,289,082 lekë, ndërkohë kostoja minimale e këtij objekti llogaritur me koston e ndërtimit është 7,207,694 lekë)

**Kriteri:** Bazuar në çmimet e referencës për koston e ndërtimit sipas zonave përkatëse. Për ndërtime të caktuara sipas kategorive të tyre preventivi nuk mund të jetë më i ulët se kostoja e ndërtimit cmimi i të cilës është caktuar nga Enti Kombëtar i Banesave EKB.Kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m<sup>2</sup>.

**Ndikimi/Efekti:** Preventivimi jo i saktë për punimet që do të kryhen ndikon në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë kur për llogaritjen e sajë merret si bazë preventivi.

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit ligjor në fuqi nga ana e DPKZHT Këlcyrë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:**

Nga DPKZHT Këlcyrë të merren masa për të mos pranuar preventiv punimesh të cilat janë nën koston e ndërtimit që është miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave.

**Titulli i Gjetjes:** Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se nuk është respektuar distanca e objektit nga kufiri i pronës.

**Situata:** nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet:

- leje ndërtimi nr. 876, datë 20/04/2022 i jepet: zhvilluesit: A.R i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: J.X leja e ndërtimit për objektin: “objekt 3 kate, kati pare njesi sherbimi , 2 kate njesi hyrse ne funksion te bujtines (D). adresa e realizimit të punimeve: Këlcyrë(objekti në orientimin jugor duhet ta kishte distancën nga kufiri i pronës jo më pak se 4 metër ndërkohë e ka 2.7 metër dhe 3.1 metër)

**Kriteri:** Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori, neni 35 distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i distancave të lejuara nga kufiri i pronës ndikon në pronat kufitare dhe kequrbanizimin e zonave.

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit ligjor në fuqi nga ana e DPKZHT Këlcyrë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:**

Nga DPKZHT Këlcyrë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi me objekte të cilat nuk respektojnë distancat e lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

Për mangësitë e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1.K.N me detyrë kryetar i bashkisë Këlcyrë

2.J.N me detyrë përgjegjës i ZPT bashkia Këlcyrë

**Pika 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)**

**Titulli i Gjetjes:** IMT bashkia Këlcyrë nuk është strukturë pasi ka vetëm një person të punësuar në këtë sektor.

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se Bashkia Këlcyrë nuk ka krijuar në strukturën e saj Inspektoratit e Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Për këtë anomali ka përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Z. K.N.

**Kriteri:** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit” si dhe ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” Neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Pranë çdo bashkie/komune ngrihet inspektorati ndërtimor e urbanistik, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë/komunës. Struktura e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës miratohet nga këshilli vendor përkatës, me propozimin e kryetarit të bashkisë/komunës. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës. Për përmbushjen e përgjegjësiave të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës mbështetet nga policia bashkiake/komunale dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga bashkia/komuna”.

Neni 5 “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Gjatë ushtrimit të përgjegjësiave të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme: a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; b) vendos gjopa sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi; e) jep informacionin e

*kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati”.*

**Ndikimi/Efekti:** Mosekzistenca e këtij inspektorati ndikon direkt në zhvillimin jo të duhur të sipërfaqes që zotëron kjo bashki pasi i jep mundsi abuzivizmit me ndërtime pa leje.

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit ligjor në fuqi nga ana e bashkisë Këlcyrë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:**

Nga DPKZHT Këlcyrë të merren masa për të krijuar inspektoriatin e mbrojtjes së territorit me kryeinspektorin dhe inspektorët e sipas legjislacionit në fuqi.

### **Pika 7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

**Titulli i gjetjes:** *Bashkia Këlcyrë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

**Situata:**

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 262/6, datë 01.08.2022 i ka dërguar Bashkinë Këlcyrë Raportin e Auditimit. Për përmirësimin e gjendjes, është rekomanduar zbatimi i masave të mëposhtme:

*a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht sipas urdhrat të titullarit me nr. 2979 prot datë 30.12.2022, nga masat e pranuar është zbatuar pjesërisht 1 masë janë në proces zbatimi 2 masa si dhe nuk janë zbatuar 11 masa organizative. Në mënyrë të detajuar gjendja e tyre paraqitet si më poshtë:*

*b.2. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 3 masë në vlerën 73,726,000 lekë, e pranuar dhe në proces zbatimi.*

### **DREJTIMET E AUDITIMIT:**

**1.Hartimi i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Këlcyrë rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 262/6, datë 01.08.2022 protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me shkresën nr. 1718 datë 04.08.2022 ndërsa nga Bashkia Këlcyrë për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje KLSH bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. K.N.

*Pa zbatuar*

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit**

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Këlcyrë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr262/6, datë 01.08.2022 dhe duhet të raportonte në



KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 01.02.2021.

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. K.N.

*Pa zbatuar*

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**Titulli i gjetjes** Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

**Situata:** Nga verifikimi rezulton se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 612/10, datë 12.04.2021 dhe nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. K.N.

**Kriteri:** Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

**Ndikimi:** Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Këlcyrë të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

**Shkaku:** Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Këlcyrë me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

**4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.**

**A. Masa organizative**

*Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Këlcyrë 14 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht sipas urdhrorit të titullarit me nr. 2979 prot datë 30.12.2022, nga masat e pranuar*

**është zbatuar pjesërisht 1 masë janë në proces zbatimi 2 masa si dhe nuk janë zbatuar 11 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si vijon:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

-Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.

-Burimet Njerëzore nuk kanë bazë të dhënash me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit. Nga kërkesa e grupit auditues u plotësua një listë e punonjësve të cilët kanë kryer trajnime ku rezultoi se 5 punonjës kanë kryer nga një trajnim dhe një punonjës ka kryer 2 trajnime për periudhën 2020- 2021.

-Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

-Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).

-Nuk ka plan-veprime vjetore për arritjen e objektivave, qëllimeve të politikave afatmesme (PBA) që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar

-Bashkia Këlcyre nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në kundërshtim me udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të MFK dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.3.

-Në strukturën organizative për vitet objekt auditimi pavarësisht se është përcaktuar pozicioni i punës së përgjegjës të zyrës së burimeve njerëzore dhe juristit, ky pozicion rezultoi të jetë vakant për gjithë periudhën e audituar, ndërkohë që nuk ka asnjë shpallje për vend të lirë pune nga institucioni.

- Nuk është ngritur grupi menaxhimit strategjik dhe nuk është vendosur koordinatori i riskut, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 10 dhe 11, “Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”.

-Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Këlcyre, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Këlcyre të merren masa për të rritur njohuritë mbi Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit si dhe për zbatimin e të gjithë komponentëve të saj. Burimet njerëzore të kenë një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve dhe të ngrihet GMS- ja, të vendoset koordinatori i riskut, të miratohet “Strategjia e Menaxhimit të Riskut”.

Për pozicionin e punës vakant së Përgjegjës të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit të shpallet vendi i lirë i punës.

**Deri më 31.10.2022**

*1.2. Nga verifikimi rezultoi se; rezultoi se me urdhrin nr. 48/1 datë 17.08.202 është përcaktuar koordinatori i riskut znj. V.K me pozicionin e përgjegjës së financës si dhe me urdhrin nr. 48 datë 17.08.2022 është krijuar “Grupi i menaxhimit strategjik”.*

*Nuk janë shpallur pozicionet vakante për Përgjegjës të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit si dhe nuk është miratuar strategjia e riskut.*

**Zbatuar pjesërisht**

**2.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë nuk ka miratuar në strukturë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, strukturë kjo e rëndësishme për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve, por edhe për mbrojtjen e territorit duke qenë se pranë këtij qyteti shtrihet edhe lugina e lumit Vjosë.

Gjithashtu Bashkia Këlcyrë nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Kjo strukturë është miratuar me një punonjës, por praktikisht nuk është plotësuar .

Nga mungesa e kësaj strukture, titullarit i mungojnë siguria e arsyeshme dhe këshillat për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke bërë që realizimi i objektivave të institucionit për aktivitetin dhe veprimtarinë e tij të kenë rrisht të lartë mos realizimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1 faqe 14-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim kontrollin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme.

**2.2.Rekomandim:**Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Këlcyrë, me qëllim rritjen e sigurisë për realizimin e objektivave dhe ofrimin e këshillave për drejtimin e institucionit, sidomos për sistemin e kontrollit të brendshëm.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

*2.3. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar strukturës organike të miratuar me vendimin nr. 45 datë 22.12.2021 konstatohet se nuk është krijuar sektori i Auditit të Brendshëm.*

#### **Pa zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Këlcyrë për periudhën 2020-2021, për arsye të ndryshme, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 27 punonjës, por nga auditimi u konstatua se asnjë nga këta punonjës, përpara largimit nuk ka bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal: dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishtas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre. Në këtë mënyrë nuk krijohet një vazhdimësi kronologjike e transmetimit të punës së kryer nga një punonjës te tjetri, por ndërprerje e saj, në varësi të shpeshësisë së ndërrimit të stafit, e cila sjellë edhe pasoja reale në punën e sektorëve përkatës të njësisë vendore. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13;

-VKM nr. 360, datë 14.07.2000 ”Për lirimin nga shërbimi civil”, pikat 19, 20 dhe 21 ”Dorëzimi i detyrës”;

-VKM nr. 171, datë 26.03.2014 ”Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, pika 50;

-Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodit te Punës te Republikës se Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 -Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1 faqe 15-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandim:** Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar

#### ***Pa zbatuar***

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë nuk ka ngritur Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020- 2022, 2021- 2023 dhe 2022-2024. Nuk është bërë miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2020-2022 me Vendim të Këshillit Bashkiak, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37. Sektori i të ardhurave nuk ka hartuar plan “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2020-2022 dhe për rrjedhojë nuk ka vendim të Këshillit Bashkiak, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Këshilli Bashkiak Këlcyrë nuk ka marrë Vendim për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2020- 2022, 2021- 2023 në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33.

Buxheti i vitit 2020 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me datë 27.01.2020 dhe i vitit 2021 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me datë 27.01.2021, jashtë afateve të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, pika 3 dhe 4.

-Mungon Plani i Masave dhe Veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Ka mungesë të dokumentave (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit. Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar edhe kërkesat e tyre buxhetore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në fund të çdo viti buxhetor të përgatis dhe të paraqes për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në vijim Këshilli Bashkiak Këlcyrë të marr vendimet brenda afateve.

## Menjëherë

*4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Rezulton se me urdhrin nr. 48 datë 17.08.2022 është krijuar “Grupi i menaxhimit strategjik”. Për vitin 2023 por nuk është ndërmarr asnjë procedurë tjetër, në dokumentimin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar edhe kërkesat e tyre buxhetore.*

## Pa zbatuar

**5. Gjetje nga auditimi:** Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Shpenzimet faktike janë realizuar ndaj planit për vitin 2020 në masën 93.9 %, dhe me të ardhurat e tyre si bashki mbulojnë 3.7 % të shpenzimeve. Shpenzimet faktike janë realizuar ndaj planit për vitin 2021 në masën 95 %, dhe me të ardhurat e tyre si bashki mbulojnë 5.2 % të shpenzimeve.

-Në PBA 2020-2022 janë planifikuar 2 investime dhe në PBA 2021-2023 një investim. Sipas kontratave të lidhura likuidimet e faturave nuk janë kryer brenda afateve të vendosura me afat përfundimtar të likuidimit në vitin 2020 dhe 2021. Vlera e palikuiduar vetëm për investimet e kryera përgjatë periudhës 2020- 2021 rezulton në vlerën 66,916,371 lekë me tvsh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 24-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marr masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit. Likuidimet e faturave për investime të kryhen brenda afateve të vendosura në varësi të kontratave të lidhura.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**5.2. Nga verifikimi rezultoi se:** *Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 321,964 mijë lekë, ndërsa realizimi 300,661 mijë lekë, ose në masën 93.3%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 92,358 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 81,481 mijë lekë, ose në masën 88%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 91%.*

*Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 29,239 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 22,613 mijë lekë, ose në masën 77.3%.*

*Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 78,494 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 78,374 mijë lekë, ose në masën 99.8 %.*

## Në proces zbatimi

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 30-ditor të paraqitjes dhe miratimit në Degën e Thesarit Përmet, të urdhërshpenzimit me dokumentacionin shoqëruar nga data e faturës së operatorit ekonomik u konstatua se:

Për llogarinë 602 “Shpenzime operative” për vitin 2020, janë kryer pagesa jashtë afatit 30 ditor në 30 raste me vlerë 2,141,294 lekë, ndërsa në vitin 2021 në 26 raste janë kryer pagesa jashtë këtij afati në vlerën 3,943,007 lekë. Për pagesat e kryera për investime rezultoi se janë kryer pagesa jashtë afatit 30 ditor për vitin 2020 në 3 raste në vlerën 51,832,955 lekë, ndërsa në vitin 2021 në 7 raste në vlerën 69,675,202 lekë.

Për pagesat e kryera të llog. 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, rezultoi se për vitin 2021 janë kryer pagesa në 3 raste me vlerë 180,000 lekë, likuidim me vonesë mbi afatin ligjor 30 ditor të pagesës nga data e mbërritjes së faturës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për likuidimin e të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga momenti i paraqitjes së faturës tatimore të shitjes, me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

*6.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar*

*Pa zbatuar*

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua mos realizim në treguesit e buxhetit, veçanërisht për sa i përket të ardhurave vendore, mos realizim i cili ka krijuar detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, duke paraqitur një risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, sepse ky buxhet i vitit ushtrimor do të përdoret jo për të financuar nevojat reale, por për të likuiduar detyrime të prapambetura për investimet, mallrat e shërbimet, ku gjendje progresive e detyrimeve në vitet është si më poshtë ;

-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2020 në vlerë 119,416,085 lekë (shlyerje në vitin 2020, vlera 84,147,165 lekë);

-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2021 në vlerë 35,268,920 lekë (shlyerje në vitin 2021, vlera 7,963,524 lekë), të pasqyruara në aneksin bashkëlidhur raportit të auditimit, veprime në mospërputhje me neni 50 “Angazhimet buxhetore”, neni(52) “Kryerja e shpenzimeve”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 56, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017“Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika (62) UMFE nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; UMF nr.5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, UMFE (plotësues) nr.4, datë 25.01.2021 “Për buxhetin e vitit 2021”, pikat (115-125) “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën e detyrimeve të prapambetura prej **35,268,920 lekë**.

#### **Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak**

*7.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar VKB nr. 3 datë 08.02.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokastrë: me shkresën nr. 175/1 prot date 24.02.2022.*

*Sa më sipër rezulton se nuk është miratuar një grafik i likuidimit të detyrimeve të prapambetura, por nga bashkia Këlcyrë është vazhduar me likuidimin e detyrimeve kjo dhe sipas shkresës nr. 520 prot., datë 21.02.2023 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore.*

#### **Në proces zbatimi**

**8.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi 2020 dhe 2021, Titullari i Bashkisë Këlcyrë nuk ka nxjerrë urdhër për inventarizimin e pajisjeve, aktiveve dhe inventarin ekonomik në institucionin e bashkisë dhe institucionet e varësisë. Mos kryerja e procesit të inventarizimit bënë që të mos njihet saktë gjendja fizike e aktiveve si dhe ekzistenca e tyre. Gjithashtu mungesa e këtij procesi, nuk jep siguri se llogaritë e pasqyrave fianciare që lidhen me aktivet janë të sakta. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr.20 datë 17.11.2014 “për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 81-94.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Nëpunësit Autorizues, të marri masa për të nxjerrë çdo vit, urdhrat përkatës për inventarizimin periodik të aktiveve të çdo niveli të njësisë publike, në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

*8.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar*

#### **Pa zbatuar**

**9.Gjetje nga auditimi:** Shuma e paraqitur në bilancin e vitit 2021 për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 6,078,720 lekë, nuk reflekton saktësisht gjendjen e kësaj llogarie. Diferenca e debitorëve progresiv të vitit 2021 në shumën 69,602,000 lekë, me debitorët progresiv të vitit 2020 në shumën 61,910,000 lekë, llogaritet në shumën 7,692,000 lekë e cila nuk korrespondon me debitorët e vitit 2021 të paraqitur në bilanc në shumën 6,078,720 lekë. Kjo pasaktësi llogaritet në masën 1,613,280 lekë. Nga auditimi u konstatua se shkresa nr.303, datë 10.02.2021 “Debitorët për vitin 2020” dhe shkresa nr.578, datë 15.03.2022 ”Debitor për vitin 2021”, të cilat janë përgatitur dhe dërguar në zyrën e protokollit jashtë afateve ligjore për tu shqyrtuar dhe përpunuar nga zyra e financës për mbylljen e pasqyrave financiare. Në librat e qarkullimit të shkresave të brendshme pranë zyrës së protokoll arkivës në Bashkinë Këlcyrë, u vu re se këto evidenca nuk janë përcjellë dhe as nuk janë administruar nga Zyra e Financës së bashkisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3, faqe 42-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, të kërkoj në formë shkresore nga Përgjegjësja e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, detyrimet progresive të vitit 2020 dhe 2021, pas verifikimit të të cilave të marri masa për të kryer veprimet e sistemimit në bilanc për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën **7,692,000 lekë**. Gjithashtu, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022**

*9.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar bilancit vjetor të vitit 2022 dërguar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. 799 prot datë 27.03.2023 rezulton se në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” është pasqyruar vlera e debitorëve nga biznesi.*

#### **Në proces zbatimi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se vlera e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” në pasqyrat financiare të viti 2021 ka vlerën 7,929,513 lekë, e cila nuk rakordon me shumën e llogarive kundërparti në pasiv të pasqyrave e cila është në vlerën 48,190,173 lekë. Si rezultat llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin” është paraqitur në pasqyrat financiare për 40,260,660 lekë më pak. Llogaritë e klasës 4, nuk kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t’u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3, faqe 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, të marri masa për sistemimin në bilanc të llogarisë 4243 “Debitorë të ndryshëm” në mënyrë që në këtë llogari të përfshihet edhe vlera prej **40,260,660**

lekë, e cila ekziston në analizën e llogarisë, por nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022**

*10.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar bilancit vjetor të vitit 2022 dërguar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. 799 prot datë 27.03.2023 rezulton se llogaria e sipërcituar është mbyll në mënyrë të gabuar.*

#### ***Pa zbatuar***

**11. Gjetje nga auditimi:** Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën neto 129,760 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 “Studime e kërkime”. Paraqitja e kësaj vlere në pasqyrat financiare, nuk mbështetet me dokumentacion, pasi struktura e financës nuk administron dokumentacion për analizën analitike të kësaj llogarie. Si e tillë, konstatohet se nuk ka informacion nëse vlera e studimeve dhe projekteve të përkasin objekteve të përfunduara apo jo, duke mos dhënë siguri për vlerën e saktë të llogarisë 202 në pasqyrat financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3, faqe 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin e listës analitike të llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke vendosur në këtë listë vetëm projektet dhe studimet për investimet e pa përfunduara dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia Këlcyrë. Llogaria 202 “Studime e kërkime” në pasqyrat financiare të rakordojë me vlerën e analizës analitike së kësaj llogarie.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022**

*11.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar bilancit vjetor të vitit 2022 dërguar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. 799 prot datë 27.03.2023 rezulton se llogaria e sipërcituar është mbyll në mënyrë të gabuar.*

#### ***Pa zbatuar***

**12. Gjetje nga auditimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të paraqitur 0 lekë në bilanc, në kundërshtim me VKM nr.433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3, faqe 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, torje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022**



*12.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar bilancit vjetor të vitit 2022 dërguar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. 799 prot datë 27.03.2023 rezulton se llogaria e sipërcituar është mbyll në mënyrë të gabuar.*

***Pa zbatuar***

**13.Gjetje nga auditimi:** Aktivet afatgjata materiale të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Këlcyrë nuk ka inicuar procesin për rregjistrimin e tyre.(*Më hollësisht është trajtuar në pika nr.2.2.3 faqe 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1.Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Këlcyrë.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022**

*13.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar bilancit vjetor të vitit 2022 dërguar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. 799 prot datë 27.03.2023 rezulton se llogaria e sipërcituar është mbyll në mënyrë të gabuar pasi nuk ka inicuar procesin për rregjistrimin e tyre.*

***Pa zbatuar***

**14.Gjetje nga auditimi:** Kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Këlcyrë në “Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA, përbën investim me vlerë kontabël (kosto) 21,259,000 lekë dhe investitori është Bashkia Këlcyrë, për të cilën nuk janë reflektuar në gjendjen e llogarisë 26 “Aktivet Afatgjata Financiare” fitim-humbjet nga pjesa e aksioneve për vitet 2016-2021. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 70,867,000.00 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP” pika 2.1. (*Më hollësisht është trajtuar në pika nr.2.2.3 faqe 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1.Rekomandim:** Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë ShA me vlerë kontabël **21,259,000 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022**

*14.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar bilancit vjetor të vitit 2022 dërguar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. 799 prot datë 27.03.2023 rezulton se llogaria e sipërcituar është mbyll në mënyrë të gabuar.*

***Pa zbatuar***

**C.2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, u konstatua se 4 subjekte që ushtrojnë këtë aktivitet në Bashkinë Këlcyrë, janë debitor për taksën e licencës në vlerën totale 4,000,000 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore. Lista e subjekteve debitor dhe vlera përkatëse për secilin paraqitet në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak, me VKM nr.

970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 të Bashkisë Këlcyrë, për periudhën 01.07.2020-2021.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **4,000,000 lekë** nga 4 subjektet debitor për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit.

### **Brenda muajit dhjetor 2022**

*1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga verifikimi rezultoi se për vitin 2022 bashkia Këlcyrë ka pajisur me autorizim 1 vjeçar 2 subjekte të cilat kanë likuiduar detyrimet sipas autorizimit në vlerën 800,000 lekë. Referuar aneksit të sipërcituar. Rekomandimi i lënë nga KLSH nuk është zbatuar nga Bashkia Këlcyrë, pasi nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës 4,000,000 lekë.*

#### ***Pa zbatuar***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik, për periudhën e auditimit 01.07.2020-2021, në kundërshtim me parashikimet e bëra në paketën fiskale të Bashkisë Këlcyrë për periudhën e auditimit. Kjo anomali është konstatuar për 3 subjekte, sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2 bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit, duke shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën totale 124,000 lekë. Subjektet nuk janë pajisur me nipte sekondare për punimet e ndërtimit në kundërshtim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1/1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **124,000 lekë**, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Këlcyrë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipa aneksit nr.2.2/6/2 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të auditimit.

#### **Menjëherë**

*2.2. Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.*

#### ***Pa zbatuar***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga puna e pa mjaftueshme e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2021 kanë vlerën progresive 69,602 mijë lekë (së bashku me kamatëvonesat), e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat;

- Biznesi 20,231 mijë lekë
- Tokë bujqësore 42,138 mijë lekë
- Taksa tarifa familjare 7,198 mijë lekë

Vlera e borxhit të krijuar vetëm gjatë vitit 2021 ka vlerën 7,692 mijë lekë nga të cilat

- Biznesi 1,298 mijë lekë
- Familjet tarifa 1,399 mijë lekë
- Familjet tokë 4,768 mijë lekë

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 01.07.2020-2021.

Nga Bashkia Këlcyrë nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shteruese, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 89, 90, 91, 93 të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore.

- Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtorja Rajonale Gjirokastër për vlerën debitore 133,799 lekë, sipas aneksit nr. 2/6/7, në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23 dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 86 datë 2.12.2019 dhe vendimi nr. 39 datë 28.12.2020 “Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.2 faqe 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën **69,602 mijë lekë** dhe kjo vlerë të kontabilizohet nga sektori i financës. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimor dhe në vazhdim të merren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVPP), kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet Neni 93 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

-Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Zyrën e Taksave e Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake të marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-

Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, për vlerën debitorë **133,799 lekë**, sipas aneksit nr. 2/6/7, në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23 dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 86 datë 2.12.2019 dhe vendimi nr. 39 datë 28.12.2020 “Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore”.

#### **Menjëherë**

*3.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Në krahasim me vitin 2021, gjendja e debitorëve vjen në rritje, ku në fund të vitit 2021 vjen në vlerën 63,685 mijë lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 72,228 mijë lekë ose me rritje në vlerën 8,543 mijë lekë.*

*Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Këlcyrë, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, **veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhura për Bashkinë Këlcyrë, në vlerën 72,228 mijë lekë për vitin 2022.***

*Sa më sipër zyra e taksave dhe tarifave vendore është mjaftuar vetëm me njoftimin e detyrimeve si dhe nuk ka ndërmarr asnjë masë tjetër për arkëtimin e debitorëve.*

#### **Në proces zbatimi**

#### **V- Konkluzione dhe rekomandime:**

*Në përfundim të procesit të auditimit, konstatohet se pjesa më me peshë e rekomandimeve nuk është zbatuar, apo është zbatuar pjesërisht, si vijon:*

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim kontrollin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme.

**2.2.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Këlcyrë, me qëllim rritjen e sigurisë për realizimin e objektivave dhe ofrimin e këshillave për drejtimin e institucionit, sidomos për sistemin e kontrollit të brendshëm.

**3.1 Rekomandim:** Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar edhe kërkesat e tyre buxhetore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në fund të çdo viti buxhetor të përgatis dhe të paraqes për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në vijim Këshilli Bashkiak Këlcyrë të marr vendimet brenda afateve.

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për likuidimin e të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga momenti i paraqitjes së faturës tatimore të shitjes, me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

**8.1 Rekomandimi:** Nëpunësit Autorizues, të marrin masa për të nxjerrë çdo vit, urdhrat përkatës për inventarizimin periodik të aktiveve të çdo niveli të njësisë publike, në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

**10.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, të marrin masa për sistemimin në bilanc të llogarisë 4243 “Debitorë të ndryshëm” në mënyrë që në këtë llogari të përfshihet edhe vlera prej 40,260,660 lekë, e cila ekziston në analizën e llogarisë, por nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

**11.1 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrin masa për hartimin e listës analitike të llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke vendosur në këtë listë vetëm projektet dhe studimet për investimet e pa përfunduara dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia Këlcyre. Llogaria 202 “Studime e kërkime” në pasqyrat financiare të rakordojë me vlerën e analizës analitike së kësaj llogarie.

**12.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyre dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, torje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

**13.1.Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Këlcyre dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Këlcyre.

**14.1.Rekomandim:** Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Kanalizime Këlcyre ShA me vlerë kontabël 21,259,000 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Rekomandim mbas verifikimit:** Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Këlcyre ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat e konsideruara të pa zbatuara të cilat janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual me qëllim përmirësimin e situatës.

**Kriteri:**

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), *ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime,*

**Shkaku:**

Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 108,300 lekë.

**Ndikimi/Efekti:**

Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Këlcyre.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandim:**

Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përsheptuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara si vijon;

**Masa organizative të ri kërkuara në total 12, një prej të cilave e zbatuar pjesërisht, ndërsa 11 masa të pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:**

**1.1 Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Këlcyrë të merren masa për të rritur njohuritë mbi Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit si dhe për zbatimin e të gjithë komponentëve të saj. Burimet njerëzore të kenë një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve dhe të ngrihet GMS- ja, të vendoset koordinatori i riskut, të miratohet “Strategjia e Menaxhimit të Riskut”.

Për pozicionin e punës vakant së Përgjegjësit të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit të shpallet vendi i lirë i punës. **(Zbatuar pjesërisht).**

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim kontrollin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme.

**2.2.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Këlcyrë, me qëllim rritjen e sigurisë për realizimin e objektivave dhe ofrimin e këshillave për drejtimin e institucionit, sidomos për sistemin e kontrollit të brendshëm.

**3.1 Rekomandim:** Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar edhe kërkesat e tyre buxhetore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në fund të çdo viti buxhetor të përgatis dhe të paraqes për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në vijim Këshilli Bashkiak Këlcyrë të marr vendimet brenda afateve.

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për likuidimin e të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga momenti i paraqitjes së faturës tatimore të shitjes, me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

**8.1 Rekomandimi:** Nëpunësit Autorizues, të marri masa për të nxjerrë çdo vit, urdhrat përkatës për inventarizimin periodik të aktiveve të çdo niveli të njësisë publike, në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

**10.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, të marri masa për sistemimin në bilanc të llogarisë 4243 “Debitorë të ndryshëm” në mënyrë që në këtë llogari të përfshihet edhe vlera prej 40,260,660 lekë, e cila ekziston në analizën e llogarisë, por nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

**11.1 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin e listës analitike të llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke vendosur në këtë listë vetëm projektet dhe studimet për

investimet e pa përfunduara dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia Këlcyrë. Llogaria 202 “Studime e kërkime” në pasqyrat financiare të rakordojë me vlerën e analizës analitike së kësaj llogarie.

**12.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, torje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

**13.1.Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Këlcyrë.

**14.1.Rekomandim:** Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjiellës Kanalizime Këlcyrë ShA me vlerë kontabël **21,259,000 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

## **C.2. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre.**

**1.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **4,000,000 lekë** nga 4 subjektet debitor për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit.

### **Brenda muajit dhjetor 2022**

*1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga verifikimi rezultoi se për vitin 2022 bashkia Këlcyrë ka pajisur me autorizim 1 vjeçar 2 subjekte të cilat kanë likuiduar detyrimet sipas autorizimit në vlerën 800,000 lekë. Referuar aneksit të sipërcituar. Rekomandimi i lënë nga KLSH nuk është zbatuar nga Bashkia Këlcyrë, pasi nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës 4,000,000 lekë.*

### **Pa zbatuar**

**2.1 Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **124,000 lekë**, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Këlcyrë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipa aneksit nr.2.2/6/2 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të auditimit.

### **Menjëherë**

*2.2. Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.*

## **Me qëllim përmirësimit e gjendjes, rekomandohen masat si vijon:**

### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë evidentuar nevojat për trajnim dhe nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Hartimi dhe zbatimi i strukturës organizative nuk garanton realizimin e plotë të objektivave të njësisë vendore për disa fusha të veprimtarisë së saj, si vijon:

- Nuk është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen dhe një mirë menaxhim të asetëve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim, si dhe kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

-Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Planifikimi dhe Zhvillimit të Territorit nuk janë plotësuar me të gjithë punonjësit sipas numrit të strukturës së miratuar.

Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese.

Nuk është hartuar rregjistër i riskut, duke mos marrë masa për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim nenin 16, 20, 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, nenin 64, pika h dhe j të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKB Nr. 03, datë 18.01.2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-19 dhe pikën 3, faqe 41-60, të raportit përfundimtar të auditimit).*

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa për hartimin e programit vjetor për trajnimin e stafit, mbi bazën e evidentimit më parë të nevojave reale për trajnim.

***Deri më 31.12.2023***

**1.2. a)** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të parashikojë në strukturën organizative të institucionit: - Krijimin e sektorit të Administrimit të Aseteve me qëllim garantimin e ruajtjes dhe mirë menaxhimi të asetëve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim;

- Krijimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

**b)** Të plotësohet sipas numrit të strukturës së miratuar në VKB Nr. 03, datë 18.01.2022, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Njësia e Auditit të Brendshëm.

***Deri më 31.12.2023***

**1.3.** Nga secili sektor të hartohet rregjistri i riskut, për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre, të hartohet harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për këto procese.

***Deri më 31.12.2023***

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë miratimi i taveveve buxhetore afatmesëm 2022-2024 me Vendim të Këshillit Bashkiak, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e programit



buxhetor afatmesëm 2022- 2024.

Nuk janë përgatitur nga strukturat përkatëse të institucionit dhe nuk ka vendim të Këshillit Bashkiak për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2022-2024, si dhe për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Këlcyrë për këtë periudhë, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, 34.

Mungon plani i masave dhe veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor për të gjithë periudhën e auditimit. Në këto plane duhet të përcaktoheshin aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.

Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 19-28 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**2.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, më parë të kryej konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit, njësitë administrative etj. dhe të bëjë dokumentimin e këtyre konsultimeve. Të ngrihet grupi i punës për hartimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe kalendarit të miratohet në Këshillin Bashkiak.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi brenda vitit buxhetor konstatohet fenomeni i pagesës së një pjesë të këtij detyrimi, por njëkohësisht edhe krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura. Konkretisht në datën 01.01.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta, është 42,260,660 lekë, ku peshën kryesore e zënë detyrimet për investime në vlerën 39,297,136 lekë. Gjatë vitit buxhetor 2022 nga detyrimi i mësipërm është likuiduar vlera 13,807,190 lekë, por njëkohësisht gjatë këtij viti janë krijuar edhe detyrime të reja të prapambetura për shpenzime operative në vlerën 1,156,274 lekë. Kjo ka bërë që vlera reale e uljes së detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2022 të jetë jo 13,807,190 lekë, por 12,650,916 lekë. Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 19-28 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**3.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Financës të marrin masa që në hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, proritët të kenë detyrimet e prapambetura nga vitet e mëparshme, duke mbuluar më parë me fonde këto detyrime. Të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor.

Lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i parashikuar në kontratë të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

### *Menjëherë e në vijimësi*

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Këlcyrë, në lidhje me kontratat e qirave për pyje dhe kullota, rezulton se për vitin 2022 janë lidhur 30 kontrata, për të cilat nuk ka detyrime të pa likuiduara, por u konstatuan anomalitë si vijon:

Në kontratat në çdo rast nuk është bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (*sipas vendimit të komisionit të ndarjes së kullotave apo vendimit të këshillit të komunës*).

Në kontratë është përcaktuar se ato i referohen hartës bashkëlidhur çdo kontrate, por në fakt nuk administrohet një dokument i tillë, por vetëm një skicë e thjeshtë e cila nuk është miratuar nga titullari i institucionit apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij.

-Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfutur kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrimit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.

Lidhja e tyre përgjithësisht është bërë në mungesë të konfirmimit (vërtetimit) të numrit të bagëtive, dokument i cili lëshohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare, dhe konfirmon regjistrin e bagëtive dhe matrikullit të tyre sipas sistemit “Ruda”, duke mos bërë krahasimin e llojit dhe numrit të krerëve sipas kontratës me regjistrin e DRSHV, për secilin vit, si dhe eliminimit të rasteve të lidhjes së kontratave me persona të cilët nuk figurojnë të regjistruar në listën e blegtorëve.

Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.

Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.

Nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave në ish-ZVRPP Gjirokastër, sot ASHK Drejtoria Gjirokastër.

Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nën ngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.

Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.

Nuk janë përcaktuar kritere lidhur me afatin i cili duhet të jetë një vjeçar dhe pagesa të bëhet e menjëhershme në momentin e kontratës. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**4.1.Rekomandim:** Për të gjitha kontrata e dhënies me qira të fondit pyjor e kullor, duhet të krijohet dosje individuale, ku të pasqyrohen qartazi të gjitha të dhënat mbi fermerin, llojin e bagëtive që mbarështon, numrin e tyre, si dhe vërtetimin nxjerrë nga sistemi RUDA me të dhënave e marra nga AZHBR, si dhe parcela kullimore e dhënë në përdorim, sipas skicës së miratuar dhe të bashkëlidhur çdo kontrate.

**4.2.Rekomandim:** Të merren masa që kontratat për sipërfaqet kullimore të jepen në raport me numrin e krerëve që disponon çdo subjekt, sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare (dokument i cili duhet të shoqërojë kontratën) dhe të dhënave të AZHBR (Sistemi Rud), mbi numrin e krerëve të deklaruar dhe regjistruar në këtë sistem.

*Menjëherë e në vijimësi*

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, (debitor datë 31.12.2022) në aktiv të pasqyrave financiare nuk është e sakt, sepse kjo llogari ka vlerën 8,524,875 lekë, por në fakt duhet të ketë vlerën 36,978,285 lekë. Pra llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, është e nënvlerësuar me vlerën 28,453,410 lekë. Llogaria 4342 është kundërparti e shumës së llogarive të mëposhtme dhe nuk rakordon me to për vlerën 28,453,410 lekë:

-Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 28,453,410 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 6,153,280 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 201,001 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,170,594 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 0 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 36-54 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**5.1.Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, në mënyrë që kjo llogari të paraqesë vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën neto 100,204 lekë. Paraqitja e kësaj vlere në pasqyrat financiare, nuk mbështetet me dokumentacion, pasi struktura e financës nuk administron analizën analitike të kësaj llogarie. Për këtë arsye pasqyrat financiare nuk japin siguri se jo llogari është e saktë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara ”Pika 1/b “Klasifikimi kontabël”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 41-60 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**6.1.Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të hartojë listën analitike të llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në mënyrë që vlera e paraqitur në pasqyrat financiare të jetë e mbështetur në dokumentacionin vërtetues. Për rastet kur investimi ka përfunduar, të kalohet vlera e projektit në vlerën e investimit, duke u paksuar me vlerën e projektit llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023*

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se për vitin 2022 Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të cilat në bilanc paraqiten në vlerën 0 lekë.

Mos kryerja e procesit të inventarizimit është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE Nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 41-60 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**7.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale, të pa inventarizuara deri më

sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023*

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar rregjistër kontabël për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra që zotëron apo ka ne administrim, përfshi dhe pronat e njësisë vendore. Për këtë arsye nuk ka të dhëna të sakta për aktivet lidhur me datën e hyrjes ose marrjes ne dorëzim, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale te mëpasshme qe sjellin rritje te vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve te mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26-33. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 41-60 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**8.1.Rekomandim:** Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit kontabël për të gjitha aktivet e njësisë vendore, atyre afatshkurtra dhe afatgjata, përfshirë edhe pronat e njësisë vendore në pronësi apo në përdorim.

#### *Deri më 31.12.2023*

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DT, seksioni i kapacitetit teknik, u konstatua se në tre procedura prokurimi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, me aftësinë zbatuese të saj, pasi zërat e preventivit nuk justifikojnë kriteret e vendosura. Të tilla janë si kërkesa për licenca, kërkesa e një numri mjetesh shumë më i madh se numri i drejtuesve të mjetit, kërkesa për ekspert zjarrfikës, shërbime për auditim mjedisor etj. Anomalitë e mësipërme u konstatuan në procedurat e prokurimit me objekt: “Ndërtim Ujësjiellësish për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)”, vlerë të fondit limit 252,277,207 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, “Përmirësim i banesave ekzistuese”, vlerë të fondit limit 16,478,713 lekë, zhvilluar në vitin 2022 “Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Mbrezhanit – Malshovë”, vlerë të fondit limit 58,333,333 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021. Veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 4, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**9.1.Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa për eliminimin e mangësive në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, duke shmangur vendosjen e kriterëve të cilët nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit, konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike. Në këtë procesverbal nga njësia e prokurimit është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën autoritetit kontraktor, që gjatë hartimit të kriterëve mund t’u kërkojë ofertuesve plotësimin e një numri të caktuar kriteresh të nevojshme, por nuk është argumentuar teknikisht lidhja e kriterit të vendosur me objektin e kontratës, se me cilin zë konkret të preventivit lidhet kriteri i vendosur. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. . (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).

**10.1.Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa që gjatë hartimit të kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, të bëhet argumentimi teknik i secilit kriter të vendosur, ku të shpjegohet se me cilin zë të preventivit lidhet çdo kriter i hartuar nga autoriteti kontraktor.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në një rast, në tenderin me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese”, vlerë të fondit limit 16,478,713 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2022, asnjë nga operatorët ekonomik nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, por KVO ka kualifikuar si fitues, BOE 2&E, me vlerë të ofertës ekonomike 16,391,400 lekë pa TVSh. KVO duhet ti kishte propozuar titullarit të autoritetit kontraktor anullimin e tenderit. Këto veprime kanë sjellë lidhjen e kontratës me një operatorë ekonomik të shpallur fitues në kundërshtim me nenin 98, pika të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me nenin 82, pika 2, germa (i) të VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).

**11.1.Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor të marrë masa për një vlerësim të barabartë të operatorve ekonomik dhe të shmang rastet e kualifikimit të operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DT. Në raste të tilla të bëhet anulimi i tenderit.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyrë për vitin 2021 dhe 2022 ka caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht person përgjegjës për prokurimin Znj. F.S., e cila sipas të dhënave të Bashkisë Këlcyrë, është punonjëse me kohë të plotë e Bashkisë Tiranë.

Për këtë qëllim në datën 06.01.2022 është lidhur aktmarrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S., pa numër protokolli.

Nevoja për marrjen e një personi nga një autoritet tjetër kontraktor nuk është e argumentuar nga Bashkia Këlcyrë, pasi ky institucion nuk ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit. Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton detyrimin që subjektet të kenë pa tjetër një jurist në njësinë e prokurimit. Detyrimi që ka vendosur nenin 74 i VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me personin përgjegjës për prokurimin është:

Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë.

Gjithashtu po ky nen, ka vendosur detyrimin për titullarin e autoritetit kontraktor si vijon: Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik. Bashkia Këlcyrë ka në strukturën e saj personel me arsim të lartë për kryerjen e kësaj detyre, të cilët më parë duhet të trajnohen prej saj.

Nga auditimi konstatohet se edhe procedura e ndjekur për këtë qëllim është e gabuar. Bashkia Këlcyrë nuk i është drejtuar me shkresë zyrtare asnjë autoriteti kontraktor, pra as Bashkisë Tiranë, në mënyrë që ky institucion, nëse pranon kërkesën, të përcaktojë vetë personin.

Në rast të nevojave të tilla, është institucioni Bashkia Tiranë që përcakton se cili do të jetë punonjësi i kërkuar nga Bashkia Këlcyrë dhe, nuk pranon dhe miraton punonjësi për veten e vet që të bëhet pjesë e njësisë së prokurimit dhe person përgjegjës në një institucion tjetër.

Akt-marrëveshja midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S nuk është një marrëdhënie midis dy

institucioneve, pasi nuk paraprihet nga aktmarrëveshja prej dy institucioneve, por një marrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe punonjësit të Bashkisë Tiranë (të cilit për arsye se është i punësuar me kohë të plotë pranë Bashkisë Tiranë, nuk i lejohej të kryej detyra të tjera jashtë këtij institucioni pa autorizimin dhe miratimin e titullarit të Bashkisë Tiranë, brenda orarit zyrtar të punës). Në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohen detyrat e personit përgjegjës për prokurimin, kryerja e të cilave kërkon kohën e nevojshme në dispozicion, angazhim konkret brenda orarit të punës dhe brenda institucionit të Bashkisë Këlcyrë që në rastin konkret janë të pa mundura, për arsyet e shpjeguar më sipër. Me Bashkinë Tiranë, kjo gjë vështirësohet akoma më shumë për shkak të distancës midis dy institucioneve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**12.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për ndërprerjen e aktmarrëveshjes që ka bërë me Znj. F.S., në të cilën është përcaktuar si person përgjegjës për prokurimin publik, si dhe të përcaktojë në këtë pozicion punonjës brenda strukturës së vet, duke siguruar trajnimin e tyre. Në rastet e tenderave që do të kërkojnë njohuri të specializuara, Bashkia Këlcyrë të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**13.Gjetja nga auditimi:** Në kontratën me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë” është parashikuar instalimi i sistemit SCADA në stacionin e pompimit Këlcyrë si dhe në depon 700 m<sup>3</sup>. Ky sistem do të bëjë të mundur matjen e prurjeve, nivelin e rezervuarit dhe konsumin në dalje të depos nëpërmjet matësve elektronik e kështu komandimin në distancë të elektro-pompave duke minimizuar kostot e prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu nëpërmjet matësve në sistemin e shpërndarjes bëhet kontrolli i humbjeve në rrjet duke i krahasuar me konsumin total të klientëve. Referuar sasisë që hyn në sistemin e shpërndarjes, e matur nga matësat elektronik në dalje të depos, bëhet dezinfektimi i ujit të pijshëm me hipoklorit natriumi të koordinuara nëpërmjet sistemit SCADA. Nga auditimi në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesit të Bashkisë Këlcyrë u konstatua se ishin instaluar pajisjet e sistemit SCADA të parashikuara në kontratë por, ky sistem ishte jashtë funksionit, i pa programuar, matësat elektronik nuk tregonin matjet në panelet përkatëse si dhe sistemi i klorinimit ishte jo funksional. Në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që në përfundim të punimeve dhe aktin e kolauditimit sistemit SCADA ti jetë kryer testi i funksionimit (test report). Mosfunksionimi i sistemit të klorinimit tregon se sasia e ujit në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjeno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm rrezikon shëndetin publik të konsumatorëve dhe është në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, neni 6 “Kriteret e cilësisë së ujit të pijshëm” pika 1 dhe Kontrata Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 (specifikimet teknike). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 79-84 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**13.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA të marrë masa të menjëhershme për vendosjen në funksionim të sistemit SCADA, i cili do të kryej një kontroll sa më efikas të sistemit të prodhimit e të shpërndarjes për uljen e kostove të prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu të vendoset në funksion sistemi i klorinimit, i

koordinuar në mënyrë automatike me sistemin SCADA, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhë ruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

***Menjëherë e në vijimësi***

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin e-leje konstatohet se në tre raste, si më poshtë vijon, në dhënien e lejeve të ndërtimit nuk është marrë mendim nga institucionet e duhura ligjore si AZHT,ASHK,UK. Konkretisht rastet janë si vijon:

- Leje ndërtimi datë 28/09/2022 i jepet zhvilluesit A.S., i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M.G., leja e ndërtimit për objekt banimi 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Zhepovë, Bashkia Këlcyrë.

-leje ndërtimi nr. 1148, datë 28/05/2021 i jepet: zhvilluesit Z.K, S.K, i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: R.SH leja e ndërtimit për objektin banesë 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Podgoran, Bashkia Këlcyrë.

- Leje ndërtimi, datë 28/05/2021 i jepet shoqërisë “L” ME licence n, drejtues ligjor E.L. zhvilluesit: Z.K, S.K i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: R.SH leja e ndërtimit për objektin banesë 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Podgoran, Bashkia Këlcyrë.

- Leje ndërtimi nr. 876, datë 20/04/2022 i jepet zhvilluesit A.R i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: J.X leja e ndërtimit për objektin “Objekt 3 kate, kati pare njësi shërbimi, 2 kate njësi hyrëse ne funksion te bujtinës (D), adresa e realizimit të punimeve Këlcyrë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori”, Neni 15 pika ë). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 84-86 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**14.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa që në rastin e dhënies së lejeve të ndërtimit, më para të merret mendim nga institucionet e duhura ligjore si AZHT, ASHK, UK.

***Menjëherë e në vijimësi***

**15.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin e-leje konstatohet se leje ndërtimi datë 28/09/2022 i jepet: zhvilluesit A.S i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M.G., leja e ndërtimit për objektin banim 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Zhepovë, Bashkia Këlcyrë. Sipas projektuesit preventivi i llogaritur për këtë projekt është 5,289,082 lekë, ndërkohë kostoja minimale e këtij objekti llogaritur me koston e ndërtimit është 7,207,694 lekë. Për sa më sipër, hartimi i preventivit me vlerë nën koston e ndërtimit të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave, është në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 3 datë 28.12.2016 “Për Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave” është 32,614 lekë/m<sup>2</sup>. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 84-86 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**15.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa për të mos pranuar preventiv punimesh, vlera e të cilave është nën koston e ndërtimit që është miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave.

***Menjëherë e në vijimësi***

**16.Gjetje nga auditimi:** Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se leje ndërtimi nr. 876, datë 20/04/2022 i jepet: zhvilluesit A.R i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: J.X leja e ndërtimit për objektin “Objekt 3 kate, kati pare njësi shërbimi, 2 kate njësi hyrëse në funksion te bujtinës (D), adresa e realizimit të punimeve Këlcyrë. Objekti në orientimin jugor duhet ta kishte distancën nga kufiri i pronës jo më pak se 4 metër, por nga auditimi u konstatua se kjo distancë është 2.7 metër dhe 3.1 metër), në kundërshtim me neni 35 të Vendimin nr. 408,

datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 84-86 të raportit përfundimtar të auditimit).

**16.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa për të ndërprerë praktikën e miratimit të lejeve të ndërtimit pa respektuar distancat e lejuara nga kufiri i pronës, sipas legjislacionit në fuqi.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.**

Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Këlcyrë, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 262/6 prot., datë 01.08.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre. **Statusi i zbatimit të rekomandimeve është si vijon:**

**17.Gjetje nga auditimi:** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, të pranuar plotësisht nga subjekti, prej të cilave është zbatuar pjesërisht 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, nuk janë zbatuar 11 masa organizative.

Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të munguara), janë rekomanduar 3 masa, për arkëtim të vlerës totale 73,726,000 lekë, të pranuar nga subjekti, prej të cilave dy masa janë të pa zbatuar, ndërsa një masa është në proces zbatimi.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7. faqe 87-103 të raportit përfundimtar të auditimit).

**17.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 262/6 prot., datë 01.08.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht. Masat të cilat ri kërkon KLSH për tu zbatuar (menjëherë) nga Bashkia Këlcyrë janë si vijon:

**Masa organizative të ri kërkuara në total 12, një prej të cilave e zbatuar pjesërisht, ndërsa 11 masa të pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:**

**1.1 Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Këlcyrë të merren masa për të rritur njohuritë mbi Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit si dhe për zbatimin e të gjithë komponentëve të saj. Burimet njerëzore të kenë një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve dhe të ngrihet GMS- ja, të vendoset koordinatori i riskut, të miratohet “Strategjia e Menaxhimit të Riskut”.

Për pozicionin e punës vakant së Përgjegjësit të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit të shpallet vendi i lirë i punës. **(Zbatuar pjesërisht).**

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim kontrollin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme.

**2.2.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Këlcyrë, me qëllim rritjen e sigurisë për realizimin e objektivave dhe



ofrimin e këshillave për drejtimin e institucionit, sidomos për sistemin e kontrollit të brendshëm.

**3.1 Rekomandim:** Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkretores, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

**4.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar edhe kërkesat e tyre buxhetore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në fund të çdo viti buxhetor të përgatis dhe të paraqes për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në vijim Këshilli Bashkiak Këlcyrë të marr vendimet brenda afateve.

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për likuidimin e të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga momenti i paraqitjes së faturës tatimore të shitjes, me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

**8.1 Rekomandimi:** Nëpunësit Autorizues, të marrin masa për të nxjerrë çdo vit, urdhrat përkatës për inventarizimin periodik të aktiveve të çdo niveli të njësisë publike, në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

**10.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, të marrin masa për sistemimin në bilanc të llogarisë 4243 “Debitorë të ndryshëm” në mënyrë që në këtë llogari të përfshihet edhe vlera prej 40,260,660 lekë, e cila ekziston në analizën e llogarisë, por nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

**11.1 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin e listës analitike të llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke vendosur në këtë listë vetëm projektet dhe studimet për investimet e pa përfunduara dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia Këlcyrë. Llogaria 202 “Studime e kërkime” në pasqyrat financiare të rakordojë me vlerën e analizës analitike së kësaj llogarie.

**12.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

**13.1.Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Këlcyrë.

**14.1.Rekomandim:** Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë ShA me vlerë kontabël **21,259,000 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

*Menjëherë*

**Për masat e rubrikës “Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të munguara)”, nga KLSH ri kërkohen për zbatim dy masa të pa zbatuara si vijon:**

**1.1.Rekomandim:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **4,000,000 lekë** nga 4 subjektet debitor për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit.

**2.1 Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **124,000 lekë**, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Këlcyrë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipa aneksit nr.2.2/6/2 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të auditimit.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **339,337 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga Auditimi:** Në objektin “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe BOE B&H me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 177,466,647 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 8 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr.1943prot. datë 03.07.2020, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën 362,733 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e

*punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën-pikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe OE “Z” sh.p.k me Nr.2041 Prot. datë 04.10.2019 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve në objektin, Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë”, Neni 7, pika 7.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 86-89 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës 339,337 lekë pa TVSH, nga BOE B&H sh.p.k, për volume punimesh të likujduara, por të pakryera në fakt sipas kontratës së lidhur me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 për realizimin e punimeve civile, vlerë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore.

***Deri më 30.11.2023***

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i mos marrjes së masave shtrënguese nga Bashkia Këlcyrë, janë krijuar debitorë nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar.

Gjendja e debitorëve më 31.12.2022 është në shumën **72,228 mijë lekë**, nga e cila debitorët e kategorisë private kanë vlerën 16,784 mijë lekë, ndërsa debitorët e kategorisë familjare kanë vlerën 55,444 mijë lekë, ose 76 % të totalit. Kjo vlerë konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar nga Bashkia Këlcyrë. Në vitin 2022 vlera e debitorëve ka ardhur në rritje krahasuar me vitin 2021, pasi në fund të vitit 2021 vlera e debitorëve është 63,685 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 kjo vlerë është 72,228 mijë lekë, ose 8,543 mijë lekë më e lartë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë të rinj në vlerën 8,543 mijë lekë.

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë masë tjetër shtrënguese për arkëtimin e debitorëve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve<sup>5</sup>, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët privat dhe familjar, si dhe në vijim të ndjekin të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve prej 72,228 mijë lekë nga debitorët e privat dhe familjar.

***Deri më 31.12.2023***

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për katër subjekte të cilët zhvillojnë

<sup>5</sup> “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

aktivitetin e tregimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, nga Bashkia Këlcyrë nuk është aplikuar tarifa për paisjem me autorizim për zhvillimin e aktivitetit të mësipërm. Nga këto veprime në total është krijuar një e ardhur e munguar në vlerën **8,000,000 lekë**, sipas detyrimeve të subjekteve në vijim:

Subjekti D., për vlerën prej 1,800,000 lekë.

-Subjekti E., për vlerën prej 3,300,000 lekë.

-Subjekti D., për vlerën prej 2,200,000 lekë.

-Subjekti A., për vlerën prej 700,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).

**2.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **8,000,000 lekë** nga 4 subjektet si vijon:

-Subjekti D., për vlerën prej 1,800,000 lekë.

-Subjekti E., për vlerën prej 3,300,000 lekë.

-Subjekti D., për vlerën prej 2,200,000 lekë.

-Subjekti A., për vlerën prej 700,000 lekë.

*Deri më 31.12.2023*

**3.Gjetje nga auditimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Ka mospërputhje të theksuar midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar, sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki, për të marrë evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se për vitin 2022 realizimi paraqitet në masën 50.6% ose nga 2,300 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 1,163 mijë lekë, ndërsa referuar të dhënave të Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Këlcyrë, rezulton se toka bujqësore u përket kategorive IV deri VII, sipas përkatësisë, Kategoria e V 753 Ha, kategoria VI 1,971 Ha dhe kategoria VII 1,928 Ha. Gjithsej fondi i tokës bujqësore për Bashkinë Këlcyrë është **4,652 Ha**. Nga sa më sipër diferenca në planifikim është **3,127,250 lekë** për vitin 2022 (5,427,250 - 2,300,000), gjë e cila ka sjell të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë për vitin 2022 në vlerën **3,127,250 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).

**3.1.Rekomandim:** Për një planifikimin të saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojë rregjistrin e taksapaguesve familjar për tokën bujqësore, duke evidentuar të gjithë personat të cilët janë pajisur me tokë bujqësore, sipas AMTP. Për plotësimin e të dhënave të bashkëpunohet me Sektorin e Bujqësisë.

*Deri më 31.12.2023*

**4.Gjetje nga auditimi:** Në auditimi u konstatua se nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 7 persona, në vlerën totale **188,754 lekë**, prej të cilëve dy persona në vlerën totale 46,394 lekë i përkasin vitit 2022, ndërsa 5 persona në vlerën totale 142,360 lekë i përkasin periudhës përpara vitit 2022. Vlera 188,754 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për

Bashkinë Këlcyrë (sipas listës analitike të pasqyruar në aneksin nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit). Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Këlcyrë, nuk është mbajtur korespondencë me ASHK Gjirokastër, për tu informuar lidhur me numrin e legalizimeve që ka bërë kjo agjenci, në mënyrë që Bashkia Këlcyrë të evidentojë personat të cilët kanë bërë legalizim objekti, por nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe, mbi bazën e këtij informacioni të kërkojë prej tyre shlyerjen e detyrimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, i ndryshuar, pika nr. 5 -Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja që janë në proces legalizimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).

**4.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës 188,754 lekë nga 7 persona debitor, sipas listës analitike të pasqyruar në aneksin nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit).

**2.2. Rekomandim** Të mbajë korespondencë të vazhdueshme me ASHK Gjirokastër për të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi, me qëllim njohjen e situatës dhe përcaktimin e personave të cilët nuk kryejnë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe nxjerrjen e tyre si debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për subjektet të cilat kanë kryer punime dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë për periudhën 01.07.2020-31.12.2022, konstatohet se kanë lidhur kontrata me bashkinë 4 operator ekonomik për të cilët nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit me pasojë të ardhura të munguara për Bashkinë Këlcyrë në vlerën **153,400 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin nr. 86 datë 26.12.2019 të Këshillit të Bashkisë Këlcyrë dhe vendimi nr.39 datë 28.12.2020 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1/1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).

**5.1.Rekomandim:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **153,400 lekë**, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Këlcyrë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipas listës së mëposhtme:

- Subjekti “2.”, detyrimi në vlerën 57,600 lekë (në dy procedura prokurimi);
- Subjekti “B.”, detyrimi në vlerën 67,000 lekë;
- Subjekti Sh., detyrimi në vlerën 28,800 lekë;

*Deri më 30.11.2023*

## **D. MASA DISIPLINORE.**

### **I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, si dhe në pikën 1, germa (i), si dhe kontratë individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH dhe **në proporcion me shkeljen e kryer**, të fillojnë procedurat për dhënien e

masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, **për punonjësit e mëposhtëm:**

**1. Znj. V.K.**, me detyrë Përgjegjëse e Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

-Për anomalitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare.

- Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja ndaj të tretëve për periudhën 01.01.2022 -31.12.2022.

*(Më hollësisht, mangësitë trajtuar në pikën nr.2.1-2.5, faqe 19-28 dhe pikën 3, faqe 41-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2. Znj. L.J.**, me detyrë përgjegjës në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore;

**3. Z. M.Ç** me detyrë Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore;

**4. Z. I.K** me detyrë Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, me pasojë mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit 83,544 mijë lekë nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore.

**5. Z. J.N.**, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimeve, specialisti i fushës, për anomalië e konstatuara në hartimin e kriterëve të të vecanta të seksionit të kapacitetit teknik të DT, në tre tendera, me objekt: “Ndërtim Ujësjiellësish për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)”, zhvilluar në vitin 2021, “Përmirësim i banesave ekzistuese”, zhvilluar në vitin 2022, “Sistemin asfaltim i rrugës Ura e Mbrezhanit – Malshovë”, zhvilluar në vitin 2021.

Në hartimin e kriterëve është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2, germa (c), - nenin 39, pika 6.ç, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2 (Trajtuar më hollësisht në pikën 4.1-4.3, faqe 60-79 të raportit të auditimit).

-Gjithashtu për anomalitë e konstatuara në cilësinë e përgjegjës të Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 84-86 të raportit të auditimit).

**6. Z. O.H.**, me detyrë specialist i lartë në emergjenca civile & kadastrës;

**7. Z. A.Q.**, me detyrë specialist i taksave e tarifave vendore;

**8. Z. Q.P.**, me detyrë teknik i mesëm pyjesh. Të tre punonjësit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese”, vlerë të fondit limit 16,478,713 lekë, zhvilluar në vitin 2022. Në këtë tender është bërë kualifikimi i operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DT dhe nuk është anuluar tenderi, veprime në kundërshtim me nenin 98, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 82, pika 2, germa (i) të VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën 4.1-4.3, faqe 60-79).

## **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Bashkia Këlcyrë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për masat e marra nga ana Juaj, të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe, për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë. Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi, duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative, apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

## ANEKSET

Aneksi nr. 1 pika 2.1 Të dhëna në formë table për planifikimin e buxhetit bazë (buxheti i vet bashkisë) dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim:

Njesia	Bashkia Këlcyrë+ Ndërmarjet e vartësisë Viti 2022							
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)=(5)-(4)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	PBA Plan Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	79,470	90,150	90,150	90,591	80,433	10,158	89%
601	Sigurime Shoqërore	13,797	15,355	15,355	15,355	14,041	1,314	91%
<b>600+601</b>	<b>Paga +Sigurime</b>	<b>93,267</b>	<b>105,505</b>	<b>105,505</b>	<b>105,946</b>	<b>94,474</b>	<b>11,472</b>	<b>89%</b>
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	24,740	31,430	31,430	29,039	22,413	6,626	77%
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshm	31	400	400	400	0.5	399	0.13%
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	240	2,045	2,045	3,995	2,396	1,599	60%
<b>602-606</b>	<b>Shpenzime operative</b>	<b>25,011</b>	<b>33,875</b>	<b>33,875</b>	<b>33,434</b>	<b>24,810</b>	<b>8,624</b>	<b>74.2%</b>
Shpenzime Korrente								
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	18,000	12,120	12,120	12,120	12,000	0	100%
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>18,000</b>	<b>12,120</b>	<b>12,120</b>	<b>12,120</b>	<b>12,000</b>	<b>0</b>	<b>100%</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>136,278</b>	<b>151,500</b>	<b>151,500</b>	<b>151,500</b>	<b>131,284</b>	<b>20,216</b>	<b>87%</b>

*Burimi: Sektori i financës*

Të dhëna në formë table për planifikimin e buxhetit bazë (buxhet me fonde të kushtezuara-gjendja civile, ndihme paaftesi dhe investime me buxhet shteti) dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim:

Njesia	Bashkia Këlcyrë+ Ndërmarjet e vartësisë Viti 2022							
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)=(5)-(4)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	PBA Plan Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	2,332		1,807	1,767	1,048	719	59.3%
601	Sigurime Shoqërore	198		249	249	175	74	70%
<b>600+601</b>	<b>Paga +Sigurime</b>	<b>2,530</b>		<b>2,056</b>	<b>2,016</b>	<b>1,223</b>	<b>793</b>	<b>61%</b>
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	73		0	0	0	0	0
603	Subvencione			0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshm			422	422	422	0	100%
605	Transferta Korente të Huaja			0	0	0	0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	76,739		90,324	90,364	90,070	294	99.7%
<b>602-606</b>	<b>Shpenzime operative</b>	<b>76,812</b>		<b>90,746</b>	<b>90,786</b>	<b>90,492</b>	<b>294</b>	<b>99.7%</b>
Shpenzime Korrente								
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	148,053		66,374	66,374	66,374	0	100%
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>148,053</b>		<b>66,374</b>	<b>66,374</b>	<b>66,374</b>	<b>0</b>	<b>100%</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>227,395</b>		<b>159,176</b>	<b>159,176</b>	<b>158,089</b>	<b>1,087</b>	<b>99.3%</b>

*Burimi: Sektori i financës*

**Aneksi nr. 1 pika 2.2** Lista e investimeve në vazhdim të parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe granti paraqitet në aneksin nr. 2 pika 2.2 bashkëlidhur raportit të auditimit.



000/lekë

Nr	Emërtimi i investimit	Nr dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)
1	Sistemim asfaltim Rruga Suke Podgoran Fushe, Rruga Gorice, Rruga Komarak e Vinokash rruga Gur Fshat Kelcyre, Rruga Rriban.	Nr. 3 date 08.02.2022	Të ardhurat e veta	0	0
2	Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së Spitalit	Nr. 3 date 08.02.2022	Të ardhurat e veta	7,000	7,000
3	Sistemim asfaltim rruga Ura e Mbrezhanit Malshove	Nr. 3 date 08.02.2022	Të ardhurat e veta	5,000	5,000
4	Blerje pajisje Kompjuter, printer	Nr. 3 date 08.02.2022	Të ardhurat e veta	120	0
<b>Total të ardhurat e veta</b>				<b>12,120</b>	<b>12,000</b>

Burimi: Sektori i financës

Lista e investimeve të reja të pa parashikuara në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga buxheti shtetit.

000/lekë

Nr	Emërtimi i investimit	Nr dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)
1	Projekte për permiresimin e kushteve të banimit		Grant buxheti shtetit		12,174
<b>Total nga granti</b>					<b>12,174</b>

Burimi: Sektori i financës

**Aneksi nr. 2 pika 2.2** Tabela e ndryshimeve Buxhetore periudha 2022-2024

000/leke

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Viti 2022	Nr.3, dt.08/02/2022	151,500	V.K.B me Nr. 29 date 30.09.2022	611	6001-6001001 paga	611	602 shpenzime operative	611
			Urdher titullari Nr. 87 date 30.12.2022 për ndryshim buxheti midis zerave brenda të njëjtes strukture	280	60161-6061051 mbeshteje financiare e menjehershme	280	602 shpenzime operative	280
			Urdher titullari Nr. 87 date 30.12.2022 për ndryshim buxheti midis zerave brenda të njëjtes strukture	170	6061-6061051 mbeshteje financiare e menjehershme	170	6001-6001001 paga	170
			Urdher titullari Nr. 88 date 30.12.2022 për ndryshim buxheti midis zerave brenda të njëjtes strukture	1,500	6061-6061051 mbeshteje financiare e menjehershme	1,500	602 shpenzime operative	1,500

*Shënim: Ndryshimet e tjera ne buxhetin e Bashkisë Këlcyrë për vitin 2022 janë kryer brenda programeve buxhetore ,midis artikujve , dhe nuk ka qene nevoja për vendim këshilli Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, Pra shtesat dhe paksimet janë bërë me urdhër të nenpunesit Autorizues dhe janë miratuar ne Degën e Thesarit Përmet.*

**Aneksi nr. 3 pika 2.2** Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Këlcyrë, për vitin 2022. Në lekë										
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit					
					Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
							Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta e kushtëzuar specifike	Nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transferta e kushtëzuar për investimet
	Paga 600	92,358,000	81,481,310	88%	1,367,030	1.68%	50,400,000	28,665,980	1,048,300	0
	Sigurime shoqërore 601	15,604,000	14,215,529	91%	2,467,526	17.36%	7,000,000	4,573,011	174,992	0
	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	29,239,000	22,613,451	77.3%	4,071,146	18%	10,270,700	8,271,605	0	0
	Subvencion Ujësjetllësi, etj. 603	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	K. Q . Emergj Civile 604	822,100	422,102	51.3%	0	0	0	422,102	0	0
	Nd/Ekonom invalid 606	90,324,000	90,030,434	99.7%	0	0	0	90,030,434	0	0
	Nd ekonom nga buxh bashksie 606	246,000	246,000	100%	0	0	246,000	0	0	0
	Mjete ne ruajtje 466	11,288,228	11,288,228	100%	11,288,228	100%	0	0	0	0
	Investime 230-231	78,494,385	78,374,385	99.8%	12,000,000	15.3%	0	0	0	66,374,385
	Emergj civile 606-609 buxhet vet	1,599,000	0	0	0	0	0	0	0	0
	Fond per mbesht financiare fund viti	1,990,000	1,990,000	100%	0	0	1,500,000	450,000	40,000	0
	Principali 651									
	.....									
	Shto, pakso sipas faktit në B.Kelcyre									
	<b>Totali</b>	<b>321,964,713</b>	<b>300,661,439</b>	<b>93.4%</b>	<b>31,193,930</b>	<b>10.4%</b>	<b>69,416,700</b>	<b>132,413,132</b>	<b>1,263,292</b>	<b>66,374,385</b>

*Burimi: Sektori i financës*

**Aneksi nr. 1 pika 4.4** Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet (Nga të ardhurat e veta)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	Sistemim asfaltim Rruga Suke Podgoran Fushe,Rruga Gorice, Rruga Komarak e Vinokash rruga Gur Fshat Kelcyre,Rruga Rriban.	H	10.06.2019	3/2021 date 03.11.2021		5,889,346	0	0	5,889,346
2	Rikonstruksioni i rrugeve te lagjes se Spitalit	J	07.05.2019	1 date 22.06.2020	87989401	20,857,913	0	7,000,000	13,857,913
3	Sistemim asfaltim rruga Ura e	SH	22.10.2021	164/2021 date		6,879,632	0	5,000,000	1,879,632

	Mbrezhanit Malshove			15.12.2021					
4									
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>33,626,891</b>	<b>0</b>	<b>12,000,000</b>	<b>21,626,891</b>

**Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për mallrat dhe shërbimet (Nga granti)**

Nr.	Emërtimi i i Objektit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Vlera e detyrimit me 31.12.2022
1	Fatura energjie muaji dhjetor	FSHU Tirane		indeksi		399,094	370,661	399,094	370,661
2	Fatura sherbime postare dhjetor 2021	Posta SHA		957/2021 dt 31.12.2021 dhe		5,310	6,585	5,310	6,585
3	Fature furnizim me uje te	Furnizim me Uje		73/2021 dt		159,120	0	159,120	0
4	Fatura sherbime telefonike	Albtelekom sh.a		156292/2023, dt		0	4,319	0	4,319
5	Pagese per trajtim ushqimor	Futbollistet e KF Kelcyra		Listepag dhjetor 2021 dhe listepag dhjetor 2022		400,000	300,000	400,000	300,000
6	Pagese per keshilltaret dhe kryetare fshati	Keshilltare & Kryetare fshati		Listepag dhjetor 2022			215,569		215,569
7	Likuidim fature per furnizim	A		283/2022 dt 19.12.2022		0	259,140	0	259,140
<b>Totali i detyrimit</b>						<b>963,524</b>	<b>1,156,274</b>	<b>963,524</b>	<b>1,156,274</b>

**Burimi: Bashkia Këlcyrë**

**Aneksi nr. 1 pika 2.6** Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Nr.	Emri Mbiemri	Funkcioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr, datë
a	b	I	2	3	4
1	L.J	Pergjegjese zyres T.T	Finance-Kontabilitet	i larte	Urdhër nr.94 date 20.09.2021
2	M.Ç	Specialist, B.Kelcyre	Finance - Kontabilitet	I larte	Urdhër nr.67 date 01.09.2016
3	I.K	Specialist,B.Kelcyre	Finance - Kontabilitet	I larte	Urdhër nr.103 date 20.09.2021
4	S.S	Agjent,Nj.Ad.Dishnice		I mesem	Urdhër nr.77 date 22.12.2017
5	Y.I	Agjent, Nj.Ad.Suke		I mesem	Urdhër nr.94 date 06.09.2018
6	A.Q	Agjent,Nj.Ad.Ballaban		I mesem	Urdhër nr.87 date 21.09.2015

**Burimi: Bashkia Këlcyrë**

**Aneksi nr. 2 pika 2.6** Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
a	b	7	8	9
<b>I</b>	<b>Te ardhura nga Tatimet</b>			
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	<b>70</b>	<b>5</b>	<b>7.1</b>
<b>II</b>	<b>Te ardhura nga Taksat</b>			
2	Taksa mbi B. Vogel			
3	Taksa e Pasurisë, ndertese	<b>2260</b>	<b>1290</b>	<b>57.1</b>
4	Taksa mbi token Bujqesore	2300	1163	50.6
5	Takse mbi rregj e Automjete			
6	Taksa e ndik te ndmbiinfrast	5500	1533	28
7	Takse Tabele	20	9	45
8	Takse hoteli			
9	Takse Parkimi			
10	Takse per hapësira publike	380	112	29
11	Takse reklame	350	93	26.5

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
a	b	7	8	9
<b>III</b>	<b>Te ardhura nga Tarifat</b>			
12	Tarife Pastrimi	1866	1284	69
13	Tarifë shërbim te tjera publike			
14	Tarife leje transport.			
15	Tarife vend banor/gj CIVILE			
16	Tarife urbanistike			
17	Tarife rregj biznes i Ri			
18	Tarife ndriçimi rrugor	410	440	107
19	Te ardhura te tjera			
20	Tarife çertifikimi mishi			
<b>IV</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>			
21	Qera trualli	600	590	98
22	Shitje Pase & privatiz banese	0	46	
23	Qera kullote	<b>1050</b>	<b>425</b>	<b>40</b>
24	Tarifë uji i pijshëm			
25	Te ardhura tendera			
26	Gjoha.			
27	Takse Vule			
28	Qerandertese			
29	Dhurata, sponsoi & Garanci.			
30	Te ardhura te tjera	6188	7949	128
	<b>GJITHSEJ ( I+II+III+ IV)</b>	<b>20,994</b>	<b>14938</b>	<b>71</b>

**Burimi:** Nga Bashkia, sipas evidencave të kundruar me Degën e Thesarit.

### Aneksi nr. 3 pika 2.6 Debitoret e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Prot BASHKI	Data	Sip. totale e ndërtimit (m <sup>2</sup> )	Vlera e taksës (lekë)	Paguar	Pa paguar
1	S	M	XH	2757	07.12.2022	159	25,928	25,928	
2	I	B	B	198	28.01.2022	123	20,058		20,058
3	F	SH	H	55	10.01.2022	161.5	26,336		26,336
4	A	H	H	835	19.04.2021	101.8	16,600	16,600	
5	A	H	H	2285	27.08.2020	70	11416	11416	
6	A	H	H	2285	27.08.2020	52	8,480	8,480	
7	A	M	M	2945/2	17.12.2021	133	21,688		21,688
8	S	K	SH	2941	16.12.2021	22.5	3,669	3,669	
9	R	V	Ç	3003	13.12.2021	92	15,002	15,002	
10	E	I	H	1545	12.07.2021	120	19,568		19,568
11	M	R	K	1761	16.08.2021	296	48,269		48,269
12	L	S	T	1209	18.01.2018	52.5	8,561		8,561
13	E	M	S	2593	05.10.2020	281.5	45,904		45,904
14	B	R	H	417	25.02.2021	123	20,058		20,058
15	Z	M	L	1973	08.07.2020	215	25,062	25,062	
16	N	L	C	671	21.04.2020	159	25,930	25,930	
17	V	P	Q	1979	10.09.2021	200	32,614	32,614	
18	TH	S	K	2327	14.10.2021	70.5	11,496	11,496	
19	K	S	S	2309	13.10.2021	334.1	54,582	54,582	
20	H	XH	K	1994	13.09.2021	23	3,750	3,750	
21	K	A	L	1980	10.09.2021	27	4,403	4,403	
22	Q	R	D	1992	13.09.2021	74.5	12,149	12,149	
23	Q	R	D	1993	13.09.2021	158	25,768	25,768	
24	B	A	A	1995	13.09.2021	375	61,151	61,151	
25	I	Q	L	1245	11.06.2021	97.4	15,883	15,883	
26	A	J	P	1539	12.07.2021	184	30,005	30,005	

27	N		M	1538	12.07.2021	53.5	8,725	8,725		
28	R	XH	D	1429	30.06.2021	147	23,972	23,972		
29	A	M	K	602	25.03.2021	66.4	10,829	10,829		
30	S	D	H	503	09.03.2021	110	17,939	17,939		
31	T	N	H	1626	23.07.2021	192	31,310	31,310		
32	SH	B	M	1512	13.07.2021	63	10,274	10,274		
33	M	TH	D	1760	16.08.2021	22	3,588	3,588		
34	Y	E	I	786	13.04.2021	57	9,295	9,295		
35	T	P	P	1246	11.06.2021	125.4	20,449	20,449		
36	S	S	Ç	834	19.04.2021	224.4	36,593	36,593		
37	S	XH	C	787	13.04.2021	40	6,523	6,523		
38	E	I	C	603	25.03.2021	161.9	26,401	26,401		
<b>TOTALI</b>							<b>800,288</b>	<b>611,474</b>	<b>188,754</b>	

**Burimi:** Bashkia Këlcyrë

**Aneksi nr. 4 pika 2.6** Kontratat për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullësor.

kont rata	Emir mbiemri	Ekonomia pyre/kullësore	Nr.ngasres	Sip. Qe shfrytezohet (ha)	Nr. Kreteve Lloji; tarifa/krer	Tarif.nder t. provizor	Pagesa sipas mand.arket.
1	B.K	Deshnice	120/a;120/b;122a	65	100 dhi x 100	3000	13,000
2	D.R	Lesk.-pacomit	Bregu dhespes	3	30 dhen x100		3,000
3	A.L	Leskovec-pacomit	10 (kushove)	15	150 dhen		15,000
4	S.R	Lesko-Pacomit	29	1.3	3 gjedhe x1000		3,000
5	V.T	Deshnice	113	44	250 dhi		25,000
6	G.P	Bubes leskovec	59	55	150 dhi x80		12,000
6	G.P	Deshnice L-P	58;124/a	45	100 x1000	3500	13,500
7	G.P	Deshnice	119/a;60	60	140 dhi		14,000
8	N.C	Deshnice	74/a,b, 29	43	150 dhi		12,000
9	B.SH	Trebeshtine	24	40	250 dhi x 80		20,000
10	SH.S	Trebeshtine	16	25	200 dhen x100		20,000
11	Zh.Z	Trebeshtine	35;34/a,b	68	220 dhi x100		22,000
12	A.C	Deshnice	72;73	30	100 dhi		10,000
13	H.G	Deshnice	101/102	43	190 dhi		19,000
14	L.M	Deshnice	42	26	70 dhi		7,000
15	A.V	Trebeshtine	20	60	300 dhen		30,000
16	B.K	Trebeshtine	7	24.6	150 dhen		15,000
17	Y.S	Trebeshtine	10	11.5	100 dhen		10,000
18	A.K	Leskovec-pac.	141	10	10 gjedh		10,000
19	V.RR	Lesko-Pacomit	Musha fshati	10	50 dhen		5,000
20	S.R	Lesk-pacomit	29	1	2 gjedh		2,000
21	A.F	Lesko-pacomit	7;52	35.7	120 dhen		12,000
22	XH.H	Leskovec pac.	39	1	2 gjedh		2,000
23	A.D	Lesko-pacomit	55/56	52	100 dhi		10,000
24	K.M	Lesko -Pacomit	8/37	13+5	60 dhen		4,000
25	Z.C	Lesk -Pacomit	8/49	15+20	80 dhen		5,000
26	I.H	Leskovec-Pac.	50	3	2 gjedh x 800	1000	2,600
27	I.H	Lesko-pacom	49	2.9	4 dhi	1000	1,400
28	H.B	Lesko-Pacomit	7/9 musha	18	20 dhen		2,000
29	SH.SH	Lesko-Pacomit	50	3	20 dhen 2gjedh		4,000
30	A.K	Lesk-Pacomit	29	1	20 dhen		2,000
						8,500	325,500

**Burimi:** Sektori i pyjeve dhe kullotave

**Aneksi nr. 1 pika 3** Formati nr.1 i Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	<b>A K T I V E T</b>	<b>1,117,849,045</b>	<b>1,137,209,996</b>
2		<b>I.Aktivitet Afat shkurt</b>	<b>101,403,848</b>	<b>92,851,649</b>
3		<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>25,153,484</b>	<b>28,301,766</b>
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	25,153,484	28,301,766
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>10,475,141</b>	<b>10,280,990</b>
12	31	Materiale	0	0
13	32	Inventar I imet	10,475,141	10,280,990
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>65,775,223</b>	<b>54,268,893</b>
22	411	Kliente e llogari te ngjashme	28,453,410	40,260,660
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	28,796,938	6,078,720
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	8,524,875	7,929,513
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		<b>II.Aktivitet Afat gjata</b>	<b>1,016,445,197</b>	<b>1,044,358,347</b>
43	<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>100,204</b>	<b>129,760</b>
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	100,204	129,760
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,016,344,993</b>	<b>1,044,228,587</b>
48	210	Toka, Troje, Terene		

49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesha e Konstruksione	365,492,210	357,824,654
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	627,911,271	660,839,287
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	1,230,679	1,521,444
53	215	Mjete Transporti	14,041,401	16,289,327
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	7,669,432	7,753,875
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		<b>4.Investime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	0	0
<b>65</b>	<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>47,323,679</b>	<b>65,915,076</b>
66		<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>47,323,679</b>	<b>65,915,076</b>
67		<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>47,323,679</b>	<b>65,915,076</b>
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	28,453,410	40,260,660
69	42	Detyrime ndaj personelit	6,153,280	5,700,684
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	201,001	202,384
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	2,170,594	2,026,445
76	436	Sigurime Shendetsore	0	0
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	10,345,394	17,724,903
82	467	Kreditore te ndryshem	0	0
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime		
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigionet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>1,070,525,366</b>	<b>1,071,294,920</b>
97	<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>1,070,525,366</b>	<b>1,071,294,920</b>
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,055,717,276	1,060,718,057
99	12	Rezultatet e mbartura	0	0
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	14,808,090	10,576,863
101	111	Rezerva	0	0

102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	0	0
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime	0	0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	0	0
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	0	0
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>1,117,849,045</b>	<b>1,137,209,996</b>

**Burimi:** Bashkia Këlcyrë

**Aneksi nr. 2 pika 3** formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Raportuse	Paraardhese
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
<b>1</b>	<b>I</b>	<b>VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT</b>	<b>347,128,109</b>	<b>529,104,842</b>
<b>2</b>	<b>1</b>	<b>Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)</b>	<b>243,470,328</b>	<b>223,094,267</b>
<b>3</b>	<b>2</b>	<b>Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor</b>	<b>300,661,439</b>	<b>372,727,999</b>
<b>4</b>		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	0	0
<b>5</b>		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	0	0
<b>6</b>		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	7,410,722	114,657,895
<b>7</b>		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
<b>8</b>		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
<b>9</b>		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	10,345,394	17,724,903
<b>10</b>		Te tjera, arketuar(+)	7,527,280	7,575,003
<b>11</b>	<b>3</b>	<b>Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente</b>		
<b>12</b>		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
<b>13</b>		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-196,060,824	-178,556,860
<b>14</b>		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	-11,288,228	-9,055,467
<b>15</b>		Interesi I paguar(-)		
<b>16</b>		Tatime te paguara(-)		
<b>17</b>		Te tjera te paguara ( - )	-14,938,002	-19,062,898
<b>18</b>	<b>II</b>	<b>VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE</b>	<b>120,000</b>	<b>2,600,000</b>
<b>19</b>		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	78,494,385	168,652,774
<b>20</b>		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
<b>21</b>		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
<b>22</b>		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
<b>23</b>		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
<b>24</b>		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-78,374,385	-166,052,774
<b>25</b>		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
<b>26</b>		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
<b>27</b>		Dividente te paguar(-)		
<b>28</b>	<b>III</b>	<b>TRANSFERTA E TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>29</b>		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		
<b>30</b>		Transferime ne buxhet te Fondeve te pa perdorura(-)		
<b>31</b>		Levizje e brendshme e transferta te tjera(+/-)		
<b>32</b>	<b>IV</b>	<b>Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare</b>	<b>347,248,109</b>	<b>531,704,842</b>
<b>33</b>	<b>V</b>	<b>Teprica ne fillim te vitit ushtrimor</b>	<b>28,301,766</b>	<b>27,132,457</b>
<b>34</b>	<b>VI</b>	<b>Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor</b>	<b>25,153,484</b>	<b>28,301,766</b>

**Burimi:** Bashkia Këlcyrë



**Aneksi nr. 3 pika 3** Analizë e shtesave të AAM-ve vlerësuar me koston historike, sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës

Struktura	Emertimi Asetit	Vlefte date 31.12.2021	Shtesat 2022	Pakesimet 2022	Fund Viti 2022
<b>212</b>					
2120101	Ndertesa administrative (aparati)	35,099,711	0	0	35,099,711
2120103	Ndertesa shkollore (2312103)	210,703,333	0	0	210,703,333
2120104	Ndertesa social kulturore	10,118,588	0	0	10,118,588
2120105	Ndertesa shendetesore	24,029,217	13,384,404	0	37,413,621
2120114	Varrezat	3,466,532	0	0	3,466,532
2120113	Shpenzime per lulishtet (2312113)	392,000	0	0	392,000
2120117	Shpenz. per terrenet sportive (2312117)	1,022,989	0	0	1,022,989
2120118	Te tjera ndertimore (2312118)	135,323,063	12,174,385	0	147,497,448
	<b>Shuma Ndertesa</b>	<b>420,155,433</b>	<b>25,558,789</b>	<b>0</b>	<b>445,714,222</b>
<b>213</b>					
2131000	Konstruksione te rrugeve (2313100)	749,201,414	12,000,000	0	761,201,414
2132000	Konstruksione te urave (2313200)	33,590,213	0	0	33,590,213
2133000	Konstruksione te rrjeteve -Ujes. (2313300)	468,265,302	54,200,000	0	522,465,302
2134000	Konstruksione te veprave ujore (2313400)	126,423,535	0	0	126,423,535
2133000	Konstruksione te rrjeteve te ndricimit	6,371,317	0	0	6,371,317
2133000	Konstruksione te rrjeteve KUZ	40,949,649	0	0	40,949,649
2133000	Konstruksione te vorrezave	8,091,561	0	0	8,091,561
2133000	Konstruksione per pajisje ujesjellesash	220,000	0	0	220,000
2136000	Te tjera konst.te rrug. vep. rrjete (2313600)	12,490,500	0	0	12,490,500
	<b>Shuma Rruge e rrjete</b>	<b>1,445,603,491</b>	<b>66,200,000</b>	<b>0</b>	<b>1,511,803,491</b>
<b>215</b>					
2151120	Makina e aparatit B	698,012	0	0	698,012
2151120	Makina e aparatit B	980,600	0	0	980,600
2151120	Makina B - Deshnica	698,000	0	0	698,000
2151120	Makina I (ambulanca) - Deshnica	7,584,241	0	0	7,584,241
2151120	Makina Hyndai - Deshnica	1,500,000	0	0	1,500,000
2151120	Mjete transp. Autov. tip "B & A	3,667,411	0	0	3,667,411
2151140	Automjete te tjera te renda - Kelcyra	4,280,000	0	0	4,280,000
2151120	Makina B 2000 -Ballabani	400,000	0	0	400,000
2151140	Ekskavator me zinxhira tip V	16,347,131	0	0	16,347,131
2151160	Automjet kunder zjarrit Zjarrfikse B	3,960,000	0	0	3,960,000
2151160	Automj.Zjarrfikse Renault (dhuruar)	0	0	0	0
	<b>Shuma Mjete transporti</b>	<b>40,115,395</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>40,115,395</b>
<b>214</b>					
2140320	Orendi zyre (2314160)	385,620	0	0	385,620
2140160	Pajisje kompjuterike	2,165,623	0	0	2,165,623
2140320	Te tjera pajisje (v.pune)	2,052,425	0	0	2,052,425

	(2314320)				
2140250	Pajisje per mbrojtjen nga zjarri	320,280	0	0	320,280
2140260	Pajisje pastrimi per rruget (karroca dore)	56,400	0	0	56,400
2140320	Mjete dhe pajisje te tjera (Hidraulike)	129,100	0	0	129,100
2140320	Pajisje zyre, mobilje shk mesme F.H nr 29/2020	1,300,200	0	0	1,300,200
	<b>Shuma Paisje inventari</b>	<b>6,409,648</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6,409,648</b>
<b>218</b>					
2184100	Fotokopjues T (2318400)	195,920	0	0	195,920
2186100	Pajisje Kompj., printera, fotok. (2318600)	9,836,376	0	0	9,836,376
2181100	Tavolina, karrige e te tjera pajisje	3,575,714	0	0	3,575,714
2187100	Te tj pajisje zyre (ngrohja cop 22x4020)	244,440	0	0	244,440
2187100	Paj. zyre -Printer Gj.Civile cop 1x19829	19,829	0	0	19,829
2186100	Pajisje kompjuter, fotokopje z.sherb.pyjor	567,275	0	0	567,275
2187100	Paj. zyre -Printer L Gj.Civile cop 1	9,250	0	0	9,250
2187100	Te tj pajisje zyre (ngrohja cop 10x5040)	50,400	0	0	50,400
2186100	Laptop, Videoprojekt. Printer Q.Kulturore	160,625	0	0	160,625
2187100	Sistem Fone Q.Kulturore dhurate	165,500	0	0	165,500
2187100	Soba zjarri, tubo, brryla cop 8 shkolla Suka	119,280	0	0	119,280
2186100	Kompj D CPC + Monitor G cope 1 Gjim	93,000	0	0	93,000
2186000	Tablete T, cope 1 (fl.hyrje nr. 3 dt.15.3.22)		16,320		16,320
2186000	Tablete T, cope 2 (fl.hyrje nr. 4 dt.15.3.22)		32,640		32,640
2186000	Pajisje kompjuter Dcop 2, monitor dell cop 2, B MFCL 2752 DË cop 2, etj (fl hyrje nr. 8 dt. 17.05.2022)		323,332		323,332
2187000	Pajisje zyre, TV65" cop 1, Laptop I7 cop 1, mikrof, audio mixer, (fl.hyrje 29 dt 20.12.22)		744,418		744,418
					0
	<b>Shuma Inventar ekonomik</b>	<b>15,037,609</b>	<b>1,116,710</b>	<b>0</b>	<b>16,154,319</b>
<b>219</b>					
2192100	Amortizimi ndertesa	62,330,779	17,891,233	0	80,222,012
2193100	Amortizim rruge, ura, rrjete, rezervuare	784,764,204	99,128,016	0	883,892,220
2195100	Amortizim mjete transporti	23,826,068	2,247,926	0	26,073,994
2194100	Amortizim paisje inventari	4,888,204	290,765	0	5,178,969
2198100	Amortizim inventar ekonomik	7,283,734	1,201,153	0	8,484,887
2092100	Amortizim Studime dhe kerkime	5,705,721	29,556	0	5,735,277
	<b>Shuma Amortizime</b>	<b>888,798,710</b>	<b>120,788,649</b>	<b>0</b>	<b>1,009,587,359</b>

**Burimi: Bashkia Këlcyrë**

**Aneksi nr. 4 pika 3 Testi substancial i amortizimit.**

Nr. Rrjeshti	Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	<b>I. AAGJ/O MATERIALE</b>	5,835,481	5,705,721	129,760	0	29,556	0	0	5,835,481	5,735,277	100,204
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	5,835,481	5,705,721	129,760		29,556	0	0	5,835,481	5,735,277	100,204
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	21- 28	<b>II. AAGJ/ MATERIALE</b>	1,927,321,576	883,092,989	1,044,228,587	92,875,499	120,759,093	0	0	2,020,197,075	1,003,852,082	1,016,344,993
6	210	Toka,troje, Terene			0					0	0	0
7	211	Pyje, Kullota Plantacione			0					0	0	0
8	212	Ndertime e Konstruksione	420,155,433	62,330,779	357,824,654	25,558,789	17,891,233			445,714,222	80,222,012	365,492,210
9	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,445,603,491	784,764,204	660,839,287	66,200,000	99,128,016			1,511,803,491	883,892,220	627,911,271
10	214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	6,409,648	4,888,204	1,521,444		290,765	0	0	6,409,648	5,178,969	1,230,679
11	215	Mjete transporti	40,115,395	23,826,068	16,289,327		2,247,926	0	0	40,115,395	26,073,994	14,041,401
12	216	Rezerva shtetore			0					0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi			0					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	15,037,609	7,283,734	7,753,875	1,116,710	1,201,153	0	0	16,154,319	8,484,887	7,669,432
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			0					0	0	0
16	28	Caktime			0					0	0	0
17		<b>TOTALI (I+II)</b>	1,933,157,057	888,798,710	1,044,358,347	92,875,499	120,788,649	0	0	2,026,032,556	1,009,587,359	1,016,445,197

**Burimi: Bashkia Këlcyrë**

**Aneksi nr. 5 pika 3 Formati nr.2 "Pasqyra e performancës financiare"**

Nr. rreshti	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	b	c	1	2
1	A	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>226,400,877</b>	<b>207,725,883</b>
2	70	<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>7,527,280</b>	<b>7,595,003</b>
3	700	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>5,000</b>	<b>57,058</b>
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	5,000	57,058
7	7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
8	702	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>2,498,621</b>	<b>2,829,588</b>
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	2,452,573	2,795,143
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme	0	0
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	46,048	34,445
12	703	<b>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</b>	<b>5,023,659</b>	<b>4,708,357</b>
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	2,334,006	2,252,112
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	2,689,653	2,456,245
18	704	<b>4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		

23	705	5.Takse e rruges		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
25	709	7.Gjoba e Kamat vonesa		
26	75	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
34	71	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>7,410,722</b>	<b>11,467,895</b>
35	710	<b>1.Nga ndermarrjet dhe pronesia</b>	<b>2,087,046</b>	<b>6,787,614</b>
36	7100	Nga Ndërrmarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndërrmarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	2,087,046	6,787,614
39	711	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>3,106,947</b>	<b>2,801,856</b>
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	1,840,161	2,080,569
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	1,250,786	711,287
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	16,000	10,000
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>	<b>2,216,729</b>	<b>1,878,425</b>
48	76	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga kembimet valutore		
53	72	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>211,462,875</b>	<b>188,662,985</b>
54	720	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>211,462,875</b>	<b>188,662,985</b>
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	0	0
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	202,938,000	180,733,472
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim i pritshem nga buxheti	8,524,875	7,929,513
62	7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)		
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	<b>2.Grant korent I Huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive		

		afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	73	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
74	<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>211,592,787</b>	<b>197,149,020</b>
75	<b>600</b>	<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>81,932,523</b>	<b>82,251,869</b>
76	6001	Paga, personel i perhershem	81,932,523	82,251,869
77	6002	Paga personel i perkohshem	0	
78	6003	Shperblime	0	
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin	0	
80	<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>14,359,678</b>	<b>14,163,032</b>
81	6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	14,359,678	14,163,032
82	6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	0	0
83	<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>22,606,201</b>	<b>23,724,710</b>
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	484,536	444,156
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	1,042,000	2,400,000
87	6022	Sherbime nga te trete	7,449,052	6,746,397
88	6023	Shpenzime transporti	8,142,052	8,932,590
89	6024	Shpenzime udhetimi	173,420	355,540
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,835,288	1,106,268
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	204,000	216,613
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	0	370,628
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	0
94	6029	Shpenzime te tjera operative	3,275,853	3,152,518
95	<b>603</b>	<b>IV.SUBVECIONE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
96	6030	Subvecone per diference cmimi		
97	6031	Subvecone per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecone per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecone per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecone te tjera		
101		<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>92,888,536</b>	<b>77,009,409</b>
102	<b>604</b>	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>422,102</b>	<b>30,571</b>
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	422,102	30,571
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
107	<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	<b>606</b>	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>92,466,434</b>	<b>76,978,838</b>
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		

114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	92,466,434	76,978,838
115		<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
116	65	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore	0	0
121	66	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
122	660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
125		<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
130	63	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>-194,151</b>	<b>0</b>
131		<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>	<b>0</b>	
132	85	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIU DHES (Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)</b>	<b>14,808,090</b>	<b>10,576,863</b>

Burimi: Bashkia Këlcyrë

**Për sa më sipër paraqitet ky raport përfundimtar auditimi.**

## **GRUPI I AUDITIMIT**

**1. B.M (P.Grupi)**

**2. H.I**

**3. E.RR**

**4. M.M**

**5. S.H**

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

**B. D.**